

I lindur në vitin 1944, Nasi Lera është një ndër shkrimtarët më të spikatur shqiptarë. Autor i më tepër se njëzet librave, sëfundmi ai ka botuar vëllimin me tregime "Vetmia e syve të qenit". Në këtë bisedë rrëfen për krijimtarinë, shoqërinë dhe atmosferën letrare në tërësi...

NASI LERA: ISHTE POEZIA QË MË DHA MËSIMIN MË TË VYER SI PROZATOR

Bisedoi Andreas Dushi

(fq. 2-4)



SHËNIME PËR LIBRAT

"Kur sunduesit grinden" i Kadaresë

RAPORTI I ARTISTIT ME PUSHTETIN

Nga Agim Janina

(fq. 12)

Raporti i mësipërm është marrë e rimarrë nga autori në shumë vepra të tij, herë del i nënkuptuar, herë i fshehur ndërmjet rreshtave, herë si vegim...

"Poetika e letërsisë për fëmijë"
i Anton Nikë Berishës

ÇELËSI I INTERPRETIMIT TË VEPRAVE LETRARE PËR FËMIJË

Nga Sabahajdin Cena

(fq. 9)

"Testamente prej mëndafshi" i
Lulëzim Hazirit

SHTATË NOKTURNO - TRISHTIM I RRALLË

Nga Ballsor Hoxha

(fq. 5)

Nga shtëpia botuese "Polis"

NGJYRA E TURPIT

një roman i ri i Geverina Muzhaqit

(fq. 23)

NJË UDHËTIM NË LABO- RATORIN E KOHËS ME OLTSEN GRIPSHIN

Nga Pol Milo

(fq. 10)


Më 25 mars 2021, ditën e
700 vjetorit të lindjes

NJË SULM I GAZETËS GJERMANE Frankfurter Rundschau NDAJ DANTE ALIGHERIT

Përgatiti dhe përktheu
ARISTIDH SHQEVË

Në faqet e para të gazetave u panë tituj si: *Sulm i pabesueshëm nga Gjermania* - La Repubblica, *Gjermania na fjen edhe me figurën e Dantes* - Il Secolo d'Italia, *Sulm nga Gjermania* - La Stampa, *Dante - egoist dhe plagjiator?* - Il Fatto Quotidiano, *Dante, sulm i një të përditshmeje gjermane: Kopjoi gjithçka nga një arab* - La Stampa. *Dante dhe gazeta gjermane: sulm i egër i Frankfurter Rundschau* - La Nazione

(fq. 18)



Ku takohen dhe ku ndahen Kompleksi i
Edipit me Baladën e Rinjohjes

PËRQASJE MES "EDIPIT MBRET" TË SOFOKLIUT DHE NJË LEGJENDE TË VJETËR MIRDITASE

(fq. 6)

Nga Ndue Dedaj

Ky variant është i përafëruar me "Edipin Mbret", subjekti zhvillohet në hullinë e tragjedisë antike të Sofokliut dhe jo në atë të Baladës së Rinjohjes. Kurse nga Zadrima At Marin Sirdani sjell një variant të ngjashëm, por jo të njëjtë me atë të Mirditës të mbledhur nga Kol Shtjefni, që frati gjithashtu e quan përrallë.

BIBLIOTEKË

Rudolf Marku

(fq. 14)

Dhjetë këngët e Sibilave

Roland Gjoza

(fq. 16)

Guernikën vesh si këmishë

Rozafa Shpuza

(fq. 17)

Përvjetor mkatesh

Gabriel Garcia Marquez

(fq. 21)

*Përse dymbëdhjetë, përse
tregime dhe përse pelegrine*

E. B. White

(fq. 22)

*Mbi disa mendime për
humorin*

NASI LERA:

ISHTE POEZIA QË MË DHA MËSIMIN MË TË VYER SI PROZATOR

Bisedoi Andreas Dushi

A.D: Z. Lera, krijimtaria juaj ka filluar heret, qysh në fundin e viteve '60 kur botonit në revistat e kohës e pastaj, në fillimin e viteve '70 kur botuat vëllimin me tregime "Bora e fundit". Një tregim në atë përmbledhje titullohet *Shiu fillon kur bashkohen retë...* Për ta marrë si një metaforë të vetme e cila mund të rrijë edhe në një tjetër kontekst, cilat *re bashkohen* për të filluar në mendjen tuaj ai shi shkronjash që bie mbi faqet e një libri të ri?

N.L: Shiut të pyetjes suaj do t'i shtoja vetëm epitelin *tronditës*, pra, ç'shi tronditës bie mbi përjetimet e një shkrimtari, para se ai të ulet për të shkruar? Për të mbetur gjithmonë brenda peizazhit shpirtëror të një shkrimtari, do të thosha se retë, qielli i tij, nuk është asnjëherë i qetë, ai është gjithmonë i shqetësuar, i trazuar, kërcënues, i errët, befasues, i pazbërthyes në misterin që fsheh brenda, aq sa ngjan sikur krijimi do të hakmerret me krijuesin e tij. Shkrimtari është i dënuar (dënim që e ka pranuar me vetëdije të plotë), të vëzhgojë çdo çast, që pastaj së bashku me imagjinatën, të mos reshtë në bluarjen e mbresave, kujtimeve, ngjarjeve, njerëzve, dramave sa vetjake aq edhe shoqërore, për t'ua kthyer përsëri atyre që i shkaktojnë shqetësimin krijues, që po të mos derdhej si *shi shkronjash*, si me të drejtë e quani ju, shkrimtarit do t'i dukej sikur kishte jetuar duke gënjyer apo mashtruar veten. (Ndoshta ky mund të ishte një subjekt interesant, por fatkeqësisht ndodh që vetë autori i tij nuk e di se ka humbur një subjekt interesant. (Si i ndodh heroit të një prej kryeveprave të Ernest Heminguejt: *Dëborë e Kilimanxharos*) Dikush tjetër do ta shkruante me dëshirë për të treguar se shkrimtari është i detyruar të jetojë për artin e tij, duke pranuar vetëflijimin që kërkon ai.)

Shkrimtari nuk është asnjëherë i braktisur, sepse personazhet që ka krijuar nuk e njohin braktisjen, ata janë edhe më të pamëshirshëm (sidomos kur kanë dalë të gjymtuar, pa botë, pa kujtime, pa të ardhme, pa asnjë vërtetësi). Pelegrinazhi i tyre i pluhuros, për fat të keq, është i pafund. (Andreas, a nuk ju duket interesant një tregim me titullin: *Pelegrinazhi i personazheve të mbuluar nga pluhuri i harrimit?*) Dhe për ta mbyllur me pyetjen që ngacmoi shiu (metaforik): unë shkruaj me shumë dëshirë kur jashtë bie shi, sepse më kujton fëmijërinë, (fëmijëria është burim i pashtershëm në krijimtarinë e një shkrimtari), qytetin ku u linda dhe ku u rrita, shokët, fëmijët e mi, nipërit dhe mbesat e mia, shiu më kujton ditën kur gruaja dhe unë nuk e vumë re se ishim qullur nga që ishim të dashuruar. (Ja dhe subjekti i një tregimi lirik.)

A.D: Në atë libër të parë është edhe tregimi me të njëjtin titull. Por ndërkohë, në librin pasardhës "Era e pishave", ju keni sërish një tregim që si motiv ka dëborën, *Dëborë nën diell*. Mbi çka i përzgjidhni motivet e krijimtarisë tuaj?


N.L: Është e vërtetë, mbi tregimet dhe romanet e mia bie vazhdimisht dëborë edhe kur tërë bota është e shqetësuar për ngrohjen e planetit. Për fat të mirë tërë fëmijëria ime kaloi nëpër dimra të gjatë, ku dëborë fillonte në fund të nëntorit dhe mbaronte në fund të prillit. Zakonisht dëborë fillonte ndaj të ngrysurit dhe shtrohej mbi rrugët dhe çatitë e kuqe gjatë tërë natës. Në mëngjes, kur zgjoheshim, na dukej sikur ndodheshim

në një qytet të ri, lindur gjatë natës nën flokët e dëborës. Kur nata ishte e kthjellët dhe kishte hënë (zakonisht këto ishin netët më të bukura por edhe më të ftohta) shihja nga dritarja si dridheshin kristalet e dëborës së ngrirë dhe nga përthyerja e dritës së hënës, dëborë se pse merrte një ngjyrë të lehtë, të kaltër, të brishtë.. Nata ishte edhe më mbresëlënëse, kur dëgjoje thirrjet që i bënin njëra tjetrës patat e egra, në rrugëtimet e tyre, të cilat vetëm fantazia e fëmijës i arrinte. (Kur ke pasur një fëmijëri të tillë nuk mund të mos shkruash për dëborën apo për fëmijën që sheh nga dritarja dritën e kaltër të kristaleve të dëborës, ku dridhej drita e hënës.) Motivët e tregimeve të mia lindin natyrshëm nga ndërthurja e përjetimeve të mia me përjetimet e të tjerëve, ku zëbërthet më mirë bota e njeriut.

Nuk e kam zakon të mbaj shënime sepse gjithmonë kam menduar se një mbresë, pavarësisht se nuk hidhet në letër në çastin kur shfaqet, qoftë edhe në formën e një sinopsi të shkurtër, nuk habitem kur shfaqet edhe mbas vitesh, sepse ka qenë e tillë që kujtesa krijuese e ka ruajtur. Një tregim mund të lindë edhe nga një ide (Tolstoi thoshte më jepni një ide t'iu jap një tregim), nga një peizazh, të cilin ideja, për t'u mishëruar në tregim, kishte kohë që e kërkonte.

Në fëmijërinë time, si djalë shoferi, kam udhëtuar shumë me babanë. Udhëtimet me të janë burim i pashtershëm tregimesh, aq sa habitem edhe vetë, sa pyes do të shterin vallë ndonjëherë apo do marr me vete shumë prej tyre, që nuk u sendërtuan në tregime apo në fragmente romani.

Ju pyesni: Mbi çka i përzgjidhni motivet e krijimtarisë tuaj?



Vetëm mbi përjetimet dhe dhimbjet që më lidhin fort me të tjerët.

A.D: Jua bëra pyetjen paraardhëse, pasi sëfundmi keni botuar "Vetmia e syve të qenit". Për dikë që e njeh mirë letërsinë tuaj, shihet se në titull gjendet sërish e njëjta fjalë që është edhe në të tjerë libra, "Sytë e dashurisë" (*sh. b. Naim Frashëri, 1981*) apo "Sytë e Sofisë" (*sh. b. Toena, 2011*). Çfarë ju shtyn tu shkruani kaq shpesh syve?

N.L: Çfarë më shtyn të shkruaj kaq shpesh për sytë. Kuptohet, sytë njerëzorë që vështrojnë kohën dhe përpigjen të depërtojnë në dramën e saj. Në gjithë qenien e njeriut nuk ka organ më të bukur dhe më të frikshëm se sytë, më të zgjuar dhe më idhnak se sytë. Në qoftë se gjymtyrët e trupit tonë dinë të fshehin botën tonë të brendshme (ose që kanë aq forcë sa të fshehin dashurinë dhe urrejtjen) sytë nuk e fshehin dot as dashurinë dhe as urrejtjen. Syri është porta e shpirtit njerëzor dhe sa i ngatërruar është shpirti njerëzor, këtë e mëson vetëm kur hyn nga porta (apo dritarja) e tij, nga syri. Te romani *Sytë e Sofisë* është një episod kur afreskëve të një kishe në Voskopojë njerëz të panjohur u kishin nxjerrë me gozhdë sytë shenjtorëve. Ata nuk u kishin prerë kokën, krahët apo këmbët, nuk u kishin prerë hundën apo veshët, ata u kishin nxjerrë vetëm sytë që po shihnin masakrën që ata po i bënin jo një afresku por vetë kohës. Nxjerrja e syve kthehet menjëherë në simbol i verbimit që njeriu përpigjet t'i bëjë kohës. Sytë kanë gjuhën e tyre dhe gjuha e tyre është më e sinqerta. Megjithatë janë shkruar poezi dhe tregime për sytë, ata mbeten përherë ngacmues për mesazhet që përcjellin. Unë kam mësuar shumë nga sytë e pafajshëm të fëmijëve dhe gjithmonë jam përpjekur që një subjekt apo ngjarje, ta shoh me sytë e fëmijës. Një shkrimtar mësimin e parë të mjeshtërisë duhet ta marrë nga sytë e fëmijës, nga çiltërsia e tyre. Dhe këtu i afrohem një prej mësimëve që na jep letërsia e shkrimtarëve të vërtetë: arti i të shkruarit, është arti i të qenit i sinqertë me veten dhe me të tjerët.

A.D: Do t'i rikthehem sërish librit tuaj të fundit, por dua të flasim edhe pak për atë "pjesë ta parë" të krijimtarisë tuaj. Patët fatin që, qysh para '90, të lexoheshit edhe nga shqiptarët matanë kufirit. Në 1980, *Rilindja* botoi librin tuaj "Dita e tretë" nën redaktimin e Anton Pashkut, ndërsa në 1985 dhe 1989, u botua e ribotua nën redaktimin e Nazmi Rrahmanit romani "Të jetosh kohën". Ç'përjetim kujtoni nga ajo kohë, kur veç letërsia mund ta kalonte kufirin mes shqiptarëve?

N.L: E kam ende të freskët dhimbjen që ndjeva kur mësova për vdekjen e shkrimtarit të madh Anton Pashku. Që pa u bërë redaktor i vëllimit tim me tregime *Dita e tretë*, botuar në Prishtinë dhe deri ditën kur mësova se Antoni kishte ndërruar jetë kisha prituri të më krijohesh mundësia të shkoja dhe ta takoja (fizikisht) sepse shpirtërisht ishim takuar (unë para Antonit) kur më ra në dorë romani i tij *Oh*, që më tronditi dhe që ishte nga romanet e rralla (ndoshta nga që ishte shkruar nga një shkrimtar shqiptar) që m'u duk i çuditshëm, i magjishëm, tronditës, tragjik. Ai më zhyti menjëherë brenda gjendjes shpirtërore të vetë autorit, si nuk më kishte zhytur asnjë roman tjetër, qoftë ky

edhe i një autori të huaj. Dhe këtu nuk ka asgjë të jashtëzakonshme, mbi një autor të ri, si isha kur më ra në dorë romani *Ob*, ndikimin më të fuqishëm e ushtron një autor, i së njëjtës rrënjë, i të njëjtit gjak, i të njëjtës gjuhë. Në qoftë se një autor i huaj përfshin në veprën e tij në mënyrë të përsosur jetën dhe fatin e popullit të vet, sigurisht që do të ndikojë te një autor i ri, ai do të ndikojë mbi të gjitha me metodën e tij krijuese, kurse një autor i madh shqiptar ndikon tek autori i ri me dhimbjen për fatin e popullit. Dramën e popullit shqiptar mund ta shpalosë vetëm një autor shqiptar. Dhe në ato vite ky autor e kishte emrin Ismail Kadare dhe Anton Pashku. Takimi me të do të ishte një nga ngjarjet që nuk do të më shlyhej nga kujtesa. Por takimi im me Anton Pashkun mbeti vetëm një takim ëndërr, prandaj dhe dhimbjen e ka të mbështjellë nga dramat që shkakton ndarja.

A.D: Qysh në krye të herës, i jeni përkushtuar prozës së shkurtër, tregim apo novelë e më pas, edhe romanit. Në ç’udhë kalon një fabul fillestare për tu orientuar pastaj drejt tregimit, novelës apo romanit?

N.L: Kur ulem të shkruaj, ulem me një parapërgatitje për të shkruar një tregim, një novelë apo edhe për të filluar një roman, Fabula fillestare e gjen vetë rrugën drejt gjinisë ku mund të sendërtohet sa më natyrshëm. Gjinia më e mirëfilltë letrare, krahas poezisë, është tregimi, kjo gjini sa e bukur aq edhe e brishtë, që mund të hidhet në erë edhe nga një fjalë e pagjetur, e futur me dhunë, si ndodh edhe me poezinë. Tregimi i shkurtër shkruhet me një frymë. Po sa e vështirë është të gjesësh fjalinë e parë, që do të përcaktojë tempo-ritmin e shtjellimit të tregimit. Edhe romani e kërkon tempo-ritmin e fjalisë së parë, që do të ndjehet në gjithë veprën. Kur fjalja e parë është e gjetur, ajo gjendet me shumë vuajtje dhe lodhje, personazhet ndjehen të çliruar nga ankthi i zvarritjes nëpër skena ku mbizotëron grija e mërziisë. Më ka ndodhur të shkruaj dy tregime brenda një nate. Por po aq sa të lodh gjetja e fjalisë së parë mund të të lodhë edhe mungesa e një fundi logjik, të natyrshëm, ku tregimit nuk i shton dot as edhe një presje. Ajo që është e çuditshme dhe që përbën bukurinë e krijimit, është se fundin, para autorit, e ndjen vetë tregimi, që ka përfutur një jetë të pavarur. Ai nuk pranon të vazhdohet më tej sepse ndjehet i përsosur në gjendjen ku ka prekur fundin. Autori duhet ta respektojë këtë vendim të krijimit të tij, ndryshe po nuk e respektoi do të dështojë. Pra autori e lind një tregim, por duhet të tregohet shumë i vëmendshëm për të dëgjuar zërin tregimit, që i thotë ndal, pikë, po e vazhdove më tej dhe ti dhe unë do jemi dy krijesa të dështuara.



A.D: Dhe një pyetje, më tepër për kureshtjen time por jam i sigurt se edhe të shumë lexuesve: E keni sprovuar ndonjëherë veten në poezi?

N.L: Kam shkruar edhe unë poezi, por e ndjeja se nuk isha poet, si ishte shoku im i dashur Xhevahir Spahiu. Për mua ai ishte poet i lindur, që gjithçka ndjente apo shihte e kthente në poezi. Xhevahir Spahiu kishte lindur për poezinë dhe poezia kishte lindur për të. Kanë kaluar gati gjashtëdhjetë vjet që kur u ulëm në auditoret e Fakultetit Filologjik dhe vetëm mënyra si i përjetoj dhe i sjell në mendje gjithë emocion vitet që kaluam aty më bëjnë, sigurisht edhe nga prania e Xhevahir Spahiut, të ndjehem edhe vetë poet, megjithëse ëndrra ime e parë kishte qenë dhe mbeti proza. Ishte poezia që më dha mësimin më të vyer si prozator.

Të qenit prozator nuk e përjashton aspak të qenit poet, sepse si edhe e thashë tregimi dhe poezia, janë, ndoshta, binjaket e vetme të mirëfillta të letërsisë. Ato kanë shumë anë të përbashkëta që i lidhin më fort sesa i ndajnë. Kam botuar shumë pak, aq pak sa mund t’i numëroj me gishta, poezi në gazetën *Drita*, të cilat m’i çonte Xhevahiri për t’i botuar, sepse vete kisha një ndruajtje gati prej fëmije të frikësuar nga mendimet vendimtare, si të perëndive fatdhënëse, të shkrimtarëve dhe redaktorëve dhe po kështu i trembesha se mos qeshnin me keqardhje kur të shkoja të pyesja për poezitë që kisha çuar për botim. Një copë, si ajo dëborë që nuk shkrin kurrë në rrudhat e majave të maleve, ka mbetur ende brenda meje. Ndryshe ishte shoku im poet.

Mbas përfundimit të studimeve u ktheva në Korçë për të kryer shërbimin e detyrueshëm ushtarak pesë mujor. Xhevahiri erdhi në Korçë me shërbim dhe më takoi. Më tha t’i jepja ç’kisha shkruar. I dhashë katër apo pesë poezi. Ato i çoi te gazeta *Drita* dhe ia dorëzoi Ismail Kadaresë që ishte redaktori i faqeve letrare. Tani, kur kujtoj çfarë i ka thënë Xhevahiri Kadaresë për mua, duke ngritur në qiell talentin tim prej poeti më vjen për të qeshur me përgjigjen që i dha, pas botimit, Kadareja Xhevahirit. Si shumë na e mburre, por poezitë e tij (domethënë të miat) ishin më se të zakonshme. Xhevahiri kishte ngulmuar se nuk ishin dhe aq të zakonshme, se ato nuk ishin poezitë e mia më të mira, se cilat ishin poezitë e mia më të mira e dinte vetëm ai, Xhevahiri, sepse poezitë e botuara ishin të vetmet dhe të tilla mbetën. Ngulmimi i Xhevahirit (sipas dëshmisë së tij) sikur e lëkundti disi Kadarenë, i cili kishte thënë:

- Ja, fillimi i kësaj poezie tregon se ka sens poeti.

Poezia që tregonte se mund të shkruaja poezi ishte kjo:

*Ja, nisën shirat këtu në Tiranë,
Dëborë bie në qytetin juglindor,
Ku nëna më pret të shfaqem,,
Me valixhen e vjetër të mallit në dorë.*

Këto vargje fare mirë mund të ishin fillimi i një tregimi:

*Ja, nisën shirat në Tiranë, në qytetin e vogël juglindor
kishte filluar të binte dëborë dhe ai (poeti) nuk po e kuptonte
kë po përjetonte atë çast, shiun e Tiranës apo dëborën e
qytetit të largët.*



Mirënjohja për Ismail Kadarenë dhe Xhevahir

Spahiun më ka nxitur gjithmonë për të shkruar...

A.D: Nga kinostudioja *Shqipëria e Re*, janë pak filma që kanë mbijetuar si trashëgimi mes brezave, pra që sot nuk shihen veç nga brezat që i panë qysh atëherë, por edhe nga të rinjtë. Disa syresh janë bazuar në romanet apo novelat tuaja. Në ç’mënyrë e keni përcjellë këtë proces?

N.L: E kam thënë edhe në biseda të tjera se filmi i përket regjisorit, se ai është “diktatori” i tij. Nuk kam shkruar ndonjëherë skenar të mirëfilltë. Skenarët janë bazuar te novelat e mia, te të cilat regjisorët shihnin ngrehinën e një filmi. Kam bashkëpunuar me regjisorët Kristaq Mitro dhe Ibrahim Muça për filmat *Dueqje emrin tënd* dhe *Telefoni i një mëngjesi*, regjiori Muharrem Fejzo më propozoi që novelën *Glaukoma* ta ktheja në skenarin e filmit *Mëngjese të reja*, ndërsa Mevlan Shanaj xhiroi filmin *Të shoh në sy* sipas motiveve të romanit *Të jetosh kohën*. Mua më duket se është tepër e vështirë të përputhen tërësisht dy mishërime të jetës së njeriut, mishërimi me fjalë dhe mishërimi me figurë. E jam mirëkuptuar gjithmonë lirinë e regjisorit në trajtimin filmik të nj novele apo romanit.

A.D: Ju i keni sjellë letërsisë shqipe një yjësi veprash, por jo vetëm kaq: Falë jush, në tempullin e gjuhës shqipe janë shuguruar edhe veprat e disa prej autorëve më të rëndësishëm të letërsisë botërore si Kamy, Kundera,



Moppasan, Saramango, Allende e të tjerë. Kur mendoj për të, procesi i përkthimit më kthen gjithnjë te ata manastiret mesjetare ku një murg përkthente e dhjetra të tjerë kopjonin. Si është për ju “të jetoni me letërsinë e tjetrit” sikurse dikur jeni shprehur?

N.L: Përkthimi është shkollë, pasion dhe udhëtim i lodhshëm në pyllin e dendur dhe shpesh edhe të errët të fjalive. Përkthimi, ndryshe nga krijimtaria letrare e një shkrimtari, është përkushtim dhe mirënjohje për gjuhën në të cilën përkthen dhe për gjuhën nga e cila përkthen. Nuk e mbaj mend në ç’kontekst kam thënë “*të jetosh me letërsinë e tjetrit*”, por gjatë përkthimit jam përpjekur që tjetri të mos ndjehet dhe në këtë rast tjetri nuk është shkrimtari i huaj veprën e të cilit përkthej, por unë vetë. Ajo që e vështirëson përkthimin e një veprë është pikërisht shkrirja e modestisë së përkthyesit me madhështinë e shkrimtarit. Përkthyesi nuk duhet të ndjehet i pranishëm, i pranishëm duhet të ndjehet shkrimtari i huaj. Nuk ka gjë më të bukur dhe vlerësim më të madh për një përkthyes sesa pohimi i thjeshtë dhe i çiltër i lexuesit që thotë: *Lexova romanin e... dhe harrova se po lexoja një roman të përkthyer*. Të harruarit se po lexon një roman të përkthyer është arritja më e mundimshme e përkthimit.

A.D: Ju kërkoj ndjesë, pasi kjo intervistë ka një lloj parregullsie e cila shmanget nëse para se ta mbyll, i rendis sërish pyetjet, por kjo më duket e pasinqertë. Ndaj, më lejoni të rikthehem të Nasi Lera si shkrimtar. Ju keni shkruar në të dyja kohët, gjatë komunizmit dhe pas tij. E parë sot prej jush, si ngjan situata letrare e të dy këtyra periudhave?

N.L: Shkrimtari, edhe më jetëgjati, nuk ka dy apo tre kohë. Ai ka vetëm kohën e njeriut. Nuk e di, por kështu e mendoj nenin e parë të kodit të ndershmërisë së shkrimtarit. Çdo shkrimtar, krahas krijimtarisë, përpunon dhe kodin e vet letrar, ku pasqyrohet konceptimi i tij për artin. Shkrimtari i vërtetë shkruan sepse nuk mund të vrasë brenda vetes krijuesin, nuk mund të vdesë duke e lënë të pashprehur dhimbjen për njeriun, për kushtin njerëzor. Besnikëria ndaj këtij kodi, nuk njih sistemi politike, shoqërore apo ekonomike, ai njih vetëm misionin e tij, që është bota e njeriut. Ajo që e mban gjallë letërsinë dhe e bën të dashur për lexuesit është karakteri i saj human, është humanizmi i shkrimtarit dhe, nuk duhet harruar, natyra dhe karakteri i njeriut-shkrimtar.

Sigurisht që një vepër të kapërcejë nga një sistem në një tjetër pa e humbur emocionin e parë, duhet që shkrimtari të ketë gjetur atë që përbën thelbin e pandryshueshëm të njeriut, thelb që zbulohet, për fat të mirë, vetëm nga një talent i madh, prandaj dhe veprat që përballojnë kohën janë aq të rralla. Veprat e mira janë të rralla, jo vetëm në letërsinë e një vendi të vogël (vend i vogël nuk është e barabartë me letërsi e vogël) dhe të një gjuhe që flitet në një hapësirë të kufizuar gjeografike, si është dhe hapësira ku flitet edhe gjuha jonë, por edhe në vend me qindra mijëra kilometra katrore. Letërsia e madhe lind edhe në shkretëtirë. Për ta çuar me tej metaforën, shkretëtira nuk njih sistemi shoqërore, ajo njih vetëm sistemin e natyrës me dukuritë e saj.

A.D: A mund të konsiderohet për ju si kapërcyelli mes tyre pikërisht vepra “Ngjallja e diktatorit”?

N.L: Kjo pyetje dhe përgjigja e saj është vazhdim i pyetjes së mëparshme. Romani *Ngjallja e diktatorit* është pjellë e kohës, ai nuk mund të shkruhej para se u shkrua, sepse kërkonte të kishte një vdekje, që do të ngjallej me synimin për të sunduar kohën me hijen e një diktatori të vdekur. Thelbi i romanit qëndron te përfundimi ku arrin një nga personazhet kryesorë të tij, që shpjegon dhe mundësinë e ringjalljes së diktatorëve në çdo kohë: “*Brenda secilit prej nesh qëndron një diktator i vogël, Që ai të mos bëhet një diktator i madh, duhet ta vrasim pa u bërë i tillë. Në qoftë se nuk e bëjmë këtë, më vonë jo vetëm do ta kemi të pamundur por do të jemi të detyruar të presim vdekjen e tij, duke marrë frymë në një mjedis mbytës...*” Një roman i tillë nuk mund të shkruhej me lirizmin e tregimeve për njerëzit e mirë dhe të ndershëm. Nuk e them dot se romani *Ngjallja e diktatorit* është një kapërcyell mes dy periudhave, ai është vazhdim i një mesazhi human për mos përsëritjen e dhimbjeve dhe dramave njerëzore.

A.D: “Vetmia e syve të qenit”... Nga një interpretim gati naiv i titullit, mund të nënkuptojmë vetminë e një shpirti besnik (sytë = pasqyrë e shpirtit; qeni = besnik). Kjo vetmi a jetohet me anë të shqisave apo përjetohet me anë të ndjenjave?

N.L: Vetmia e qenit, e syve të tij, është mbi të gjitha vetmia e njeriut dhe për ta bërë atë sa më të prekshme, ajo shprehet me anë të shqisave dhe përjetohet me anë të ndjenjave. Njeriu mban pranë qenit për të thyer vetminë e tij dhe kur qeni e thekson këtë vetmi duke u përpjekur t’i ndodhet sa më pranë njeriut, njeriu, shpesh, jo vetëm nuk e kupton atë, por edhe revoltohet me guximin e qenit që me *humanizmin* e tij, thekson egërsinë, egoizmin dhe kafshërinë e njeriut. Qeni në fillim trembet nga ndryshimi i papritur i njeriut, kur atij i bie në dorë një armë, që për kënaqësi, vetëm për një kënaqësi sa të egër aq edhe idiote, provon në është i zoti për të qëlluar në shenjë një qen, që ecën tërë frikë rrëzë mureve, për t’iu fshehur njeriut, që syrin njerëzor e ka kthyer në vrimën vrastare të qytës vrastare.


A.D: Në vitin 2001 keni botuar në gazetën “Drita” tregimin “Tërbimi i njerëzve në sytë e qenëve”. Çfarë ka ndodhur gjatë këtyre dy dekadave që *qentë* të jenë të vetmuar dhe jo më të ngushtuar për të parë *tërbimin e njerëzve*?

N.L: Tërbimi i qenit vjen nga mikrobi i tërbimit që ai e merr nga një kafshë e egër. Po njeriu nga e merr tërbimin, nga arma që ka në dorë apo ai e ka pasur brenda vetes dhe i xxitur nga rrethanat, e shpërthen atë duke shkaktuar viktimë. Kur shkrova tregimin *Tërbimi i njerëzve në sytë e qenëve*, kisha parasysh gjithë dramën e madhe që përjetoi populli ynë gjatë vitit 1997, prandaj dhe tregimi e kërkonte që koha të përcaktohej saktë me një fjali të drejtpërdrejtë si është dhe fjalja që mbyll tregimin:

Ishte viti 1997.

A.D: Në këto tregime, ka raste kur narratori gjendet nën lëkurën e qenit. A ka qenë për ju e vështirë t’i sendërtonit vetëdije deri në kufijtë e ndërgjegjes një kafshe?

N.L: Jo, nuk ka qenë aspak e vështirë, sepse në radhë të parë po shkruaja një vëllim me tregime, ku personazh do të ishte qeni dhe jo një studim shkencor për praninë apo jo te qeni e një vetëdije që e afron me vetëdijen e njeriut. Pra isha i lirë ta shihja qenin si një personazh që gjatë leximit do harrohej se ishte qen, që kur lexuesi të mbaronte së lexuari tregimin, të thoshte me vete: *Me të vërtetë një qen është kaq i aftë sa të jetojë me gjendjen shpirtërore të njeriut?* Ose të pyeste: *A është edhe njeriu aq i devotshëm ndaj natyrës së tij sa është qeni?* Nga përgjigja e këtyre pyetjeve do të arrihej edhe te mesazhi i tregimeve. Devotshmërinë e qenit, do t’iu



lutesha Andreas të më lejoni ta ilustroj me vërtetësive e ditëve kur ngjitesha më këmbë nga Kinostudioja te Fusha e Dajtit. Në fillim ishim unë dhe qeni im, Pupu. Më vonë nga dy vargani që i ngjitej më këmbë malit të Dajtit u rrit me fëmijë dhe të rritur. Unë zakonisht ecja në fund dhe nuk e dija sa ishte largësia nga kreu i varganit, ku ecnin djemtë që donin të tregoheshin më të rritur sesa ishin dhe meje. Këtë e dinte vetëm Pupu. Ai shkante nga unë, fundi i varganit, te kreu i varganit, duke u siguruar se nuk kishte ndodhur asgjë. Sapo shihte që kreu i varganit vazhdonte ngjitjen, kthehej tek unë. Ai e bënte ngjitjen e malit shumë herë. Ç’shtytje e hidhte Pupun të shoqëronte vazhdimisht ecjen e njerëzve? Kjo pyetje mund të ketë edhe një përgjigje shkencore, kurse unë do të bëj vetëm një shpjegim letrar: *Pupun e shtynte besnikërai ndaj natyrës së tij. Pupu nuk e njihte fjalën devotshmëri dhe nuk kishte aspak nevojë ta njihte, ai dinte vetëm se duhej të ndodhej pranë njeriut për ta bërë atë sa më të mirë*. Dhe jo më kot ndjeshmëria e njerëzve që komunikojnë me qentë, është më e lartë se ajo e njerëzve që jo vetëm nuk e njohin por edhe e tallin dashurinë për qenin.

A.D: Pse zgjodhët pikërisht *qenin*, ndonëse duhet thënë se nuk është hera e parë kur *ai* merr rëndësi të veçantë në letërsinë tuaj?

N.L: Pse zgjodha qenin? Sepse ai është fëmijëria ime dhe sepse në vitet e mia të vështira m’u gjend shumë pranë, duke e vuajtur pamundësinë e komunikimit me anën e gjuhës, fjalës. Por ai e vuante kot këtë pamundësi sepse kishte gjithë ato mundësi për të shprehur dashurinë dhe përkushtimin e tij. Dhe kuptohet, në radhë të parë kishte sytë, që nuk dinin të fshihnin, kishte bishtin që e tundte kur ishte i gëzuar, kishte uljen e kokës kur bënte diçka që meritonte të qortohej, kur takohej pas një ndarjeje pak të zgjatur urinonte nga dhe dridhej i gjithi nga takimi sepse me siguri kishte menduar se njeriu i cili e donte aq shumë e kishte braktisur, apo kur e shihte të zotin të mërziut dhe të zhytur në mendime, nuk i pëlqente që t’i mbante duart mbi gjunjët, futej mes këmbëve, shtynte duart e njeriut për t’i vënë mbi kokën e tij. Nga e kuptonte se isha i shqetësuar dhe donte që të ndaja me të shqetësimin tim. Jo, ai nuk e kuptonte, ai e nuhaste, sepse shqetësimi im duhej të kishte erën e vet që vetëm qeni e nuhaste.

A.D: Visar Zhiti ju ka quajtur *Shkrimtar i së mirës*. Mirësia ndjehet në tregimet tuaja, si ai filli i hollë që lidh faqet në një libër. Ndoshta akoma nuk e keni kuptuar. Ndoshta nuk do ta kuptoni asnjëherë, por jam kureshtar të di: nga vjen ajo? Nga ndikimet e librave të lexuar e përkthyer? Nga jeta në tërësi?...

N.L: Sigurisht ajo vjen nga të gjitha ato që thatë, por do të doja të shtoja, se ajo fillon nga fëmijëria, nga familja, nga gjyshja, prindërit, vëllai, motra dhe shokët e mi, ajo vjen nga përgjegjësia që kam ndaj emrit të familjes ku u linda dhe u rrita dhe ndaj familjes që krijova. Letërsia ka vendin e saj, ajo ka ndikuar fuqishëm tek unë aq sa në çaste të caktuara, kur kam ndeshur padrejtësinë, ligësinë, hipokrizinë, dhunën dhe fyerjen, kam thënë, mos vallë do të kisha më shumë forcë për t’u përballur me to, sikur të mos i kisha besuar aq verbërisht librit? Këtë pyetje ia kam barë vetes, por e kam fshirë nga kujtesa duke e lënë pa përgjigje më shpejt sesa lindi.

Mbi poezinë e Lulëzim Hazirit,
përmbledhja “Testamente prej mëndafshi” – cikli Nokturno

SHTATË NOKTURNO – TRISHTIM I RRALLË

Nga Ballsor Hoxha

“Shtatë nokturno” të Lulëzim Hazirit mund të lexohen edhe si një narrativ. Është kalim, nga ndërmjetësia e nemitjes dhe tronditjes. Fillon pas perceptimit të një momenti themelor të ekzistencës, gjë që kalon tutje në ngulfatje nga ky perceptim, si një lloj tërheqje distancim nga – dita -, dhe më tutje në tri notkurnet e fundit, si përfundim i kësaj tronditje, por jo edhe si zgjidhje, në të vërtetë është braktisje, për në strehën e poetit, në “përhënie”, jo si zgjidhje por si ndërthurje me ankthin e të qenit – në distancë nga dita -.

Poeti është i gulfatur nga ankthi, është i nxënë dhe i mbetur ndërmjet, në rezonimin ëndërror të një ankthi të bardhë, dhe kalon nëpër atë duke ndjekur, duke kërkuar, duke pritur dhe duke gjetur “pikën e parë të dritës”. Në të vërtetë, pika e parë e dritës është zhveshur nga çfarëdo konotimi kuptimor, si ditë apo si jetë, dhe është sjellë në momentin fizik të saj. Ai është i fascinuar dhe i tronditur, e tëra është një hapje, si – bëhu – mitike/religjioze (Nokturno e parë), deri në skajin e botës me “krevat të druve nga Laponia”, pa “ti”-në e jetës së poetit (Nokturno e pestë), dhe e cila nuk gjen zgjidhje, as shpërblim, dhe as premtim, por përfundon me narcisizëm/strehim poetik/të poetit në “përhënien” e tij.

Ky është narrativ i të bukurës në trishtimin e saj dhe në kapërcimin e ankthit të një momenti themelor të ekzistencës, apo të natës, të përzgjatjes së natës. Është pritje e durimshme, pleqërore, dhe në kufi të pleqërisë, e kalimit të ankthit universal të tronditjes që pësojmë në vetëdijesimin për temporalitetin e jetës dhe të gjërave rreth saj.

NOKTURN I PARË: Poeti është midis natës dhe ditës “ribëhem çdo ditë”, duke pritur, duke kapur, duke gjetur, duke ndierë “pikën e parë të dritës”. Por kjo është shumë pak për të thënë, ai “ribëhet”, duke qenë ndërmjet “pikës së parë të dritës së ditës” në njërin sy dhe në syrin tjetër që kapë pika tjera të kësaj bote: floku i saj, zverku, aroma, koha.... Por “pika e parë e dritës së ditës” është diku mes trishtimit dhe zbulesës, “dallim-it”, shpërthimit të hapave tepër njerëzor mbi natën. Pika e dritës, ende pa u bërë ditë, ende fije mëndafshi dalë nga vemja, para se të kalojë në flutur “e renditur si

vesë në rrjetë marimange”, është përtej njeriut, është përtej – prapa, në njeriun që ende duhet të ribëhet.

NOKTURN I DYTË: Poeti është në dilemë para po edhe me, ditën. Ajo ngutet, i duhet dhënë peshë, mund “të presë në besë”. Janë ajo që në popull njihet si peshqesh, çdo ditë, e moshës së pjekur. E poeti është përballë gotës së qumështit, e dita shpërfaqet si gota me qumësht, gjë që do të thotë ka një distancë ndërmjet pamjes dhe ditës, ndërmjet asaj që e bën jetën dhe ditës, për poetin. Ka filluar një distancë ndërmjet të dyve. Por nuk ka frikë, nuk ka keqardhje, nuk ka dorëzim as para fajit të “territ të kënaqësisë”, nuk ka as rezignim. Poeti e pret ditën siç e ka falur po e njëjta, edhe pse dilema e distancës ndërmjet të dyve, që ka filluar, është e paikshme..

NOKTURN E TRETË: Një herë është drita, e ftohtë dhe e nxehtë, e pastaj edhe trupi i femrës që e ndien të ftohtë e të nxehtë. Aq më shumë para ditës, poeti, esull është me zjarm. Por më pas është trupi i femrës që e bën të gjallë këtë mish, trupin e tij. Merkuri, si planet më i ftohtë dhe më i nxehtë është ana e vetëdijshme e poetit. Por në anën tjetër, ai e “kthen zemrën që i jepet”, për dashuri apo për jetë, për të mbetur gjallë në këtë paradoks, para se të – ribëhet – dhe të nisë drita dhe dita. Këtu frymon dashuria në të vërtetë, trupa që bëjnë njëri tjetrin, njerëz që i falin zemrat njëri tjetrit. Ndosh-ta këtu lind zemërimi i paradoksit të të ftohtit dhe të nxehtit njëkohësisht, në temporalitetin fizik të kësaj dashurie.

NOKTURN I KATËRT: këtu poeti tanimë zbret në të “untë për vakt”, dhe drita gjithnjë e më vonë del mbas mali, por edhe “i dehuri nuk ka gjetur ngushëllim në pije”. Ka filluar të tregoj për turbullimin, për brengën, për mundimin e tij. Tanimë nuk është bukuri trishtuese dhe zbulesë në të njëjtën kohë, tanimë është e qartë drita nuk është ditë, është vetëm dritë, është vetëm, dhe e zhveshun kuptimeve etj. Është nevojë esenciale fizike.

Poeti tregon edhe më shumë në këtë ndërmjetësi nate dhe dite, në këtë pritje: sa më vonë që del drita, aq më herët ai zgjohet, ta pres atë i pari. Dhe ta përcjellë



i fundit.

Por tanimë – distanca – ndërmjet poetit dhe ditës është edhe ironi, ajo më nuk gjen “ngushëllim në pije”, në poetin.

NOKTURN I PESTË: poetit i mungon “çdo gjë që s’është në këtë dhomë”, dhe më tutje ai vazhdon duke thënë “siç më mungon ti”. Ka pranuar edhe se është në “moshën e butë” dhe ndien peshën e trupit. E në moshën e butë është vështirë pa dashurinë, pa një “ti”. Qoftë edhe në skajin e botës, në shtratin e ndrequr nga drunjtë e Laponisë, në ndërmjetësinë e pakufishmërisë që krijon vetë skaji, fundi, në qetësinë e kësaj pafundësie, dhoma, mvëshur me zemërimin për veset e parregullsisë, është fundi i vërtetë, fundi, jo si vdekje por si kufi, i të gjallit me moshën e butë në trup, e me tërë atë që i mungon përballë këtij kufiri.

NOKTURN I GJASHTË: Poeti tanimë është në ndikimin e trishtimit të të bukurës, të paradoksit të rendit të bukurisë, me lulet që çelin në vjeshtë. Është në të vërtetë çdo çast i vëzhguar, i matur, dhe aq më shumë “këmbëzbathur”. Vjeshta dhe lulet që janë aq të ndjeshme që bien pa i prek. Por disi tutje në trishtim, edhe më thellë, ai, poeti, kalon në tablo të Matisse, vizuatuar nga vjeshta, është i ndërmjetëm vet, është i pëshqjellur dhe tutje është i vizatuar këmbësh, sikur ato janë shtjerrë, kanë mbetur tutje-prapa në kalimin dhe temporalitetin.

NOKTURN I SHTATË, E FUNDIT: poeti tanimë është “lezuar”, është përhënur, është në ikjen e tij, në gjetjen e tij, në strehën e tij. Në të dielën e tij.

Ajo që ndodh në këto pjesëtime të natës me ditën, në këto momente të kapjes së këtij pjesëtimit, as më shumë as më pak, është ribërja, rikthimi në jetë; më tutje gjetja e një pike të dritës për të kapur ditën. Dhe më tutje, kjo është gjithnjë në raport me “ti” në e poetit, me atë që poeti mund t’i thotë “ti”. Në tërë këtë, ribërja, pika e dritës, dhe ajo që është pranë tij, janë në të vërtetë rikthimi i poetit në dëshminë themelore të jetës. Në dëshminë e cila ruan dhe peshon jo vetëm të kaluarën, por sidomos të tashmen e tij. Konfirmon në është këtu.

Më tutje këto tri shkallë të këtyre poezive krijojnë një ndërmjetësi, një çarje të prekshme dhe të kapshme, të gjatë dhe të ankthshme, ndërmjet natës dhe ditës, ndërmjet pikës së dritës dhe – pikës – së jetës, të kaluar. Kjo ndërmjetësi është kalimi i njeriut nga shumësia, pafundësia e kotësisë së kuptimeve, në themeloren dhe në të paikshmen e tashme, të prezencës, prej nga pritët pika e dritës. Në të vërtetë në të gjitha këto Nokturno/poezi, vëzhgimi është nga momenti i kapjes së jetës, në të vërtetë rikthimit të jetës, ribërjes së jetës, si zbulesa. Pikërisht kjo duke dhënë të qartë thellësinë e vëzhgimit të kësaj ndërmjetësie, aty ku njeriu e gjen jetën të kaluar, të kalueshme, që duhet ribërë.

Në tërësinë e tyre, dhe veçmas, këto nokturno shprehin zemërimin e njeriut ndaj tërheqjes së fuqisë së njeriut, zemërim i cili shprehet dhe poetizohet në bukuri të ankthit të jetës, të kalimit të tronditjes në jetë, dhe të vetëdijesimit mbi veten në tërheqjen e tij.

Bukuria, në të vërtetë është vetë iniciimi dhe kërkimi i këtyre nokturnove. Por nuk është bukuri e zakonshme, është bukuri e ankthit dhe trishtimit, bukuri e rrallë, e cila flet për veten e saj.

Në të vërtetë kjo bukuri është pikërisht “pikat e dritës thurur si vesa në rrjetë merimange”, edhe ankth, edhe mungesë zëri, edhe bukuri që shpërfaq lindjen dhe tranzicionin e njeriut në kohë.



Ku takohen dhe ku ndahen Kompleksi i Edipit Me Baladën e Rinjohjes

PËRQASJE MES “EDIPIT MBRET” TË SOFOKLIUT DHE NJË LEGJENDE TË VJETËR MIRDITASE

Nga Ndue Dedaj



(gjashtë orë prej shtëpisë së tij), që s’duhet të jetë as i ri, as plak, mban vesh me ankh. Mendon për një çast se mos ajo grue asht bareshë që ka humbun dhitë e ka dalë t’i ndjellë nëpër natë. Nga maja e malit përkarshi i përgjigjet një za tjetër grueje, me piskamë ma të fortë e ma të thekshme, që bani me ushtue krejt bjeshka për-reth:

“Tash i leu një djalë (përmend emrin e tij), si t’ia caktojmë nafakën?”

“Me vra Babën e me marr për grue Nanën!”

Kishin qenë dy zana a orë mali që kishin folur ashtu duke i parathënë fatin i zi, njëlloj si orakujt. Po endej filli mitik i tragjedisë së madhe të atij njeriu të ngjuar në atë vetmi bjeshkësh. Si një stuhi që nuk do të dinte të ndalej vetëm te ai si individ.

Zanat, gjer vonë, ishin lajmëtare të gëzimeve dhe fatkeqësive të maleve. Ernest Koliqi ka një tregim me titullin “Zanat lajmojnë”, ku zana iu “thotë”, përmes shëmbëllesës së 6-7 të shtimeve me armë natën, dy komitëve të fshehur në shpellë se brenda shtatë ditësh njëri nga ata nuk do të ishte gjallë. (Kishin vlarë njerëz të qeverisë gjandarmëria i gjurmonte pa pushuar)...

Përmbajtja e tragjedisë “Edipit Mbret”

Bash kur Edipi Mbret i vihet detyrës për të vënë në vend nderin e humbur të ish-Mbretit që kishte sunduar Tebën para tij, dmth të Mbretit Edip, që i kishte rënë mbi kokë “mynxyra” (me gruan e të cil-it tashmë bënte shtrat), në skenë del një personazh i çuditshëm me emrin Tirezja. Ngaqë ky “rrok me mend gjithë sendet”, Edipi Mbret i lutet t’i zbulojë të vertetën e vrasjes së Lajos, duke shlyer kështu çdo njollë që shkaktoi ajo vrasje, e për më tepër, duke shpëtuar qytetin, nderin e fronit, pushtetit, përfshi dhe lavdinë e së shkuarës. Por Tirezja e kupton se “asht e tmerrshme” për njeriun të dijë ato gjëra që s’ia lejojnë t’i dijë. Nisur nga deviza e tij “Më jep forcë e drejta”, ai guxon ta akuzojë hapur Edipin Mbret se ai është e keqja “që këtë tokë molepsi”, edhe pse do të kërcënohej egër. Tirezja nuk është profet mitik si Orakulli i Delfit që i nuhat gjërat, por një “profet i vërtetë” që i ka parë ndërgjegjet e trazuara e gjëmat dhe nuk mund t’i ndryjë në vetvete. Paralajmëron verbimin e Edipit (“tash sytë i ke të mprehtë, ma vonë me ta veç errësirë do të shohësh”), cek martesën me Jokastën, që do ta qesë në “liman të kobshëm.” Edipi Mbret që nis të kuptojë diçka mallkon fatin që “të madh e bani” Tirezja i pamëshirshëm vijon të fshikullojë vrasësin:

*nga pasanik fill lyparak do bahet
e qorr me shkop do bredhë në dhë të huej;
sheshit do të dalë se me t’ bijtë ai ishte
vëlla babe, dhe bir e burrë me gruen
nga e cila u lind, bashkëshort martese
e vrasës i babës së vet.*

Në pak vargje, me persosmëri, është sintetizuar, një nga formulat unike të kodit moral të njerëzimit, që në pamje të parë ngjan me një rebus anekdotik, sofistik, të paftillueshëm. Pikërisht mbi këtë hetohet aty në Pallatin Mbretëror të Tebës, njëherësh duke u bërë Gjyqi i Madh i vetë atij që kryeson Hetimin (Zbulimin), pa e ditur kurrësesi se vetë ai ishte protagonist i fatkeq i vargut të ndodhive tragjike. Është shkelqimi i parë dhe gjyqi i fundit i Edipit Mbret, që nuk do të mund të ishte mbret i Tebës, siç kishte qenë paraardhësi i tij. Në betejën për të drejtën ndërhyr dhe Kreonti, kunati i tij, vëllai i Jokastes, i zemëruar dhe ai, duke e grishur të shkojë vetë në Delf për të mësuar të vertetën. Nuk mund të rrijë mënjatë Jokasta, mbretëresha me dy kurorë mbretërore e martese radhazi; sjell “prova të qarta” para Edipit, se Lajos, Orakulli i pati thënë se atë do ta vriste i Biri, “që bashkë me të do të lindja unë”- kurse Mbretin e vranë, siç qe hapur fjala, disa hadutë të huaj në kryqëzim triudhësh. Djalin, tri ditë pas lindjes, përmes shërbetoreve, ai (dhe ajo) e kishin flakur në një greminë mali, pasi Apoli nuk lejoi që ai Djalë të ishte nesër vrasësi i t’Et. Kur Edipi pyet se ç’pamje e ç’moshë kishte patur Lajo, ajo i përgjigjet “diçka në ty shëmbëllente.”

Në vetëdijen e Edipit Mbret gjërat fillojnë të përqasen e lidhen.

“...Edipi nuk e kishte vlarë të atin. Dhe as kishte fjetur kurrë me të ëmën. Ishin shëmbëllime krimesh të mundshme, që u shpallën si të kryera ndërkaq, ditën që ai ishte bërë tiran... Ditën që ai (tirani) e merrte kurorën, ato zhvendoseshin nga koha e pritme, ajo që ende s’ishte, drejt së shkuarës, për të mbërritur gjer në strehën më të sigurt, në zgrof të nënës...”

Ismail Kadare, “Lulet e ftohta të marsit”, Onufri, 2000.

“...Natën e martesës, kur shkuen me ra, qielli u terratis, gjamë e bubullima gjemuen, një shi i imët prej gjaku filloi me lag tokën...”

Legjenda. Sfondi i tragjedisë antike

Teba e njohur ka filluar të brehet nga murtaja e zezë, çka ka shkaktuar një tronditje të pashoqe tek të gjithë tebanët. Mblidhen aty në oborrin e Pallatit Mbretëror njerëz të shumtë të gjuhëzuar duke u lutur para altarëve. Pamjen e bën më solemne prania e një prifti të Zeusit, i cili rri vazhdimisht në këmbë, si dhe e korit prej 15 vetësh të Parisë së Tebës. Të gjithë janë në ankth dhe presin nga do të shfaqet rrezja e shpresës për shpëtimin e tyre. Dhe vjen mes tyre heroi teban, mbreti me emrin Edip. “Çdo gja po shuhet. Frytet e tokës në lulesë po thahen. Kopetë e gjedheve në kullotë po ngordhin. Foshnjat pa le vdesin në bark të nanave”. Prifti që i flet kështu Edipit dhe gjindjes së atyshme shpalos përmasat tragjike të zezonës që ende nuk dihet se për ç’shkak madhor po e fundos Tebën, aq sa vetëm “Hadi i zi po ngopet me kuje e gjamë.”

Në atë “tërbim hyjnisht”, “murtajë mizore” sytë e gjithkujt drejtohen nga Mbreti, Edipi, duke e kërkuar aty Shpëtimtarin. Por a është ai i mundshëm të jetë i tillë? Natyrshëm i drejtohet Orakullit të Delfit, i cili nuk vonon të përgjigjet: “Lipset patjetër të zbulohet një orë e më parë vrasësi i ish- Mbretit, Lajos, që të zhduket murtaja”. Kori mitik cilëson një treshe (Athinën e pavdekshme, Artemidën dalzotëse, Febin lartshigjetues) që ka fuqi të zbojë murtajën, çka duket se do t’i vijë në ndihmë Edipit, që i kërkon Korifeut që të gjithë Kadmejt ta mbështesin në përmbushjen e misionit që i buron nga “pushteti” e “froni.”

Një botë tipike antike: Hyj, orakuj, mite, gjamë, të vramë, gjakës e gjaksorë (të dukshëm e po aq të padukshëm), si në Kanunin Shqiptar të Maleve, rrëpirave të tij. Edipi, edhe pse Mbret Fuqiplotë, krejt si një malësor i thjeshtë bën be sipas zakonit se vrasësi i ish-Mbretit nuk kishte dijeni “të fshihej në shtëpinë e tij.” I nxit ndërkaq tebanët që kurrësesi të “mos e lënë në harresë Vrasjen pa e shpague gjakun”. Me zell të veçantë i pari vihet në kërkim të vrasësit të Lajos, gjithnjë në emër të drejtësisë.

Pa e ditur se kjo sipërmarrje, sa fatlume për Tebën, aq fatale do të ishte për atë vetë.

Pa e ditur se kobi ishte dhe më tronditës se dukej-ngaqë vrasësi kishte qenë i ndëshkuar nga fati i pashëmbullit të vriste t’Atin dhe të martohej me t’Amën.

Pa e ditur se vrasësin që e kërkonte gjithkund e gjithëkah e kishte më pranë se çdo njeri tjetër mbi dhë, e kishte brenda vetes.

Sfondi i legjendës shqiptare-mirditase


Legjenda vjen pa një emër, siç kishin qenë të tilla në mitologjinë greke dhe legjendat për Edipin, gjersa ato të merreshin në dorë nga shkrimtarët. As koha e ngjizjes së saj nuk dihet, por mungesa e adresimeve (njerëz, katunde, krahina, male, tempuj) duket se dëshmon për tejlashtësinë e saj, dhe sidomos për natyrën përgjithësuese, pa u ndalur në faktin se ajo nuk është e vetme në përmbajtjen e saj.

E mbledhur nga studiuesi i njohur i visareve të Mirditës, Kolë Shtjefni, diku në Mirditën e viteve ‘30, ajo është botuar në librin e këtij autori: “Mirdita - doke e zakone” (1998), dhe aty jo si legjendë më vete, por në pjesën ku trajtohen ritet që lidhen me lindjen e

fëmijës. Legjenda është mbledhur në mënyrë spontane, si material folklorik dhe jo me pikësynim si e tillë. Rrëfimtari i saj ka qenë i vonë, i ndikuar nga e folmja e kohës, ku nuk kanë shpëtuar dhe huazimet turke, si fjala sahat etj. Kjo gojëdhënë është të paktën e kohës së baladave të tjera shqiptare të Rinjohjes, Murimit etj., edhe pse mbase me një fillesë më të hershme.

...Një njeri, në një stan, mes bjeshkëve të larta të kredhura në vetmi të plotë, njëlloj Olimpi shqiptar pa Zota. Nuk kanë emër, por mund të jenë bjeshkët e Munellës, Livadhut të Hamzit, Oroshit, Selitës... Ka patur mjaft legjenda e gojëdhëna të spikatura që lidheshin me këto bjeshkë të epërme, ashtu si dhe me Velën apo Bjeshkët e Namuna qindra kilometra larg tyre. Njeriu i atij stani nuk është Mbret, Plak, Kapidan i vendit. Ai është thjesht një mirditas i vorfën, i mocëm, që ka dalë në pyll të presë drurë për të bërë bulira uji për t’i shitur, që të fitojë bukën e gojës. “Katundi ku kishte shtëpinë ishte larg prej atij vendi rreth gjashtë sahat rrugë”.

Ka megjithatë një përmasë dramatike të mirëfilltë. Natë, vetmi e plotë, një njeri si i ndryrë në një stan, jo rastësisht të largët. Rri pranë vatrës dhe pi duhan i menduar, i përhumur, gati në kufijtë e përtejbotës. Edhe pse nuk ka shkelur kurrë në saraje mbretërisht



e nuk di nga punët e tyre, kjo nuk do të thotë se ai nuk mund të kishte një fat si të tyre, kur ishte fjala për dramë. Ani pse perreth tij nuk kishte teatër antik, Eskil, Homer, Euripid, Sofokli, që atë që atij i kishte ngjarë në vetmin e maleve ta shihnte pas disa kohësh në skenë. Atij do t’i duhej të ishte vetë dhe “heroi” dhe “shkrimtari” anonim i veprës së tij. Ai do ta shqiptonte ndodhinë e ajo do të shkante gojë më gojë, kohë pas kohe, vend pas vendi.

...Teksa bluen me mendje të fshehtat e jetës, të cilat nuk ka mundun me i zbulue, befas ndjen një za femre që piskat tue thirrun shoqen e vet. Burri i asaj vetmie të madhe, të atij pylli të largët

Të ishte rëstësore profecia e orakullit për Lajon dhe profecia tjetër, ajo e atij vetë? Ai dinte se kishte për babë Polibin e Korintit dhe për nënë Meropë Doriden, por në një gosti, njëherë, një i dehur, bafas kishte thirrur *DJALË I GJETUR*. Djaloshi Edip që i kishin djegur ato fjalë shkon në Delf të gjejë ngushëllim e shpresë, por atje Febi i profetizon *“punë të shëmtueta, të llahtarshme e të kobshme”*: do të “bënte shtrat” bashkë me nënën e tij, pjellë të zezë me të në dritë do të qiste, e, për më tepër, do të vriste babën që e kishte lindur! Ishte kjo arsyeja që ai kishte frikë të vente më te prindërit e tij në Korint dhe pse kishte mall. Ai do të vente atje vetëm kur Polibi dhe Meropa të kishin vdekur, kur nuk do ta kishte më të mundur të bënte mëkate- të vriste të atin dhe të martohej me të emën. Ai i trembej më fort se vdekjes këtij kompleksi të përbindshëm, “kompleksit të Edipit”.

Pikërisht kur Ai nuk donte të besonte se Edipi i Polibit ishte bir i rremë i këtij dhe bir i vërtetë i Lajos, Korintasi sjell dëshminë më të rëndësishme të atij Gjyqi:

“Or ty Polibi as në farë as fis s’të kishte”

.....

“Nga duert e mia ai ty dhuratë të mori.”

I rrëfen si e kishte gjetur në pyjet e Qiteronit. Pastaj shpërthimi i Jokastes “Kurrë mos e ditsh ti, o faqezi, kush je!” Mallkim nëne, gruaje, a të dyja bashkë? A mallkim perëndie? Tashmë Edipi Mbret nuk ishte bir i askujt: i Polibit e Meropës jo e jo, po as i Lajos e Jokastes - ishte vetëm Bir i Fatit. Gjithçka e vulos dëshmia e fundit e bariut plak, i cili kishte rrojtur gjatë për të vërtetuar se atij i qe besuar nga dy prindërit mbretërorë tretja e birit të tyre, po atij nuk ia kishte bërë zemra ta treste foshnjën Edip në greminë...

Edipi Mbret, njeriu më rrezikzi në botë, dritën do ta shihte për herë të fundit. Ai i kishte kryer mëkatet e renda pa e ditur. Kori do ta përcillte kufomën e fatit të tij (si ndëshkim ai do të vazhdonte të rronte për të vuajtur, shpaguear) me fjalët klithëse:

...I njëjti prehër t’përit

si Bir e Babë e Burrë.

Djali i Gjetur, Biri tragjik i Fatit, kishte zgjedhur si shpagim nxjerrjen e syve të vet, që të mos mund ta shihte më atë botë, që i kishte sjellë fatin më të pashembullt mbi fytyrë të dheut.

Përmbajtja e legjendës mirditase

...Me të zbardhur drita në maja, Burri merr udhën për në shtëpi. Gratë e fisit që kishin shkuar për t’i shërbyer së shoqes lehonë, i dalin përpara gjithë gaz për t’i dhënë sihariqin e lindjes së djalit të vetëm që i kishte falë Zoti. Ato gati sa nuk vallëzojnë nga hareja. Por ky që e dinte kobin, se fëmija nuk kishte lindur për të mirën e tij, përkundrazi me fat të zi të parathënë, i përmbajtur, veti tipike e mirditasve, nuk shfaqi asnjë shenjë gëzimi. Gratë u çuditën dhe disi të fyera u larguan, pa e kuptuar shkakun e zymtësisë së atij burri. Në shtëpinë e tij nuk i tha asnjë fjalë urimi, në skaj të oborrit nuk i shti asnjë pushkë, siç ishte zakoni, që lajmëronte me të shtëna “ardhjen e bardhë” në jetë të një djali, aq më tepër të një djali të vetëm, që do të çonte më tej brezat e atij barku. Kur mbetën vetëm, Burri i thotë së shoqes:

“Grue, ky fëmijë nuk asht i hajrit. Kur të rritet Ky do t’më vrasë Mue! Prandaj ma mirë po e mbys unë qysh tani”.

“Burrë, mos ke luejt mendsh? A e din se çka po thue!”

“Jo, Grue, nuk më ka luejt mendja, po asht puna kështu...”

Dhe i rrëfeu fill e për pe të fshehtë e frikshme të një nate më parë, përcjellë përmes fjalëve të zanave apo orëve. Kur ajo dëgjoje se foshnja e saj do të kishte fatin e zi, jo vetëm të vriste t’Atin, por dhe të martohej me t’Amën (dmth me atë vetë) i shkuan të dridhura nëpër shtat. Djali që po i jepte gji u ftoh mbi gjoks dhe i shëmbëlleu sakaq me një gjarpër... Vendimi u mor përnjëherë. Fëmijën e porsalindur e lidhen në djep në shpërgenj të rinj dhe e hodhën në një lumë që rridhte aty afër. Djepin e mori rrjedha e atij lumi malor dhe e shpiu shumë larg atij vendi. Diku në atë lumë merrte uji një vijë mulliri, ku bluante katundi i largët. *“Valët e lumit i dhanë krah djepit kah vija e mullinit dhe ai bllokoj ujin. Mullisi doli me një shatë në krah për me pastrue grykën e lugut. Sa futi shatin n’uij, iu ngatrrue në rrathët e djepit. Tërhoqi shatin dhe nxori djepin sipër. Fëmija ishte gjallë. Me të shpejtë e mori djepin dhe e çoi në shtëpinë e tij...”* I tha së shoqes ta ndërronte, ta afronte pranë zjarrit, mbase dhe të gjente në katund një grua për t’i dhënë gji, kurse vetë doli të kërkonte t’Amën e djalit, që sipas tij, duhej të ishte mbytur në uji në përpjekje për të kaluar lumin me djep në shpinë. Por askund nuk u gjet ajo, as gjallë, as vdekur.

Mullisi dhe e shoqja nuk kishin fëmijë, ndaj e rritën vetë *DJALIN E GJETUR* si të ishte i tyre, me gjithë të mirat, si djalë mbreti, siç thuhej. Dhe ai Djalë vetëm ata të dy njihje për babë dhe nënë.

Legjenda vijon subjektin e saj. Kur Djali u rrit, u bë bari delesh. Kishte një tufë shumë të mirë. Shtegtonte me berre (bagëti) krahinë më krahinë për të gjetur kullosë të freskët e të bollshme. Ishte njëzet vjeç, kur, pa e ditur, u gjend rastësisht në katundin (ku kishte lindur). Aty delet morën turr e hynë në një livadh të huaj ku dëmtuan barin, teksa bariu ishte harruar duke luajtur me një bari tjetër. I zoti i livadhit doli nga shtëpia me vrap me një shkop në dorë të nxirte ato dele damçore nga livadhi. Prona për të ishte e shen-

jtë, e pacenueshme, ndaj ashtu i zemëruar në kulm, i karmoi delet duke u rënë më shkop ku të mundte. Kur Djali bari pa atë skenë të dhunshme mbi tufën e tij, që s’kishte guxuar t’i afrohej as ujku, i bërtiti me të ashpër të zotit të livadhit. Por tjetri iu përgjigj me të egër:

“Hidhu, hidhu këndeje, se për qiell e për dhë, bri pa të thye me këtë shkop nuk po të la, e shpinën po ta baj ma të butë se barkun!”

Djali i marruar s’përiti më, po nxori topanxhën (koburen) nga brezi dhe ia rrsi në gjoks atij Burri duke e lënë të vdekur.

“Kështu ai (Djalë) vrau Babën e vet”.

Pa e ditur se ai burrë mbi të cilin kishte shtirë pa iu dridhur dora kishte qenë i ati. Ku ta dinte ai se fati i tij kishte qenë i parathënë nga zana e malit, njëlloj si fati i një mbreti helen, nëntë male përtej, Edipit, të cilit gjithashtu fatin ia kishte parashkruar orakulli i Delfit, njëlloj zane e atyre viseve të largëta. Si zanat e orët, dhe orakujt vinin nga kohët pagane.

Ende ai Djalë nuk dinte, se njeriu i sapo vlarë prej tij, njëzet vjet më parë, për të shpëtuar veten, gruan, jetën, nderin e familjes e të mbarë dheut nga një mëkat i padëgjuar e i pashembullt, kishte kryer vetë një krim vrasës, po ashtu të padëgjuar e të pashembullt, me vetëdije të plotë ai kishte “vlarë” djalin e tij të vetëm, të nesërmen e natës që kishte lindur, duke e flakur me gjithë djep në lumë... domethënë kishte kishte hequr qafe si një djall pikërisht atë djalë që sapo kishte shtirë mbi të, kur ishte bërë njëzet vjeç, e nëse fati



do të kishte qenë tjetër, ai Burrë tash duhej të ishte duke iu gëzuar dasmës së të Birit.

Pleqtë e Maleve, që shquheshin për gjyqësi shembullore, që kishin zgjidhur ngatërresa nga më të vështirat, nëse asokohe kishin ardhur në fuqi (pasi mund të jetë ende tepër herët për ta), a do të mundnin në të vërtetë ta kapnin fillin e atij lëmshi aq të ngatërruar nga ajo profecia e zanave të malit, para të cilave ishin gjithmonë të pazot, si para një fuqie hyjnore.

Epilogu tragjik i Edipit Mbret

...Ka rënë më në fund sipari i gjyqit të madh, gjyqi i fatit (i një Biri të Fatit), gjyqi i rrallë i epokës homerike, ku mungon shkëlqimi i betejave. Kanë dëshmuar me hir e me pahir të gjithë, në emër të së vërtetës, dhe pse ajo do të trondiste fate njerëzore, por do të shpëtonte Pallatin, Tebën, lavdinë, botën. Edipi Mbret asnjëherë nuk u bë dot Mbreti Edip, si paraardhësi i tij. Edipi, Mbret?! Sikur kishte dyshim, cinizëm, në mos tallje në këtë shqiptim të tebasve. Si ka mundësi? Të jetë bërë Mbreti ynë ai që vrau të atin e u martua me të emën (!) Edipi, Mbret?... Jo, nuk është e mundur.

Edipi i ikën fatit të keq që e ndjek nga pas mizorisht si hija e vdekjes, po loja e rrezikshme e fatit është gjithnjë një hap para tij. Ai beson se e ka përjashtuar fatin, por fati, pa e kuptuar e ka vënë

poshtë, e ka mundur, e ka propozur. Askush nuk mund ta shpëtojë më, as fëmijët e tij, monstat më tragjike të kësaj bote. Një soj “klo-nimi” antik. Edipi, tashmë *“plaku i verbër i palëvizshëm”*, i nëmuri i fatit, do ta presë vdekjen paqësisht, duke i ardhur rreth me përndërim mbarë populli, shpëtimin e të cilit do ta sigurojë shtatorja e tij.

Epilogu fatlum i Birit të legjendës

Me qenë se i Vrani nuk kishte djalë, as kushërinj, e nuk kishte kush t’ia merrte gjakun, Djali bari që e kishte vlarë sillej lirisht e pa frikë atyre anëve duke kullotur si më parë tufën e tij. E Shoqja e të vlarit kishte mbetur e vetme, e ve. Djali ia çon delet deri afër shtëpisë së saj, në megjat e arave. Ajo i thotë:

“More Djalë, pashë tokë e qiell, m’u hiq qafe me këto berre, se mjaft ta kam pa sherrin; më vrave burrin e më fike konakun, he ty Zoti të vraftë!”

“Mos më nam, fisnike, e di dhe vetë se kam gabue, por rrezik pas-ka qanë! Veç po të jap fjalën e burrave, se, për çdo nevojë që ke me pas, më thuej mue, se kam me t’u gjet dhe kam me të ndihmue, në punë bujqësie e ku të duesh ti, e do të mundohem me e pague (mund të lexohet dhe shpague) gjynafin (mund të lexohet krimin) që kam ba”.

Gruaja e ve u prek prej fjalëve të djalit bari dhe atë ditë e mbra-pa mes tyre filloi miqësia.

“Nuk shkoj shumë gjatë dhe ata vendosën të martohehin bashkë”.

“Natën e martesës kur shkuan me ra (me fjetë) qielli u terratis, gjamë e bubullime gjemuen, një shi i imët prej gjaku filloi me lag tokën. Një pëllumb i bardhë fluturimthi bjen në mes të dyve. Zot, çka asht kështu? Çfarë mrekullie ka ndodhë?”

Të trishtuar nga ndodhia e pazakontë, të dy kërcyen me të shpejtë prej shtratit për të mos rënë më bashkë aty. Pëllumbi u zhduk dhe shiu prej gjaku pushoi. Me të zbardhur drita shkuan me pyet një të dijshtëm se çka mund të ishte kjo mrekulli. I dijshtëmi u tha:

“Ju duhet të jeni Nanë e Djalë e s’ka si të jetë ndryshe!”

Djali u kthye mënjëherë te mullisi, e pyeti në ishte me të vërtetë djali i tij apo jo? Dhe ky ia shpjegoi hollësisht, fije e për pe, se si kishte pas ndodhur”.

U zbulua gjithçka dhe Nanë e Djalë u përqafuan me lot për faqe. *“Fjala e Orës u ba amen për çudinë e gjithkujt...”*

Ku takohen dhe ku ndahen tragjedia antike greke me legjendën mirditase.

Kompleksi i Edipit te helenët, motivi i Rinjohjes te shqiptarët.

I. E para gjë që duhet vënë në dukje se njëra është vepër e letërsisë antike, kurse tjetra është një prurje folklorike, gojëdhanore.

Si shumë veptra të tjera të antikitetit grek, edhe “Edipi Mbret” është ushqyer nga miti, legjenda. Miti mbi Edipin është trajtuar dhe te “Edipi në Kolonë” po të Sofokliut dhe te Seneka. Edhe në letërsinë e kohës së re figura e Edipit ka frymëzuar shuma autorë, si Kornejn, Volterin etj. 2 Miti është vetëm pikënisja, pasi komponentët e vepërës i janë nënshtruar përpunimit artistik, duke krijuar një vepër komplekse me një subjekt të dukshëm dhe një tjetër “të padukshëm” që zbulohet vetëm në fundin e vepërës.

Edhe legjenda mirditase e Djalit të Gjetur (që Vret të Atin dhe Martohet me t’Amën) është e brumit popullor, porse ajo vjen ashtu si në fillësë, siç është ngjizur, e virgjër, e papërpunuar. Megjithatë të gjitha elementet e *kompleksit të Edipit* i ka dhe ajo, me përjashtim të aktit final, të kurorëzimit *de fakto* martesës së birit me nënën e tij. Këtu legjenda devijon nga ky kompleks universal, duke ruajtur ngjyrën thellësisht shqiptare, atë të mitivit të Rinjohjes, që natyrisht është i njohur dhe në popuj të tjerë të rajonit ballkanik. Martesa *de jure* e djalit me nënën e tij e rrit dramacitetin e vepërës anonime.

2. Në gojëdhënë mirditase ndjehet i largët mjedisi i lashtë e hijerëndë ballkanas, me kështjella, pallate mbretërore, altare të shenjta, që për çudi toka e Mirditës i ka patur të shumtë; po ashtu mungojnë dredhitë, kurthet, kulisat, intrigat, shërbetorët, kori antik etj. Përkundrazi dekor i është gati ekzotik, malor, bjeshkëtar, thuajse baritor, i papërpunuar nga fantazia e rrëfimtari, dekor aspak skulpturor e monumental, i pagdhendur nga dalta e mjeshtërvë të gurit, as nga ajo e rapsodëve që kishin skalitur në vargje epose të madhërishëm, balada në zë. Duket në pamje të parë se një ndodhi si ajo ka qenë në periferi të ndërgjegjes kolektive të banorëve të maleve. Rrëfyesit të rastësishëm i ka mjaftuar të thotë gjënë e veçantë, që është e vështirë ta besojë. Megjithatë këtu mbase qëndron madhështia e tragjikes së saj, pasi është ruajtur natyrshmëria, pa u ngarkuar me epicitet të panevojshëm etj.

Edhe pse ajo nuk ka patur fatin të njihet e shqyrtohet nga filologë, mitologë, estetë, psikologë, ajo vjen krejt e përqasshme në përmbajtjen e saj me tragjedinë greke mbi dy mijë vjeçare që ka mrekulluar dhe tronditur njëherësh mendjet dhe ndërgjegjet njerëzore. Nëse me kompleksin e Edipit janë marrë gjenitë krijues të kohërave, filozofët, shkrimtarët, aq më tepër popujt, me legjendën

(vijon në faqen 8)

(vijon nga faqja 7)

mirditase nuk është tronditur askush, përpos një çasti të vetëm kur befas është shqiptuar kumti i zanave për fatin e atij djali të sapolin-dur. Ky është nganjëherë fati i krijesave të anonimatit. Veçse ato nuk kanë nevojë një industri të tërë shkrimi e teatri për t’u mbajtur në këmbë e për t’u përcjellë shekujve, pasi u mjafton thelbi i tyre rrezatues, përjetësisht i pandryshuar.

3. Pavarësisht nga disa fjalë, që me siguri janë shtuar më vonë, si *baft*, *nafakë*, *topaxhë*, *konak*, mosha e legjendës duhet të jetë e lashtë, të paktën e kohës së lulëzimit të baladave të njohura të Murimit në kala, Vëllait të Vdekur e Rinjohjes. Ndjehet në të koha pagane, pasi nuk përmendën elemente të krishterë, ndikimi i Kanunit etj. Mungojnë adresat kohore e vendore. Është nje mjedis tipik gati idilik: bjeshkë, livadhe, lumë, mulli, zana, orë. Mundet që kjo legjendë është e njëkohshme me vetë mitin grek të Edipit, pasi asokohe ka qenë ajo mënyrë të menduari e popujve ballkanas në të njëjtat kushte; e dallon vetëm elementi i Rinjohjes, që dhe mund të jetë shtuar më vonë, kur është kërkuar një zgjidhje morale e pranueshme. I rëndësishëm është thelbi tragjik i fatit. Janë qeniet jo njerëzore që japin kumtin e keq në të dy rastet, te Edipi - orakujt, te Legjenda Mirditase - orët apo zanat. Ato shqiptojnë të njëjtën formulë të fatit “vrasjen e babës nga i biri dhe martesën e tij me të nënën”, pavarësisht kahjes së zgjidhjes së fabulës tragjike.

4. Nisur nga tragjedia le ta rindërtojmë linjën fillestare të mitit mbi Edipin dhe pak a shumë të subjektivit të tragjedisë, për të parë përafrinë me legjendën tonë.

Në bjeshkët e larta të Qiteronit nga një bari gjen-det një djalë i tretur në greminë; Edipi foshnje gjendet i lidhur me lak në këmbën e shpuar (këndeje i buron dhe emri). Ky bari është Korintasi, i cili i thotë Edipit Mbret “të pata gjet në pyje të Qiteronit.” Po si kishte ngjarë? Korintasit foshnjën e tretur ia kishte dhënë një tjetër bari, i shtëpisë së Mbretit Lajo të Tebës. Këtij të fundit barrën e mbytjes (tretjes) së fëmijës ia kishin ngarkuar pikërisht prindërit e vogëlushit, Lajo dhe Jokasta, për arsye se ata e dinin nga orakujt se kur të rritej ai do “të vriste të atin dhe të martohej me të ëmën”. Kjo kishte qenë zgjidhja e tyre, për të cilën nuk ishin penduar asnjëherë.

Bari i shtëpisë së Lajos kishte ndërë keqardhje, duke mos e ditur gjëmën e fatit, fëmijën ia kishte dhënë Korintasit, bariut tjetër. Ky nga ana e tij do t’ia bënte atë fëmijë “dhoratë” Polibit dhe Meropes, të cilët nuk kishin fëmijë. Bamireshia e Korintasit ishte e shpjgueshme, në logjikën e gjërave, që shkonte përkundër logjikës fëmi-jëvrasëse të mbretërve antikë.

Edipi rritet dhe në rrethana të paimagjinueshme vret të atin e martohet me të ëmën.

Pak a shumë kështu ngjet dhe në legjendën tonë.

Pyje atje, pyje këtu. Atje fëmija flaket në greminë, këtu në lumë. Atje fëmijën e tretur e gjejnë barinj që i shpetojnë jetën dhe ia japin ta rrisë një njeriu që nuk ka fëmijë, Polibit, që e rrit si fëmijën e vet. Këndeje fëmijën e gjen mullisi, i cili gjithashtu nuk ka fëmijë, dhe që e rrit dhe ky si fëmijën e tij. Në të dy rastet prindërit, le të themi adaptues apo birësues, nuk bëjnë zë, e mbajnë enigmën deri në vdekje, dhe të dy bëjnë e gjetur dijnë për prindër këta të fundit dhe jo prindërit e tyre të vërtetë. Të dy kanë të njëjtin fat të parathënë, nën hijen e zymtë të të njëjtit Ballakan: Edipit - orakulli i Delfit dhe djalit shqiptar - zanat apo orët, u kanë caktuar të njëjtin fat: të vrasin të etërit dhe të martohen me të jemat.

Edipi e vret të atin në një ngatërrësë të rastit. Djali shqiptar, po në një sherr të rastit, te livadhi, vret të atin. Fati nuk ndryshon për një “bir të fatit”, paçka se ai ishte hero, mbret, bir mbreti a bari i thjeshtë delesh.

Në të dy rastet është akti i vrasjes së babait që çon drejt zgjidhjes së enigmës, zbulimit të së vërtetës. Nuk mund të shkohej më përtej gjakut. Pas tij e vërteta duhej të gjente gojë për të dëshmuar fatalitetin. Për Lajon kërkohet shpagim, pasi ai ka konsumuar gjithë spektrin e krimit (sh)njerëzor e moral, përfshi dhe martesën me të ëmën, kurse për djalin e legjendës shqiptare nuk do të jetë ky fundi, jo se nuk ka kush merr gjak për të vrasin prej tij, po se këtu rrjedha e tragjikës ndërron kahje, shkon në tjetër hulli.

Edipi rreket gjatë në zbulimin e fatit të vet. Djali i legjendës sonë e zbulon atë vetëm kur kupton se fati kësaj here e kishte ndihmuar të mos kryente mekatin e rëndë, të bënte shtrat me të ëmën. Kështu, Edipin fati e kthen në një rob të përjetshëm të tij, se ai e ka konsumuar aktin mekatnues të martesës “qorre” dhe ka lindur katër fëmijë, Polinikun, Eteoklin, Antigonen, Ismenën. Në këtë anë djali “ynë” është i privilegjuar, nuk vetëndëshkohet, as me verbim, as me ndonjë formë më të lehtë, pasi në rastin e tij, në gjykimin e shqiptarit të maleve, peshon fort e mbase mbi çdo gjë aspekti moral. Shqiptari ta falte dhe gjakun e djalit, por jo turpin, inçestin, shthurjen seksuale, krimin moral.

5. Martesa e djalit me nënën e tij ndodh në botën mitike helenike dhe e trondit atë nga themelet, në një kohë kur ishte kapërcyer martesa brenda të vetëve (gjakut), dukuri e fillesave të shoqërisë njerëzore, por ajo nuk arrin të shkundojë dot botën shqiptare

mitike të maleve, për shkakun se nuk arrin të ndodhë. Kjo është dhe veçoria kryesore dalluese midis mitit helen dhe atij shqiptar. Këtu shfaqen dhe kodet e veçanta morale të dy popujve fqinj nën një “çati” mitologjike ballkanase, çka tregon në mënyrën e vet se ata kanë dhënë e kanë marrë mes tyre, por kanë ruajtur ashtin identitar të vetin. Legjenda shqiptare vete gjer rrëzë malit të mëkatit, por ai nuk rrëzohet t’i zërë brenda mekatnuesit e mundshëm, pasi në çast diçka mrekulluese ngjan, diçka shpëtimtare fluturon nga kthinat e ndërgjegjes, një pëllumb, një shi gjaku, dhe në vend që të ndodhë mbitragjedia, ndodh mrekullia e Rinjohjes së Nënës më Birin.

6. Në tragjedinë “Edipi Mbret” shpëtimtari i fëmijës së humbur është një barë, kurse në legjendat shqiptare, diku është mullicaku, diku një shtegtar. Bariu i lashtësisë është dhe tjetërkund shpëtimtar i fëmijës së pambrojtur. Thuhet se poetin e mash indian të shekullit V të erës sonë, Kalidasën, që ishte bir Brahmani (shtresë e lartë), kur mbeti jetim 6 muajsh, e pati marrë një bari lopësh dhe e pati rritur si djalë shpirti.

“La leggenda del’Edipo Albanese”

Në këtë trajtesë ne zgjedhëm variantin më përfaqësues (sipas nesh) të gojëdhënës së *Djalit të Gjetur*, siç na pelqen ta quajmë, pasi,



në një trajtë apo në një tjetër, ajo ka qenë e përhapur në krejt Dukagjinin, siç shkruan At Marin Sirdani, duke sjellë një variant që ai e ka mbledhur në Pult, dëgjuar në dy a tri vende. Ai e quan përrallë dhe titullon “Nama e Orës”. (Sirdani, Kontribut..., 2017, 525). Skenari është po ai dhe personazhi mitik një njeri i vetmuar, natën, diku bari e diku mbret.

Nji nieri shkoi për një herë më dritë në bjeshkë me ça do drresa për me goditë një djep, pse së shoqes ishte me t’i falmit Zot’ ynë një fmi. Në sa ishte ky tuj shkurtue një mrë, po ndien një orë ke prej njaj mali po i bâte zà njaj shoqes së vet, se “njatij origlu i ka lé një djalë, si thue t’ia njesim ëmmin?” Zana tjetër ia kthen se nuk ka ngae me çá kryet për sa nierz lejn. Por ora qi lshoi zânin së parit nuk e la me aq, por i bzâni edhe dy a tri herë, e atbotë, ora/zana tjetër e mërztitun i përgjegj përmes një name tronditëse: “Vraftë t’ án e mårret t’ amen!”

Nuk është lumi këtë herë, por deti ku i ati (pasi ishte marrë vesh me të shoqen) do ta hidhte fëmijën mbyllur në një arkë, ku tallazet do ta qitnin në një breg larg, ku një dhi vente përditë “me e ndergue” (ushqye me tambël). Një shtegtar e gjen, e merr e çon te shtëpia e vet. “*Si u bâ ky një farë tarabacit, i ra n’er se ishte bir mbretit...* prandej shkoi tuj kërkue dhenë... me jetue ngjat babës së vet”. Mbas disa vitesh, ashtu duke kërkuar t’atin, has në një popull që po ankohej fort për mbretin e vet, bashkohet me kundërshtarët e tij dhe e vret

mbretin, ndërsa ky i fundit po udhëtonte me tri karroca diku afër qytetit. Populli e zgjodhi për mbret e i dha për grue, “*mbasi pëlqyen shoqisho’in, mbretneshën e mbetme pa fat*”. Pa u mbushur viti u lindi një djalë, por mes tyre kishte një marrëdhënie të çuditshme: burrit i jepej, kurdo që fliste me të shoqen, me i thirrë nanë, kurse asaj me i thirrë burrit, bir! Kjo bëri që të flisnin një ditë gjatë mbi jetët e tyre, ky i tregoi gjerdanin që e ëma i kishte pas lidhur në qafë, kur kishte qenë kërthi - kaq u desh që të merrej vesh se ata të dy (mbreti i ri dhe mbretnesha vejushë e martuar me të) ishin nënë e bir. Prej dëshpërimit burri vrau me thikë, së pari të shoqen, mandej të birin e së mbrami veten.

Ky variant është i përafruar me “Edipin Mbret”, subjekti zhvillohet në hullinë e tragjedisë antike të Sofokliut dhe jo në atë të Baladës së Rinjohjes.

Kurse nga Zadrime At Marin Sirdani sjell një variant të ngjashëm, por jo të njëjtë me atë të Mirditës të mbledhur nga Kol Shtjefni, që frati gjithashtu e quan përrallë.

...Teksa ishte tue i falë Zoti një fëmijë një grueje, kjo ndien një orë mali që po e pvette një shoqe të veten, nëse leu fëmija... Hej medet! Se leu në sahat të lig: ka për të vra t’an (atin)! Gruaja e rrënqethur nga ajo që kishte dëgjuar, ia tregon të shoqit, i cili “*ba efshe për at’ punë dau me të shoqen më goditë një arkë e me e qitë një tuj mos u ba zemra me e mbytë me duert e veta*”. Fëmijën e mbyllur për së gjalli në arkë e morën dallgët dhe e qitën së mbramit në breg, ku, prej vullnesës së Zotit, shkonte një dele që e ushqente përditë me tambël. Mbas do muejsh shkon aty një lundëtar, e ndesh fëmijën e njomë, i dhimbset, ndaj e merr me vete dhe e mban në lundrën e tij derisa bahet njifarë tarabaci, e atëhere, i thotë që të zbresë në tokë për me mujt me gjet ndonji punë e me u ba i hajrit.

Si u ul në tokë, djali zuni vend te një zotni, i cili i la të ruante një pemëtore, e kushdo që do të guxonte me e damtue, ta vriste patjetër. Një ditë prej ditësh iu dha këtij zotnisë me e provue rrogëtarin a po e zbatonte urdhnin e tij dhe pa ague mirë drita shkoi e hipi në një fik. Erdhi mbas pak kohe rojëtar i (djali), pau se dikush kishte hipur në fik, i bani za dy a tri herë dhe kur njeriu në pemë nuk po ua vinte veshin kërcënimeve të tij, shtiu mbi të dhe e vrau. Shkoi fill e tek shtëpia për me i tregue zotnisë se kishte vra një njeri, por tuj mos e gjetë aty, ia diftoi punën zotisë së shpisë dhe shkuen së bashku me e kundrue se kush mund të ishte i vrami.

Kur panë se kishte vra zotninë e vet u mjrue të dy ke s’ve ma. “*Si e bajten e e çuen te shpija, e pveti zoja se çfisit e gjinjet ishte, me i ndodhë ai farë rrezikut. Ky u vu e kallxoi fill e për pë të gjithë jetën e vet, e atbotë grues i ra ndër mend nama e orës, e u vertetue se ishte shi i biri qi i kishte pas lé në sahat të lig me vra t’an*”. (Sirdani, Kontribut..., 529.)

Siç shihet, rrëfimi zadrimer i Sirdanit nuk përmban pjesën e “dytë” të fabulës së Edipit Mbret, martesën fatale të djalit më të amën. Profecia *edipiane* e orëve të malit këtu është e përgjysmët.

Shaban Sinani, që në studimet e veta e ka rrokur dhe këtë dukuri, shkruan: “Gojdhana e t’birit qi martohet me t’amen”, që Cordignano e mblodhi prej një fshatari nga Dardha e Pukës, me emrin Nikollë Ndoci, në italisht nëntitullohet prej tij “La leggenda del’Edipo Albanese”... disa prej këtyrë motiveve gjenden të mbledhur e të botuar më herët a më vonë dhe nga dijetarë të tjerë, si te Hahni, ku “Gojdhana e t’birit qi martohet me t’amen” është, në koleksionin “Griechische und Albanische Märchen”, haset në një trajtë tjetër, ku bartësi është folës i toskërishtes. Në këtë variant miti i Edipit ndërthuret me mitin e Perseut e të Andromedës. (Sinani, “Tradita gojore si etnotekst”, 2012, 327.)

Në vend të epilogut

“...Edipi nuk e kishte vrasë të atin. Dhe as kishte fjetur kurrë me të ëmën. Ishin shëmbëllime krimesh të mundshme, që u shpallën si të kryera ndërkaq, ditën që ai ishte bërë tiran... Ditën që ai (tiran) e merrte kurorën, ato zhvendoseshin nga koha e pritme, ajo që ende s’ishte, drejt së shkuarës, për të mbërritur gjer në strehën më të sigurt, në zgrof të nënës...” (I. Kadare, “*Lulet e ftohta të marsit*”, Onufri, 2000.)

Sofokliu. *Edipi Mbret*, Tiranë 2008 & 2016.

Kalidasa, *Sakuntala*, Tirana 1958, përktheu Skënder Luarasi.

Kol Shtjefni. *Mirdita, doke zakone, Tiranë 1999.*

At Marin Sirdani, *OFM, Kontribut për historinë dhe kulturën shqiptare, Botime Françeskane, Shkodër 2017.*

Ernest Koliqi, *Hija e Maleve, botimi i parë, Zarë 1929 & Botimet “Pakti” 2011.*

Përjasje mes “*Edipit Mbret*” dhe një legjendë mirditase, gazeta “*Shqip*”, 2006.

Vëllime folklorike ku përfshihen këngët e Rinjohjes etj.

Ismail Kadare, “*Lulet e ftohta të marsit*”, Onufri, Tiranë 2000.

Shaban Sinani, “*Tradita gojore si etnotekst*”, “*Naimi*”, Tiranë 2012.

Anton Nikë Berisha, *Poetika e letërsisë për fëmijë*.
Botoi Universiteti i Gjakovës “Fehmi Agani”, Gjakovë 2020, f. 204

ÇELËSI I INTERPRETIMIT TË VEPRAVE LETRARE PËR FËMIJË

Nga Sabahajdin Cena


Tashmë nuk është kontestuese se veprat e studiuesve të mëdhenj të letërsisë në përgjithësi e të letërsisë për fëmijë në veçanti, u bënë gurë për ngritjen e kësaj godine që jo vetëm e mban të zgjuar dhe e kënaq kureshtjen e lexuesve të vegjël e të rritur, të mësimdhënësve të letërsisë, të arsimtarëve dhe të mësuesve, por edhe të studiuesve të letërsisë për fëmijë. Një hap të këtillë e bëri dhe Universiteti i Gjakovës “Fehmi Agani” që mundësoi botimin dhe e vuri në dritë veprën e Prof. Dr. Anton Nikë Berishës me titull “Poetika e letërsisë për fëmijë” me çështjet: Letërsia për fëmijë si art i fjalës, Vëzhgime teorike, Krahasime me letërsinë për të rritur, Interpretime veprash e në fund Portrete shkrimtarësh.

Kjo përmbledhje e hulumtimeve dhe e shkri-meve të Anton Nikë Berishës, studiuesve u erdhi pas veprave: Mundësi interpretimi, Ese dhe vësh-trime (Prishtinë 1979), Teksti poetik. Vështrime e kritika (Prishtinë 1985), Veçanti ligjërimesh poetike (Tiranë 1996), Gjymtime dhe shënime të letërsisë së arbëreshëve të Italisë (Prishtinë 2001), Çështje teorike të letërsisë (Prishtinë 2005), Njëmendësia e fjalëve. Mundësi interpretimeve letrare (Prishtinë 2006), Interpretime të letërsisë së arbëreshëve të Italisë (Cosenza 2008), Këngë që përlligjin pasurinë shpirtërore të shqiptarit e të botës së tij. Mbi këngët kreshnike shqiptare (Prishtinë 2008), Vëzhgime te-orike dhe estetike të De Radës dhe të Fishtës (Ti-ranë 2011), Larmi vëzhgimesh letrare (Prishtinë 2012), Ligjërime rreth tekstit letrar poetik (së bash-ku me Labinot Berishën, Prishtinë 2017), Hyrje në historinë gojore shqipe (Prishtinë 2017), Estetika dhe estetika e letërsisë (së bashku me Labinot Ber-ishën) e shumë vepra të tjera.

Pjesa e fundit e veprës “Poetika e letërsisë për fëmijë” vështron letërsinë për fëmijë si art të fjalës, qoftë në rrafshin teorik, qoftë të krahasimeve me letërsinë për të rritur, pastaj interpretime të veprave e të portreteve të shkrimtarëve. Si moto të librit au-tori ka vënë mendimin e doajenit të letërsisë për fëmijë Mark Krasniqit, autorit të përmbledhjeve tejet të rëndësishme për fëmijë, ndërsa hapet me një parathënie, ku në mënyrë tejet të matur, autori konstaton se studimi i veçantive teorike të letërsisë për fëmijë, veçanërisht i poetikës së saj, krahasimit me letërsinë për të rritur dhe interpretimit të disa veprave të veçanta, ishte një sprovë dhe ballafaqim i mirëfilltë duke sfiduar vetveten dhe përvojën e tij si studiues, jo vetëm i letërsisë kombëtare por edhe botërore për fëmijë, gjë që shihet më gjerësisht edhe në veprat e tjera të autorit.

Në pjesën e parë – Çështjet teorike të letërsisë për fëmijë, autori trajton veçanti të artit të fjalës së shkruar, përkatësisht të letërsisë dhe të aktit të krijimit: “[...] shkrimtari ndien nevojë shpirtërore t’i shprehë gjërat që ‘vlojnë’ brenda tij, për t’ia thënë vetes, për të menduar vetë rreth tyre ose për t’ia thënë tjetrit; të ballafaqohet me mendimet

e ndryshme që i lindin kur është në vetmi, ose që ia nxisin dukuritë e jetës së përditshme, leximi i veprave të paraardhësve” (f. 27) duke u ndalur te qenësia e tekstit si strukturë gjuhësore poetike, me theks të veçantë tek rëndësia dhe karakteri njohës i letërsisë për fëmijë. Në këtë kuadër Berisha synon ta përkufizojë letërsinë si art të fjalës dhe ndikimin estetik që teksti ushtron në lexuesin. Pra, thekso-het rëndësia e letërsisë për fëmijë dhe ndikimi i saj estetik, krahas rëndësisë njohëse të saj. Po kështu autori thekson rëndësinë e të bukurës si kategori estetike në pasurimin e shpirtit të fëmijëve si dhe të mrekullueshmen.



Si çështje me vete autori e ngrit ndikimin dhe rëndësinë e përrallës si lloj i mëvetësishëm i letër-sisë për fëmijë për të hyrë në problemet që ka kjo letërsi përballë letërsisë për të rritur. Duke i trajtuar këto çështje autori ndalet në shtresat dhe llojet e ndryshme të letërsisë me vështrime mbi artin letrar gojor dhe artin letrar të shkruar, pra raportin ndërmjet letërsisë gojore dhe asaj të shkruar, fusha këto të cilat autori i pati rrahur edhe më herët në punimet e shumta duke e krahasuar letërsinë për të rritur me letërsinë për fëmijë me theks të veçantë mbi tiparet integrale dhe dezintegrale që ndikojnë në forma të ndryshme mbi njërin apo mbi tjetrën. Me të drejtë theksohet: “Gjuha që përdor shkrim-tari në veprën letrare për fëmijë është një nga për-bërësit e rëndësishëm që e veçon atë nga gjuha e veprës për të rritur. Ajo duhet t’i përshtatet natyr-shëm mënyrës së të menduarit të fëmijëve, të jetë një qenësi e kuptueshme prandaj dhe lehtëzi e re-ceptueshme. Pikërisht brenda këtyre përbërësve fshihet dhe qëndron fuqia dhe veçantia e gjuhës që përdor shkrimtari në një vepër për fëmijë” (f. 76). Pra, autori ndriçon dhe begatimin shpirtëror, este-tik që vepra për fëmijë mund të bëjë përmes artit të saj në marrësin.

Berisha thekson se letërsia shqipe për fëmijë ka vlera të mëdha dhe se përkimet me letërsinë gojore shqipe janë të dukshme, si fjala vjen, këngët e riteve e këngët e motmotit, këngët e riteve familjare, lo-ja-nakët (lojënumraket), përrallat, por edhe letërsinë e traditës duke i ilustruar mendimet me shembuj të bukur që gjallojnë ende në letërsinë gojore.

Në pjesën e dytë autori përqendrohet në inter-pretimet e disa veprave të letërsisë sonë për fëmijë dhe nis me interpretimin e “Postës së porositur” të Mark Krasniqit, njëres prej veprave më interesante, më të këndshme e më të rëndësishme, madje edhe më të lexuara të letërsisë sonë për fëmijë. Galeria e personazheve: njerëz, kafshë shtëpiake e kafshë të egra, shpezë e insekte, paraqet botën e mbushur me anatagonizma të shumtë sepse “I ligu prej të fortit, gjithmonë është në rrezik”, prandaj edhe “Delja kurrë nuk mundi, ujkun ta zërë mik”. Së kënde-jmi, ujkun, ariu e dhelpra rrezikojnë përherë delen me qengja, bletën me mjaltë dhe pulën me zogjtë. Mirëpo, mbi të gjithë qëndron njeriu që, sipas studi-uesit, del më i fortë se guri e mesazhe të qëndresës mishërohen nëpërmjet gjahtarëve: axhës Sat (që ka një pushkë të gjatë) Kapllan Barutit (që mallkon që kafshës t’i qorrohen sytë e t’i dalin sa huti”) e ax-hës Behram (me kërcënime për derrin e egër i cili e përshëndeti me një telegram), prandaj edhe opti-mizmi shprehet vetvetiu pa trumbetime e deklarata e moralizime. Në këtë mënyrë ndriçohen vlerat edukative, njohëse dhe estetike të veprës për fëmijë, Mark Krasniqit, të cilin studiuesi Berisha e njeh çdo skutë të veprimtarisë letrare, duke filluar nga vepra “Prrallat e gjyshit” e “Dritës së parë”.

NJË UDHËTIM NË LABORA-
TORIN E KOHËS ME OLTSEN
GRIPSHIN NË MUZEH LAB

Nga POL MILO

*“Më jep një moment në kohë
Që unë të vrapoj me fatin,
Pastaj, në atë moment të kohës
Unë do të ndjej, përjetësinë!”*

Whitney Houston

1. Një moment në kohë

Nëse do të kërkojmë një shpjegim për kohën, atë do ta gjejmë të përkufizuar si një progres i vazhdueshëm dhe i pafund i ekzistencës dhe i ngjarjeve në të shkuarën, të tashmen dhe të ardhmen!

Ekzistenca dhe ngjarjet padyshim që zhvillohen sipas perceptimit tonë, të ndara në këto tre kategori të mëdha, të lidhura së bashku nga fija e padukshme e kohës. E të njëjtës kohë që ato i përkasin, por njëkohësisht edhe të ndara e të copëtuara në miliona momente, të fiksuara midis akrepave të orëve të varura pezull në ajër si re. Këto janë vetëm disa nga miliona copëza mendimi që të vjen në mendje kur futesh në një ekspozitë të veçantë si një laborator i kohës.

Të tillë e ka ndërtuar artisti bashkëkohor Oltsen Gripshi instalacionin e tij të quajtur “KOHA”. Mbi

treqind orë qëndrojnë të varura pezull të ekspozuara në një muze të ri të pagëzuar me emrin MuzEH Lab, kuruar nga Dorina Xheraj Subashi, në një shtëpi të vjetër të një qyteti akoma më të vjetër, jashtë nga koha, jashtë nga dinamika e jetës së shpejtë aktuale, metropolitane e mondane, nga ku jeton dhe sundon mendja e botës.

Jetojmë në epokë virtuale kompjutetizimi masiv, larg nga epokat e vëzhgimeve të yjesive, galaktikave dhe ndikimit të perëndive, që na rritën e na mbikqyrën duke menduar se filluam te ecim me kembet tona. Por më pas rikthehemi te shprehja e Shekspirit kur thotë se: *“E gjithë bota është një skenë, dhe të gjithë ne, burra dhe gra, jemi aktorët e saj.”*

Po kur filloi koha për artistin Oltsen Gripshi? Kush është zoti i kohës? Çfarë bënte ai përpara se koha të fillonte? Këtu pyetjet, çuditë dhe të vërtetat ndërthuren, që nga fillimi i Big-Bengut deri tek hipotezat e Shën Agustini kur thoshte se ndoshta zoti përgatiti ferrin përpara se të bënte kohën, për tipa si puna jonë që bëjmë të tilla pyetje. Teksa mendon të tilla gjëra vijon të endesh në labirintet e këtij instalacioni intrigues si në labirintet e Babilonisë. Mijëra vite kalojnë dhe ne ende nuk kemi vendosur për të kuptuar nëse bëjmë pjesë mes rrathëve të Dante Alighierit nga njëra anë apo në universin



përhapës të Hubbleit nga ana tjetër. Kështu ngelim të ngërthyer në rrathët e kohës. Kujtojmë se jemi zotër të qiellit, të yjeve dhe universit, por nuk arrijmë kurrë të jemi zotë të kohës.

Këto orë qëndrojnë të varura si lavjerësa, duke matur kohën brenda kohës. Ato qëndrojnë të ngrira brenda hapësirës së një dhome fare të vogël nga ku duket sikur ka hyrë aty i gjithë universi. I ngecur aty, i buzëqeshur.

- Ky instalacion nuk është një rastësi - thekson Oltsen Gripshi, - ky është një mesazh kozmik, i parapërgatitur nga dimensione të tjera. Është vetë koha, nëpërmjet përthyerjes së saj, që e sjell në këtë mënyrë!

Ne dimë se ekziston vetëm e tashmja. Ajo është tani. Nuk ekziston as e shkuara as e ardhmja. Ato ekzistojnë vetëm në perceptimin tonë. Kur ora ndalon akrepat e saj në një moment ajo fle përgjithmonë në atë moment, jeton brenda atij momenti. Ndërkohë ne nga jashtë shohim vetëm dy numra pa kuptim mbi të cilën qëndrojnë akrepat e ngulur, pa ditur kurrgjë për të kaluarën e saj.

Në këtë instalacion mund të futesh midis orëve të varura ku të krijohet ideja e kalimit mes universeve paralele, si të hysh në portat nga ku fillojnë udhëtimet për të kaluar nga një hapësirë në një tjetër, nga një dimension në një tjetër. Këto porta imagjinare duket si portat ku Stephen Hawking tha se *“mund mund të shkojmë deri në skajin tjetër të galaktikës dhe të kthehemi sërish në shtëpi, në kohën e ngrënies!”*

2. Misteri i sëndukut dhe Re të bardha

Në mes të dhomës me orë të varura qëndron një sënduk i vjetër, i rëndë. Duket sikur aty koha mbaron. Sënduku fluturues të çon në mendje se pas udhëtimeve nga njëra orë te tjera, fluturimi i fundit është brenda tij. Por njëkohësisht ai përfaqëson gravitetin përthyes të hapësirës dhe të kohës. Ky është misteri i padukshëm. Kapaku i tij i hapur lë shteg kalimi për mendimin hermetik. E tashmja ngjyrë gri, një urë optimiste, lidh të shkuarën e kuqe të gëzuar me të ardhmen jeshile të shpresës.

- Një udhëtim në kohë, të lutem?
- Jo, më vjen keq, nuk është e mundur. Ende nuk e kemi shpikur makinën e kohës.
- Atëherë, përse të njëjtët sahatë mbi avionë apo mbi satelitë, lëvizin me shpejtësi të ndryshme nga ata që rrinë mbi tokë? Përse graviteti bën që një sekondë atje mos të jetë e barabartë me një sekondë këtu? A nuk do të thotë kjo “të udhëtosh në kohë”?
- Kjo është e vërtetë, por ky është një diskutim misterioz, i pamundur. Siç e shihni, këto orë kanë ngecur prej shekujsh. Njerëzit të cilët i braktisën ato, tashmë jetojnë në të tjera kohë. Gjithçka që mbetet është vetëm perceptimi ynë.

Mungesa e gravitetit është braktisja, zbrazëtia që qëndron pezull mbi re. Retë e bardha fluturojnë duke ndryshuar format e tyre në lumturi iluzive si peshat e rënda të pendimit. Ku flenë retë? Ç’gjumë bëjnë? Përse ndryshon koha kur retë nuk janë e kur rikthehen sërish? A nuk do të dëshironim edhe ne të qëndronim pezull në ajër si retë e bardha të kohës? Por ne kemi një fat. Ne jemi vëzhguesit më të mëdhenj të një kohe pafund, të ngadalësuar në spiralet e galaktikave rrethore, të ndriçuara me supernova gjigante të shpërthimeve diellore dhe të shuara brenda pikave të shiut të rëna nga retë tokësore! Ndaj vëzhgojmë qëndrimin dhe rënien, ndriçimin dhe shuarjen, qetësinë dhe zhurmën e hapësirës së jashtme dhe të ngushticës brenda vetes, e në fund përfundojmë tek shprehja e filozofit Berkeley, ku thotë se *“objektet, hapesira dhe koha janë thjesht një iluzion i yni.”*



me orë të ndalura, - thotë profesor Fatmir Minguli - ku ato orë ngjajnë sikur janë mendime të varura, por njëkohësisht edhe mendime të hapura! Ky muze është “Tjetër-Lloj” në kohën ku jetojmë, është vetë muze për vlerat e kohës!”

Instalacioni i artistit bashkëkohor Oltsen Gripshi, shumë përmasor dhe me mjaft përthyerje si një laborator, bën që të udhëtosh në kohët që ekzistojnë dhe që nuk ekzistojnë, në kohët e tanishme dhe të përtejme, të shkuara e të ardhme, të arrira dhe të paarrira, si një rrëshqitje përgjatë tingujve të kitares, kur grupi i famshëm Pink Floyd këndon:

*“dhe ti vrapon, e vrapon për të kapur diellin,
ndërkohë që fundoset,
e ai rrotullohet, për të dalë sërish prapa teje”*

Me diellin në rrotullim meriton të falënderohet Oltsen Gripshi si një artist me qasje conceptuale surrealistë, që përmes simbolikës së orëve, reve, sundukut dhe tri fjalëve E SHKUARA, E TASHMJA dhe E ARDHMJA arrin të zbërthejë qenien njerëzore nëpërmjet semiotikës së kohës, si fenomenologji e vetë ekzistencës.

Durrës, 14 Prill 2021



(vijon nga faqja 9)

Në këtë pjesë të librit trajtohet dhe krijimtaria letrare e Rifat Kukajt, veçanërisht përmbledhja e vjershave me titull “Pëshurrani i gjyshit” të cilën studiuesi Berisha e vështron dhe e shpall “xhevahir” të krijimtarisë letrare për fëmijë edhe kur e krahason me veprat e autorëve të tjerë në rrafshin intraletrar, me veprat e mëparshme të Rifat Kukajt dhe me krijuesit e letërsisë sonë në përgjithësi.

Një qasje e këtillë multidisiplinare mund të shërbejë edhe si model e çelës për depërtim në shtresat më të thella të veprave për fëmijë e për të rritur e në sajë të qasjeve të këtilla shumë mënyreshe dhe shumështrësore. Berisha heton se Rifat Kukaj arrin një rrafsh të lartë shprehës poetik dhe komunikues; përfton me mjeshtëri disa nga pamjet e rralla të poezisë sonë për fëmijë, ku e rëndomta ose e zakonshmja ngjizet me të pazakonshmen, përditshmëria me përfytyrimin dhe aty gërshetohet gëzimi e hareja me rastin e lindjes, gjatë rritjes dhe gjatë pjekurisë, duke theksuar zhbërjen e kufirit midis poezisë për fëmijë dhe poezisë për të rritur, ku vjersha shpreh e paraqet një tekst të mbrytur mirë me mendime të qenësishme.

Gjatë hapërimit nëpër veprat e autorëve - krijuesve studiuesi Berisha ndalet edhe në interpretimin e poezisë së Agim Devës, ku gjen një botë të mendimit dhe të veprimit të lirë që nga përmbledhja e parë e Devës e deri në fazën kur krijuesi ngrihet, pasurohet e thellohet në përmbledhjet e mëvonshme dhe lexuesi, në sajë të vjershave të Devës, por edhe interpretimit të Berishës bindet se me të vërtetë Deva e njeh artin e fjalës së shkruar në përgjithësi e të letërsisë për fëmijë në veçanti; nga teksti i poezisë së tij del se çdo njeri është farkues i fatit të vet dhe se “do të korr atë që e mbjell”, prandaj vetëdija asnjëherë nuk duhet të jetë e fjetur dhe lexuesit të çdo niveli e grupmoshe i bëhet se gjatë shtegtit jetësor has lypsarë apo karrocierë të shtypur nga guri i skamjes dhe i varfërisë. Sipas Berishës “Rrëfimi poetik i Agim Devës, është sa i pandërmjemë dhe i qartë, aq dhe simbolik dhe poetik. Poezia e tij tematikisht është aktuale dhe kuptimisht shumështrësore. Edhe pse autori nuk e kultivon fantastikën, të mrekullueshmen, krijimet e ngritura e të shtjelluara nga gjuha poetike, nxisin një nëntekst dhe një konotim të pasur” (f. 126).

Në këtë libër Berisha interpreton dhe vepra të letërsive të huaja, siç vepron me veprën në prozë të Antoan Dë Sent Egzyperi “Princi i Vogël” të prirë nga motoja se “Libri është zgjatim i kujtesës dhe i imagjinatës”, maksimë kjo e Jorge Luis Borgesit; pra krijuesi duhet të frymojë përmes shkrimit që e harton, duhet të qajë kur shkruan ose të këndojë gjatë shkrimit, në të kundërtën, sipas Anaïs Nin, është më mirë të mos shkruajë, për arsye se kulturës nuk i shërben. Këtu studiuesi hap horizontin kah bota në sytë e fëmijës dhe kah bota në sytë e të rriturit.

Në vazhdim Berisha e interpreton romanin “Zogun e bardhë” të Rifat Kukajt, duke e plotësuar portretin e këtij krijuesi. Me të drejtë konstaton se “Vlerat e mirëfillta poetike duhet t’i përkasin gjithë njerëzimit: ato i tejkalojnë kufijtë krahinorë, kombëtarë, racorë e fetarë. Këtë gjë e kushtëzon para se gjithash arti i tyre, komunikimi dhe ndikimi estetik që bëjnë tek marrësi” (f. 147); arti ekziston për njeriun e jo për vetë artin. Në rrafshin poetik ky roman i Kukajt ndjek poetikën, strukturën dhe kompozicionin e përrallës gojore, pra roman i tipit përrallë.

Çështjet e interpretimit të veprës letrare,

në formë modeli-çelës Berisha i përfundon me romanin “Shpella e piratëve” të Petro Markos. Duke e interpretuar këtë vepër të Markos, studiuesi i ballafaqon botën reale me botën e gojëdhënave për një shpellë që ngjan të jetë e piratëve, ku lidhen dy kohë: e tashmja me të kaluarën e sërish haset modeli romanit të tipit përrallë, sipas parimit aditiv, kur njëri episod “thërret” episodin tjetër sipas modelit “Çka pastaj?”, por që te Petro Marko, studiuesi gjen një botë të mëvetësishme artistike e cila në një mënyrë apo në një tjetër bëhet pjesë edhe e atij që e lexon.

Pjesa e tretë e librit përmbushet me dy portrete të shkrimtarëve: Rifat Kukaj e Vehbi Kikaj, autorëve të veprave të rëndësishme poetike për fëmijë, shprehur më gjuhën figurative, të dy bardhësive; “Zogut të bardhë” e të “Sarajeve të bardha”.

Krijimtaria e Rifat Kukajt vështrohet nga aspektet e ndryshme; dëshmohet e pasur dhe e përfutur me përkushtim të madh nga se autori jetoi me letërsinë dhe për letërsinë. Romanet e Rifatit studiuesi Berisha i grupon në tri rrafshje. Në rrafshin e parë ky studiues ia gjen vendin “Kokërmellit dhe pilivesës”, në të dytin, “Ditës së xhufkave” dhe në rrafshin e tretë “Zogun e bardhë”.

Sipas interpretimit të Berishës, Rifat Kukaj dëshmohet edhe mjeshtër i tregimit të shkurtër. Këto krijime janë përfutur mbi bazën e argëtimit dhe të lojës, shpesh të gërshetuar me një humor të lehtë, mbështetur në krijimtarinë gojore.

Nga veprimtaria letrare të Vehbi Kikajt studiuesi ndriçon një varg vlerat e veçantish artistike, qoftë në rrafshin e poezisë, qoftë të prozës.

Në sajë të vështrimeve të gjithanshme, të qasjeve multidisiplinare, Anton Nikë Berisha procedon sipas një koncepti të ri e të përfillshëm shkencor, prandaj edhe ka arritur që t’i shtrojë çështjet rreth poetikës së letërsisë për fëmijë, po dhe marrëdhëniet me letërsinë për të rritur, pastaj me letërsinë gojore, ndikimet dhe përkimet në disa rrafshje. Punën serioze të autorit e dëshmojnë burimet e shumta, fusnotat dhe referencat që flasin për gjerësinë dhe thellësinë e të shtruarit të problemit të poetikës së letërsisë në përgjithësi dhe të letërsisë për fëmijë në veçanti, të interpretimit të disa veprave të rëndësishme për fëmijë dhe të ravijëzimit të portreteve të shkrimtarëve.

Me këtë vepër Berisha ndriçoi një varg dukurish të letërsisë; i shprehu mendimet dhe vlerësimet me një drejtpeshim dhe solli argumente dhe fakte të rëndësishme. Pra, edhe arriti t’u japë një përmasë më të gjerë shqyrtimit të problemeve të kësaj letërsie që u kushtohet një pjese të madhe të lexuesve.

Në veprën “Poetika e letërsisë për fëmijë” Anton Nikë Berisha përdor një sistem të tërë të nocioneve, qofshin të traditës sonë, qoftë nga tradita e tjera, me ç’rast pasurohet terminologjia e studimit të letërsisë. Këtë pasuri autori e voli nëpër veprat e ndryshme që i studioi si dhe nëpër qendrat universitare ku qëndroi, veprimi dhe i bëri hulumtimet.

Mënyra e të shkruarit të Anton Nikë Berishës është e qartë dhe bindëse, prandaj me mendimet dhe vlerësimet e shprehura në këtë libër mund të komunikojë edhe krijuesi i thjeshtë, por edhe studiuesi specialist i fushës së letërsisë në përgjithësi e i letërsisë, sidomos i për fëmijë.

“Poetika e letërsisë për fëmijë” e Anton Nikë Berishës tejkalon premtimin që i jepet lexuesit përmes titullit për arsye se ai vëzhgon edhe çështje të diskutueshme të letërsisë për fëmijë.

Rahovec, shkurt 2021

Libri “Kur sunduesit grinden” i Kadaresë

RAPORTI I ARTISTIT ME PUSHTETIN

Nga Agim Janina, studiues arti

Raporti i artistit me Pushtetin është një raport diabolik, i thekshëm si kama me dy tehe. Fare lehtë mund të pritesh dhe më lehtë mund të vritesh.

Kjo lidhje, për më shumë ky dyluftim, i shtrirë në kohë është e vjetër sa njerëzimi, shi kur doli vepra e parë artistike, që lind me ndërgjegjësimin e qenies njerëzore. Aty nisi ballafaqimi, të parit, të kundruallit e njeri tjetrit, dmth të artistit me të tjerët, fillimisht me bashkësinë, për të vijuar më pas me, drejtuesin, shefin, udhëheqësin, mbretin etj., etj dmth me “tjetrin”, pra me Pushtetin.

Në diktatura dhe tirani, ky raport vjen e bëhet më i vështirë, më ndrydhës, më diktues.

Janë dy qasje, dy veshje, dy kostume. Pushteti me forcën e madhe të një ngrehine ogurzezë të endur e thurur në fije të pafundme, humbur në skutat më të thella, që shtrihet kudo dhe end fijet e saj shtrënguese në të gjithë shoqërinë dhe ai, artisti i vetëm, që kërkon të çajë e dalë nga kjo rrjetë me barrën e censurës dhe me keq të autocensurës mbi supe. Në prag të përmbysjes së diktaturës, Kadare kishte pohuar arradhën e mendimeve të mosshprehura në shkrime për shkak të trysnisë që ndjente në të shprehur të lirë të vetvetes.

Kjo është hullia ku shkrimtari Ismail Kadare ka ngritur rrjetën në përshtatjen e fundit titulluar “Kur sunduesit grinden”. Termi “grinden” ka më shumë shembëlltyrën e dhunimit të së shenjtës së artistit – krijimin, qenësinë e patjetërsueshme, të veçantën, të epërmen, të parrokshmen, mbretërinë e vetme të tij. Edhe pse nuk ka asgjë tjetër, veç të shkruarit nëvetimit e studios, krijimi është në thelb pushtet dhe ndeshja është përplasja pushteti.

E ndërtuar si fabul ajo të trand mendimet, duke të futur në rrugëtimet e pashkelura, honet e pakapshme, atë gjendje flutarakë endur si makti i përhershëm që pushteti diktatorial ushtron dhunshëm si një kupolë e hekurit në mendjet e krijuesve për t’i mbajtur e shtënguar jo thjesht në rresht, por në një fre gjakatar. Artisti ka thjesht një armë – të shkruarin, lirinë e krijimit.

Kadare sjell shembuj, mund të shtohen mund të shtohen me të tjerë që nga zanafilla e krijimit. Eskili i larguar në syrgjyn, Seneka në vaskë me damarë të prerë, duke pritur kumtin e shpëtimit nga Neroni, Gëte pranë tiranit, Hygo i mërguar etj., etj. Por gjithçka kalon. Gjithçka. Mbetet vetëm kumti. Dhe kumti i artistit është gjithëkohor, del e mbyl çdo lloj diktature dhe tiranie.

Raporti i mësipërm është marrë e rimarrë nga autori në shumë vepra të tij, herë del i nënkuptuar, herë i fshehur ndërmjet rreshtave, herë si vegim kujtues, por i vazhdueshëm. Këtë herë ai del e bëhet kryefjalë. Është e kuptueshme, sepse është hija shoqëruese e shkrimtarit gjatë gjithë diktaturës me ulje ngritje të vazhdueshme, me goditje të buta, të forta që shkojnë deri në kërcënime vdekjeprurëse në cënim të vetë vlerës së autorit.

Diktatura e mendjes, dmth zotërimi i saj, është diktatura më e rëndë, më e thekshme, më mizore. Përplasja e Artistit me Diktaturën vjen e menjëhershshme, çoroditëse në fillim deri sa kuptohet se çfarë kuptohet apo më mirë gardhi deri ku mund të shkojë liria e të shprehurit.

“Atë fjalinë nuk e kishe ndërtuar mirë. Me këto mendime të shprehura në libër shkon në burg. Ndaj kujdes... Ç’janë këto ngjyra?! Po këto nota?! Ku është heroi? Ke nxirrë realitetin, dmth ku jam unë Diktatura, ajo çka unë ju jap”? Të ka dhënë shkollë Partia, të bëri artist dhe kështu ia shpërblen ti! Etj. etj., etj, pa fund... Por jo vetëm kaq. Kjo është vetëm “luksi”, se pasohen me heqjen e të drejtës për shkruar, dëbimi nga vendi i banimit, fyerja e lançimi, burgosja e vrasja. Shumë nga këto Kadare i ka ndërjerë thekshëm mbi supe dhe provuar shumë herë. Tipik është fushata pas botimit të romanit “Dimri i vetmisë së madhe”, kur iu desh të përplasej me takime të panumërta, ku i kërkohej shpjegimi nga nga titulli i romanit në ballinë të librit e deri në fjalën e mbylljes së tij.

Për të ndërtuar e shpjeguar këtë ballafaqim, raport të mbrapshtë, shkrimtari Ismail Kadare në librin e fundit “Kur sunduesit grinden”, i shërben një fabul fare e thjeshtë: - një tefonatë: - Diktator - Shkrimtar. Kaq. Asgjë më shumë. Zgjedh Bashkimin Sovjetik, diktatorin Stalin dhe shkrimtarin Boris Pastërnak, por mund të zgjidhte çdo vend dhe shkrimtar në mbretërinë komuniste. Skena është e njejte, e frikshme, e rëndë, djegëse, përvëluese.

Mjaftojnë tri minuta dhe shfaqet Diktatura me të gjithë peshën e saj mortore, si hija e një ngrehine të rëndë, ku nuk le të shihet asgjë, se e mbulon me zezonën e saj të rëndë.

Ato tre minuta rrinë varur pezull, frikshëm. Dikush nga lart, dmth nga Pushteti mund t’i merrte lehtësisht dhe t’ia përplaste fytyrës shkrimtarit. Koha e Diktaturës, sepse ka një kohë të saj është ndryshe. Në diktaturë është e ngrirë. E palëvizshme. Mund të ishte dje. Sot. Nesër. Ose asnjera prej tyre.

Të kërkohej llogari. Dhe duhej të përgjigjeshe, kudo e për gjithçka.

Rrënjosja në mendjen e njerëzve, se ajo kurrë nuk do të ndryshojë. Kurrë nuk do të zbutet. Prandaj asnjë shpresë. Asnjë ëndërr. Asgjë. Hi. Asgjëja shtrihet tek të gjithë mbytëse. Të ndrydhur, të mbledhur bashkë miq e armiq. Të denoncuar dhe denoncues njëherazi. Gjithçka në përshtatje vjen si në një ëndërr zhgënjendër e keqe dhe e pambarimtë, plot me makthe të papitura, sepse e gjitha kalon bëhet

zhbëhet. I zgjuar në gjumë. Një gjendje e pakapshme e ka mbërthyer fort, një gjë që është jashtë, por të ka mbërthyer brenda. Kllapi. Tmerr.

Ajo që jetonte dhe ajo që shkruante ishin si dy botë krejt të ndryshme në dukje, por thellë e shkuara zgjonte të tashmen. Herë miqësore dhe herë në kundërshti dhe armiqësi me njera tjetrën, ku si një lavierës varej liria e të shkruarit, stili i tërthotë për të shprehur atë ç’ka donte. Në këtë trandje shkrimtari shkruante, duke harruar krejt botën tjetër, pa e pasur frikën e saj, atë të vërtetën apo më mirë e vërteta ishte ajo që shkruante. Dhe aty nuk kishte spiunë, hetues, diktatorë, gjyrmues, shpifës, që edhe pse mund të ishin personazhe nuk e pengonin t’i paraqiste ashtu si dëshironte. I kishte flakur nga vetëdija, sepse aty nuk mund t’i bënin gjë, kur së jashtëmi mund t’i bënin gjë më.

A nuk ishte kthyer vendi në një arenë boksi? Mbyllja e kufijve ishin si litarët e ringut. Përtej tyre nuk dilje dot edhe pse mund të të rraskapisnin, rrinin, vdisnin e të linin edhe pa varr ku të preheshe.

Arti del përtej edhe artistit që e bën. Është një kokëkrisje dhe kuturrisje e veshur me talent. Të shtyn diçka e brendshme. E ndjen, por nuk e shpjegon. Vjen thellë nga nëndërgjegjja e trurit, bashkuar në shpirtit, që e shtyn artistin ta shprehë veprën në atë mënyrë, si forcat e brendshme ia kërkojnë. Është në një lidhje e përzjerje të atillë, ku ajo që është jashtë ka hyrë brenda dhe ajo që është brenda do të shpërthejë jashtë.

A mund të bëhet fjalë për shpirt të lirë nën Diktaturë? - vjen vetiu pyetja.

Skenë krimi? Është përtej saj. Është një sistem. Një strukturë. Një ngrehinë. E madhe. E frikshme. E dhunshme. Pësja e Pushtetit.

Variant pas varianti shkrimtari kërkon t’i afrohet ciklonit, enigmes së zbërthimit të së vërtetës, shi Diktatorit të shkrimtarit. Binom i gjallë. I fortë. I përhershëm. I shkruan të gjithë variantet. I studion. Kërkon dhe gjen në pauzat e fjalëve, në frymëmarrjen e të dyve. Duhet qëmtuar në çdo fjalë, fjalë apo gërmë. I ngjan hetimit të një skenë krimi. Piktori francez impresionist August Renuar, do të shprehë se, ndërtimi i një tabloje në pikturë i ngjan ndërtimit të një skene nga një kriminalist. Një lloj si në krijimin e një shkrimtari.

Në të gjitha variantet theksohet një frazë, Diktatori, dmth Stalini, pasi jep kumtin, në bolshevikëte vjetër nuk i braktisim kurrë shokët, ia përplas telefonin në fytyrë. Kaq. Asnjë fjalë më shumë. Frazja bie rëndë si në tragjeditë greke.

Pastërnaku (si shumë të tjerë do të donin) iu turr telefonit... jo nuk është e vërtetë... unë... besnikëria ndaj kauzës... telefoni i zi është mbyllur. Numri nuk ekziston më.

Një numër që përdoret vetëm një herë. Në kufijtë e çmendurisë. Vetë diktatura ishte e çmendur dhe e pillte atë çdo ditë.

Ndërkohë paralel me të është Kadare me diktatorin Hoxha. Një telefonatë. Dy tela, o të prisnin kokën, o të lejonin jetën.

Asnjëherë bashkëbisedimi nuk ka marrë trajtën e gijotinës, si në rastin e bashkëbisedimit Artist - Diktator.

Mos vallë libri është një përshtatje alibi për të shmangur veten nga diktatura? Aspak. Shkrimtari ka qenë në vorbull të ciklonit diktatorial, në qendër të dhunës. E ka ndërjerë. E ka prekur. “Ai kishte qenë atje... kur ndodhte gjithçka... Më saktë, unë kisha ndodhur... atje”, shkruan Kadare dhe kuptohet që “atje” është këtu. Është fshikur prej saj. Jo vetëm nga struktura, po nga vetë diktatori. “Thuajini të lëpijë mutrat që ka shkruar, sakëlliu Diktatori nuk lexoi një vepër të shkrimtarit.

Nuk gjen një thënie të dytë! Më banale. Më të ndyrë. Më antinjerëzore. Më shtypëse.

Ç’duhej të bënte? Kush do ta mbronte dhe nga kush? Kishte prekur fundin. Ishte vetë Diktatori përballë tij. Ky, i fundit, i fuqishëm, i padiskutueshëm, i gjithëpushtetshëm. Ai i vetëm. Me një letër përpara për të shkruar. I duhej të shkruante. Ishte bërë Princ i letrave.

Ah “por”. Gjithmonë ka një por. Është një prag. Një harraç. Duhej paguar. Dhe Kadare e pagoi drejtpërdrejt dhe ballazi në dilemën artistike, më mirë një Kadare në burg dhe pa veprat e shkruara, apo një Kadare të “lirë” me veprat që la?

S’ka mëdyshje. Një Kadare siç e kemi.

Një personalitet, këtu nuk bën përjashtim shkrimtari, është si një skulpturë, e cila nuk mund të qendrojë pa dritë-hije. E tillë është thelbi i tij. Është domosdoshmëri.

Kadare nga arradhat e shumta të talentit, i është dashur t’i lëshojë diktaturës shumë prej tyre, t’i vrasë me duart e tij, si në mitin e Medeas, për të shpëtuar të tërën.

Shkrimtari e ka një ankth që i rri pezull. Shpesh ka shkruar për diktaturën dhe përsëri ka ende për të thënë. “Isha aq i bindur, shkruan, se do të shkruaja për të (diktaturën) saqë kishte çaste kur më duhej se kjo ishte bërë ndërkaq, madje sasia e shkronjave që do të më duheshin për të krijuar fjalët, ishte stivosur në këndin e vet, në pritje”. Vallë a do vijë koha t’i shkruajë. T’i shprehë? Ato prisnin. I ndjente.

“Në Tiranë vazhdonte fushata për njohjen e jetës. Shkrimtarët, pothuajse pa përjashtim, e kishin pranuar se kishin mangësi, sidomos për njohjen e punëtorëve të uzinave, pa folur pastaj për kooperativat bujqësore”. Ti nuk e njeh jetën! – mjaftonte kaq nga një njeri fare pa njohje të letërsisë apo të artit, por që kishte pushtet dhe përfundojë diku në qarkullim. Duhet të qarkullosh të njohësh jetën! Diku mund të ishte kudo larg edhe afër, por kudo që të ishte shkrimtari duhej të



njesohej me ata ku e kishin caktuar të punonte, të bënte punë fizike. Ky ishte detyrim.

“...kisha brenda vetes diçka të ngjashme: tmerrim tim kërcënues. Se ç’ishte ky tmerr, kur do të më hynte në punë dhe kundër kujt, nuk arrija ta kapja dot”. Kjo është madhështia e letërsisë, kumti i saj, që e shtyn shkrimtarin dhe e nxjerr jashtë realitetit dhe vetvetes. Është një magji e mrekullueshme, që ndodh dhe nuk shpjegohet se si ndodh.

Nën diktaturë ndoshta shkruhet më mirë se sa në liri. Paradoks? Kush e shpjegon. Po e vërtetë. Sepse të shkruarit nuk ka të bëjë me kohën, sistemin apo dhe vetë shkrimtarin.

“Ai kishte pas shpine shtetin dhe kjo mjaftonte që të tregonte dhëmbët në çdo çast. Miki dashur, këtu ke ca gjëra të bezdishme. Ndaj unë kam për detyrë t’i kthehem një herë, dy herë, dymbëdhjetë herë...”

Letërsia më çoi drejt Lirisë, ka vërejtur shkrimtari. Ky rrugëtim jo jetësor, por artistik është jashtë diktaturës. Ajo nuk e ndjek dot. Nuk e kap. Nuk e shikon. Vetëm e ndjen dhe pret syhapur dhe nëse gabon ta godasë. Deri tani e kemi nën kontroll. Jemi syhapur. T’ia mbledhim pak. Libri i fundit sikur ka ca gjëra që... sikur t’ia ndalojmë ca kohë?. Hë se mirë i bën. Mos vallë i është rritur mendja? Hëm...!

Por ka edhe një arsye tjetër më madhore, që e çoi drejt saj. Vetvetja. Mos pasja e frikës, një kokëkrisje në kufijtë e marrëzisë.

Ai thjesht do të shkruante. Dhe shkruajti gjithmonë deri sa tha, nuk më vjen më të shkruaj! Sa bukur. Asgjë patetike, dëshpërim, apo ankth. Thjesht nuk më vjen të shkruaj. Kur në fund të fundit i kërkuan llogari, se përse nuk shkruajti atë që ata donin, u përgjigj po thjesht, nuk kisha asnjë kontratë me popullin shqiptar. Shkruajta atë që desha! Dhe e gjitha ishte për popullin dhe kulturën shqiptare, letërsinë e gjuhën e saj të lashtë, bazë e Gjuhës së Njësuar Shqipe.

Shi pasjen e frikës kërkon Pushteti. Kur e arrin atë, atëhere sundimi është i plotë, i thellë, i shumanshëm...

Kadare nuk ka nevonë për alibi. Nuk punon për të. Vepra nuk është në qerthullin e vetanisë. Ajo shkon përtej saj. Kurrë nuk ka shkruar për veten. Edhe kur së fundmi, i kushtoi një libër nënës, ajo nuk është thjesht nëna e Kadaresë. Është Nëna.

Edhe libri i fundit u drejtohet artistëve, të gjithëve. Secili ka pasur një ndërlidhje e mpleksje të caktuar me Diktaturën. Dikush ia dha, i kushtoi gjithë talentin, dikush u thye dhe humbi, dikush u shtyp pa mëshirë, dikush u harrua... por gjithsecili kur doli prej saj, ktheu kokën pas dhe pa çfarë kishte krijuar.

Kadare doli i gjallë dhe nga të vetmit, që nuk mohoi asgjë nga ato çfarë kishte shkruar.

Dikush rrëmoi e rrëmon për të gjetur arradhat e lëshuara nga shkrimtari Diktaturës dhe gjejnë, duke mos kuptuar dhe më keq, duke dashur ta njesojnë shkrimtarin me to.

Shumëkush, që sot shpreh mllefin kundër shkrimtarit, në fundin e gramave të diktaturës, i kërkoj të bëhej prijës, të vihej para revoltave. Kadare thjesht tundi kokën dhe vijoi të shkruante. E kërkuan studentët me forcë në thirrje të zjarra. Ai përsëri tundi kokën. E kërkuan të gjitha forcat politike të bëhej President dhe përsëri ai tundi kokën dhe buzëqeshi hidhur.

Heshte në një plastikë shprehëse, sikur kumtonte. Ende nuk po e kuptoni!? Jam Shkrimtar! Nuk dua asgjë tjetër. Nuk pata asgjë tjetër. Isha i vetëm para letërës së bardhë. Asaj iu fala. Mbi të derdha dashurinë, gëzimin, urretjen dhe mllefin... Gjithçka.

Ajo ishte varri dhe jete ime! Nuk më në fund do ta kuptoni? Nuk jam Njeriu. Jam Shkrimtari. Vetëm ai. Ajo çfarë kam shkruar, vetëm ajo jam.

Është Princi i Letrave Shqipe!

Telefonimi, një tekst prej dhjetë rreshtash, Stalin - Pastërnak (poet – tiran) një ditë qershori e vitit 1934, me pyetjen mbi poetin Mandelshtam, të sapo arrestuar, me 13 variante, (ah sa shumë që janë!). Diktatura ndërtonte tablo sinoptike të panumërta, sepse dall-disja nga pushteti sjell delirim të mendjes për të parë kudo armiq, edhe tek njerëzit më të afër, të gjakut.

Poetët Pastërnak, Mandelshtam (jo vetëm ata) ishin të lidhur si në një letër bixhozi. Njeri lart. Tjetri poshtë. Njeri në darën e pushtetit. Tjetri në barakën e internimit. Fare lehtë mund të ndrronin vendet. Mjaftonte vetëm një vërvitje e letërës nga Diktatori. Thjesht një lëvizje përtacie si një e thithur apo nxjerrje tym duhani pa vlerë. Ky ishte shkrimtari. Një hiç nën kthetrat e diktaturës.

Një pohim therrës si fshakullimë acari nga Kadare, pikturon tablonë, sipas mendësisë shqiptare shteti sovjetik (shteti shqiptar. E njejtja gjë. shën.im) e vërtetoi edhe një herë që ishte mizor, jo sepse u soll keq me poetin (Kadarenë shën. im), por ngaqë u soll tepër... butë” na ka dalë një hall i madh me një poetin tonë, të përkëdhelur nga borgjezia botërore (sa herë u akuzua shkrimtari se shkruan për perëndimin! (Shën. im)na jepni një këshillë ç’duhet të bëjmë me ta. Isha e sigurtë se së paku dy shtete, Shqipëria dhe Korea e Veriut, do të përgjigjeshin të parët: ç’të bëjmë? Ajo dihet. Atë që kemi bërë gjithmonë: plumbin në kokë dhe kjo punë mbyllet”.

Sa lehtë e kishte diktatura! Krimi ishte në themel të ngritjes së pushtetit. Po arti? A mund ta dënonte, demaskonte apo të shprehte dyshimin më të vogël për të? As që bëhet fjalë! Krejtësisht e pamundur. Dhe këtu nis “lufta” shkrimtar – diktaturë. Veprat e mëdha kanë

një gjenerues të fshehtë, që shpërthen papritur, duke drejtuar mendimin e lexuesit aty ku diktatura nuk mund ta ndalonte e ta priste, sepse gërma, fjalia, periudha lexohet ndryshe, krejt ndryshe. A nuk ka ndodhur kështu me veprat e mëdha?

Ecejaku jetë art - shpesh kthehej art - jetë kishte të fshehtat e saj. Mund të shkruaje për një legjendë dhe ajo të kalonte kufijtë e saj dhe të bëhej jetësore, e përditshme. Projektonte të kaluarën dhe shikohej e sotmja. Përshkruante perandori të vdekura dhe ato shfaqeshin në lajme apo TV në përditshmëri. Dykuptueshmëria bëhet stil krijues, mënyrë të shprehuri dhe më shumë mënyrë të menduari. Jo vetëm nëpërmjet rrjeshtave, por leohej aty ku nuk kishte asgjë të shkruar, sepse mendimi i lexuesit tejkalonte leximin. Nuk shijojë vetëm personazhin në format e tij njerëzore. Më shumë kuptoje mendimet e tij dhe për më shumë vijojë të plotësoje mendimet e tij ashtu si ty të pëlqente.

Kthinat e të shkruarit, të fshehtat dhe të papriturat e tij, as që mund t'i kapte kërkush nga Pushteti. Aty ishte krejt i lirë të thoshte atë që donte, duke zgjedhur mënyrën e formën që donte. Të kuptonte kush donte të kuptonte.

Mirë u shkrua, por si do të botohëj? Mekanizmi i botimit kishte kalvarin e dhimbjes. Pasi vepra shkruhej ajo dërgohej apo dorëzohej në shtëpinë botuese, aty fillonte gjyqi i parë, ai i reaktorëve. Shkrimtar redaktor në të njëjtën përgjegjësi. Dërgimi apo më mirë dorëzimi. Sa fjalë e gjetur! Ti duhet të dorëzohesh, ti nuk je asgjë. Tani do gjykoresh. Ne do marrim vendim etj., etj. Dhe dorëshkrimit në redaksinë e shtëpisë botuese mbante gjithë peshën e kryqit, ankthin jo thjesht të botimit, kjo ishte njera anë, më njerëzorja, më e thjeshta. Dorëshkrimi fare lehtë mund të të kthehej në një vetëkallzim, vetëdenoncim. T'i dënojmë e demaskojmë pa mëshirë shfaqjet e huaja që na shfaqen në art dhe letërsi, sokëllinte Diktatori.

“Në Tiranë vazhdonte fushata për njohjen e jetës”, - shkruan shkrimtari. Njohja e jetës ishte thelbi, ku synonte Diktatura. Të njihje jetën do të thoshte të njihje diktaturën në anën e saj raciste në luftën e klasave, aspak njerëzore, të egër, të papranueshme. Po shkrimtari? Ç'ne shkrimtari?! Ai duhet të shkruajë atë që i themi, i diktojmë. Dhe shkrimtari fare lehtë mund të të kthehej në një vetëkallzim, vetëdenoncim. T'i dënojmë e demaskojmë pa mëshirë shfaqjet e huaja që na shfaqen në art dhe letërsi, sokëllinte Diktatori.

Mosnjohja, thekson Kadare. Ajo ishte e kundërta. Mosnjohja lidhet me genien e shkrimtarit. Ai do të shkruaj atë që ai ndjen, kup-ton, do të shprehë. Por kështu shkon në kah të kundër me Pushtetin. Ky i fundit nuk mund ta pranojë. Ndaj vepron. Të shtyp. Shi këtu fillon dyllytimi. Do të nënshtrohesh? Do pranosh diktatin, orientimin apo do rebelohesh?

Rebel. Shkrimtar rebel, duhet të ishte një citim hamngjitës për një shkrimtar, por kjo nuk mund të ndodhte nën diktaturë. Ishte e pamundur. Përtej çdo përfytyrimi.

Autori e njeh në ind Diktaturën dhe e zhbirilon thuaje në shterim, të paktën në ushtrimin e shtypjes në art dhe kulturë. Është fat që një shkrimtar si ai (penë e fuqishme si... etj) të bëj autopsinë e diktaturës.

Libri është një nga përsjatjet më të thella, ku denduria e medimit kadareian arrin në skaje sipërore. Një mahnitje stilistikore. Rreshimi i fjalëve të kalëmend se atje dhe sa këtu. Sa atëhere dhe sa tani.Në një kohë si pakohë.

Pena e tij e kalonbisturinë e kururgut. Ndaj vepra duhet lexuar ngadalë, jo thjesht në periudha dhe fjalë, por deri në shenja pikësimi dhe hapësirat boshe ndërmjet fjalëve.

Stili i tij gjakon ide tek lexuesi dhe vetvetiu e shtyn të bëhet pjes-marrës i gjallë i autopsisë.

Trandja e mendimit shkon në zemër të Diktaturës, në zbërthimin e thelbit të saj, në zbulimin e kthinave të fshehta, mizore, të nëndheshme, gjëmatare, njerëz hije të pushtetshëm në një kapje të të gjithë shoqërisë, si në një rrjetë peshkimi, ku askush nuk del dot.

Me një durim të admirueshëm, tepër hulumtues, autori futet në qerthullin e ngjarjes, shi në qendër të saj për të zbuluar atë që ai di, e ka ndjerë, ka qenë dëshmitar.

“Gjysmë ore më vonë e gjithë Moska e kishte marrë vesh ngjarjen”, dëshmon Zinaida Nikollajevna, e shoqja e Pastërnakut. Po ta ndryshosh qytetin është e njëjta gjë. “Ajo se çfarë tha E.Hoxha për gjysmë ore me vonë e kishte marrë vesh e gjithë Tirana”. Apo ajo se çfarë kishte thënë Honekeri, e kishte marrë vesh i gjithë Berlini një gjysëm ore më vonë. Apo ajo se çfarë tha Kim Jungi i Koresë së Veriut... Po mund të ndrosh kryeqytet si Pragë, Budapest, Pekin, Pehnian, Havanë etj dhe je po njëlloj. Diktatura është njëlloj.

Brenga është një kyç lidhës se sa mbyllës. Është shpjegim. Pse? Shkrimtari jeton një realitet si gjithë të tjerët, më hallet, gëzimet dhe gjithçka tjetër. Kjo e lidh me kohën e gjallë. Kohën ku jeton si qenie. Por në vetminë e studios, ku përpara ka letrën e bardhë, ai jeton në një kohë tjetër, në një liri ta pakufizuar. A nuk ka thënë, lirinë nuk ta jep kush. Atë e ke brenda vetes. Ky është ndërgjegjësimi i shkrimtarit, rubini i çmuar, që përditëson atë, që mendon me atë që është, duke kaluar në atë që mendon se duhet të jetë.

Rusia, jeta moskovite, Instituti Gorki, sivëllezërit poetë, shkrimtarë, e ndërmjet tyre miku i ngushtë letonezi Stullpanz, mjedisi i akullt, që merrte zjarr nga diskutimet letrare, ku gëlonin thashethemet, intrigat, spiunët dhe mbi të gjitha fryma artistike. Ishte fryma ajo që do të linte gjurmë tek shpirti (shkrimtari). Ngjarja është fasada, jo fryma dhe shpirti i veprës.

“Në ditët e fushatës kundër Pastërnakut, telefonimi i tij me Stalnin, lidhur me Mandelshtamin e arrestuar, përmendej si një nga ngjarjet kryesore për ta poshtëruar poetin”.

“Shoku Enver do të flasë me ju... ç' mendoni për Mendelshtamin... domethënë për Lasgush Poradecin, ose për Paskon apo Markon që... burg... mund të ktheheshin prap atje... ose thjesht për Agollin, Qiriazin, Arapin... që... burg... domethënëse ende burg s'kishin bërë. Që t'i biem shkurt, ç' mendoni për veten tënde”. Pra, klithma shtypëse e diktaturës shkon deri në asht, në vetëdenoncim. A ka më thellë?! Vetëshkatërim. Nënshtrim. Përrulje, vetëbaltoje, vetëdënim. Mernri çdo lloj mase. E meritoj! A nuk iu desh autorit të librit të thoshte për një nga veprat e shkruara, me këtë që kam shkruar meritoj të quhem armik i partisë?!

Mendja e artistit është e dyzuar dhe e ndarë në atë të tashmen, të jetuarën me shkuarjen në punë, në leksione, mbledhje e forume partie dhe tjetra ajo e tija, tempulli i gjithpushtetshëm, studio, ku ai mbyllet dhe larg të gjithave e ndjente veten princ, Zot i plotfuqishëm, larg gjithë të tjerëve, në rradhë të parë larg tiranit. “Kjo e dyta, në krahasim me të parën shkruan, ishte e pafundme”. Pafundësia është

e çon në pakohësinë e krijimit dhe në plotfuqishmërinë e shprehjes artistike, e barazon me forcën e tiranit, dhe për më shumë e tejkalon atë.

“Paanësia shkrepte aty-këtu, por s'prapsej sakaq. Isha i huaj, isha ndodhur rastësisht në atë lëmsh. Le të bënin ç'të donin, të pajtoheshin, t'i nxirrnin sytë njeri tjetrit. Unë s'kisha punë me ta. Isha i ndryshëm”. Shkrimtari ve në dukje kinse mëdyshjet, por tërthorazi kuptohet se qenia e tij ishte aty (Moskë) dmth këtu (Tiranë), mendja e tij ishte përtej dy kryeqyteteve. Kishte krijuar “kryeqytetin e vet artistik, një botë ku tiranë, diktatorë, presidentë, pushtetarë, lavire e pijanecë mund t'i bënte bashkë, pra, gjithçka jashtë tij ishin thjesht personazhe. Për më shumë kishte krijuar kohën e tij, një kohë që ecte e lëvizte ndryshe e silllej ndryshe. Mund të ishte njëherazi dje dhe sot në një largim kohor mijvjeçar. Mund të ishte dje dhe të gjithë të kuptonin sot.Mund të shkrunte për Tabir Sarajin dhe të kuptohej Komiteti Qendror, të shkruante për një shëtitje në muzgun e stepave dhe të kuptohej tjetër gjë. Të përshkruante zymtinë e stepave dhe bisedave në Bashkimin sovjetik me përralltaren e famshme dhe të kuptohej “përralla socialiste” e pakuptimtë, që gjithnjë e më shumë, bëhej e tillë e izolimit të vendit. Mund të dëshmonte Kamaren e turpit dhe aty mund të vinte kokën e kujtdo, madje edhe kokën e vet.

Kjo ishte magji e kaluar asaj. Një mrekulli të cilën vetëm Letërsia mund ta krijonte. Ky lloj dyzimi në zbulimin e vet i dha një përmasë të re shtatit. Kuptoi se veç tij nuk kishte Askush pushtet, se Letërsia që shkruante ishte e Gjithëpushtetshme dhe ai sovran absolut i saj.

Të mbante qendrim apo jo, ishte e njejta gjë. Të zgjidhej apo më mirë ta emëronin në poste përsëri ishte e njejta gjë. Si të thoshe po, si të thoshte jo ishte e njejta gjë. Asgjë nuk ndryshonte. Përkohësisht diktatura dhe tirani kishte fituar, por ai e di mirë, është i bindur thellësisht, se ai do të ishte ngadhnjyesi, fituesi i madh. Një arradhë e madhe sivëllezërish ia kishin dëshmuar. Nga verbëria e Homerit, çakërqeji Servantes, filozofi i dashurisë Gëte, Balzaku apo Shekspiri mbretëror, Tolstoi e Servantesi, Dante që hyri e doli nga ferri, e së fundmi Pastërnaku etj., et., etj, që mbushin kupolën qiellore me yje me shkëlqim të ndryshëm, por që të gjithë i jepnin bukurinë marramendësi të Artit.

Pastërnaku i vrarë prej çmimit Nobel. I njejti fat e priste edhe atë vetë, nëse Akademia Suedeze do t'ia jepte atë çmim, që do t'i kthehej në mallkim. Vazhdimi i dyluftimit me diktatorin nuk do të kishte më kuptim. Ai (shkrimtari) që në gjallje të të dyve do të dilte fitues dhe kjo do të ishte fatale dhe nuk do të ndodhte. Ai do të refuzonte çmimin. Duhej patjetër ta shoqëronte mospranimin me një letër shpjeguese, ku ai duhej të ndihej i fyer për dhënien e çmimit. Letra duhej të fil-lonte “Moi, je refusee... çmimin Nobel të dhënë nga borgjezia...etj., etj. vepra ime i kushtohet kominizmit etj., etj. fjalë pa kuptim si të shkruara në jerm. Këtë bënte diktatori të të poshtëronte atëhere kur arrije diçka. Mirë që nuk e mori në atë kohë!

Këtë ndjenjë sovraniteti e ka ndjerë që në nisje të fillimeve krijuese. “Hapja shënimet e romanit dhe, në vend të tmerrheshja prej tyre, me dorën që më dukej se nga çasti në çast do të më ngrinte, shtoja diçka”. Kjo akullnajë paralizuese, shkrin vetvetiu, kur merr penën në dorë dhe ndjen lirinë në kuptimin më të thellë. “Do të ishte Letërsia, ajo që më çoi drejt lirisë, do të shprehej më vonë. Kupton se jetonte në tre kohë. E treta ishte Letërsia. Alucinacion? Marrëzi? Trill joshës apo vdekjeprurës? Anjë nga këto dhe të trija bashkë, të përditësuar si në një shtatore skulpturore.

“Të ishe në listën e Nobel do të thoshte të ishe i damkosur prej gjysmës së tij të rrezikshme. Më kishte rënë shorti të rrijetoja krusmën e tij të mëtejshme, atë që atij ia kishte ndërprerë vdekja. Doja apo sdoja, isha aktori që detyrohesha të lozja atë rol”. Futja në rol. Kthimi në aktor. Krijimi i dy gjuhëve. Dy lloj komunikimesh. Sot kemi mbledhjen e Frontit. Përgatituj! Një fjalë goje. Do shkruaje dhe do flisje atë që diktatura kërkonte. Gjuhë e drunjtë. Jashtë kohës e brenda saj, dmth diktaturës. Kjo ishte frika më e marrë e shkrimtarëve nën diktaturë. Gjuha e drunjtë. Tharja e tharmit. Lëngut letrar. Sa të tillë e ndrydhën artin për të qenë në rregull me kërkesat e diktaturës. Ku e ke heroin pozitiv? Si mund të vdesë nga kanceri një komunist? Ai duhet të ketë vdekje heroike. Pse merresh me këto tema të së kaluarës? Pse nuk trajton temën e klasës puntore? Etj..., etj., deri në mërziti. Dhe Kadare ia doli mbanë. Ta theyej. Ta dhunojë. Ta përbuzë. Ta tejkalojë edhe

pse iu desh të dorëzonte arradha të tëra.

Ti gjendesh vetëm. Të shan një e gjashta e globit.... madje më shumë, ndoshta gjysma, dhe ti hesht”.

Që në titull merr peshë shpjegimi “Kur sunduesit grinden”. Është shkrimtari dhe diktatori. Të dy sundues. Të dy pushtues.

Ndjek ecejaken e lodhshme të botimit të një libri. Ankth. Frikë. Keqkuptim. Pritje e gjatë apo e shkurtër. Dhe në horizont shfaqet prokurori. Ç'ne prokurori? Edhe pse ka një redaktor e madje shumë të tillë për një libër, për botimin e tij nuk janë ata e vetmja pengesë. Dikush tjetër i padukshëm, tejet i pranishëm si një frymë e keqe rri e përgjon. Shkon deri lart. Deri tek diktatori. A nuk kishte kthyer mbrapsh një dramë, të pëlqyer nga e gjithë Byroja Politike dhe përmbysur një festival kënge?

Diktatori kishte turfulluar në një plenum inkuzicioni shi për rolin e arteve dhe të letërsisë, “Çdo shkrim, çdo material i botuar në faqet e gazetave, të revistave e të librave duhet të përshkrohet nga ideologjia marksiste-leniniste, t'i shërbejë edukimit të gjithanshëm komunist të madsave, formimit të njeriut të ri të shoqërisë socialiste... duhet të frymëzojë masat për qëllimet e larta të ndërtimit të socializmit dhe mbrojtjes së atdheut... të rritë frymën militante revolucionare dhe të godasë me forcë ndikimet e huaja të çfarëo lloji që të vijnë ato.... duhet të demaskojë rendin borgjez e revizionist, politikën e tyre antipopullore e agresive, ideologjinë e kulturën e tyre dekadente, të zbulojë plagët sociale dhe të tregojë kalbëzimin e gjithanshëm të sistemit.” Dhe e gjitha shkonte në tehun e luftës së klasave, çmenduri mohuese, në thelb raciste.

Ka apo nuk ka censor? Pyetje idiote. Nuk ka, por ka një më të rëndë, më të thugët, kriminale. Ka autocensurë. Ku ti të duhet të censurosh veten. Pra, edhe pse libri mund të kalojë gjithë hallkat shtetërore të kontrollit, vjen e godet papritur një rrufe shkatërrimtare. Askush nuk e di se nga të vjen. A nuk iu nënshtroa autorit, një nga gjyqet më të tmerrshëm, kur iu desh të përballohej në takime ndëshkuese, që kalojnë mbi treqind të tillë, në një prej romaneve, ku personazh ishte vetë diktatori. Nga kush duhet ta mbronte? Nga vetë ai? Ai si një Zeus shkatrimtar, ai të lëshonte rrufenë dhe të përcël-lonte të gjallë.

Nuk ka rregul. Nuk ka asgjë. Të pritet e drejta të shkruash për tre vjet. Për një periudhë të pacaktuar. Ti nuk e meriton. Nuk e njeh jetën. Shko të edukohesh pranë klasës punëtore. Etj., etj.

Biseda me Stullpansin, letonezin e zgjuar dëshmon atë që ndodhte në Shqipëri me listat e dëbim internimeve, pushkatimeve, heqjen e riskës së frontit, heqjen e së drejtës për të votuar.

“... ndoshta tipari kryesor i enigmave të komunizmit ishte pikërisht shfaqja e tyre aty ku s'priteshin. I biri që kallzonte të atin, gjyshja nipin, ministri rrobaqepësin e vet...”

A e vinte dot në gjuhë tirani poetin? Shkurt, a e rrëzonte dot? E njëjta gjë mund të thuhej për poetin përballë tiranit”. Këturithe-hemi edhe një herë raportit të fillimit: - përballja e poetit me tiranin është e pashmangshme. Dikush kërkon rolinpoetit në përmbsysjen e tiranit. Po si? Iu kërkua shkrimtarit dhe i kërkohet të veprojë, a thua sikur ai nuk ka një jetë të tërë që shkruan, shi për këtë dyluftim të pabarabartë. Në fillimet e përmbsjes së diktaturës iu drejtuan, “Bëhu Havel”! Pse? Bëhu prijës! Nuk jam i tillë. Vepra është e tillë. Unë jo! Jo dhe asnjëherë nuk kërkoi të bëhej prijës. Përse i duhej? Kishte krijuar mbretërinë e tij të lirisë. Kush të donte mund ta gjente aty lirinë e vet. ...shumë gjëra ngjanin, për të mos thënë gjithçka, shkruan auto-ri. S'ka pikë dyshimi për autorin. Si Tirana si Moska ishin njëlloj, në mos Tirana më keq! Aty i feks mendimi, “le të ngjanin sa të donin... kryesorja ishte që unë të mos ngajaja”. Ishte klithma e lirisë. Kuptoi se me Letërsinë ishte i gjithpushtetshëm. Nuk do të ngjante me askënd!

Disa herë dëgjoi dhe e ndjeu thellë në të gjithë qenien se ishte në listë. Lista kishte qenë një shpikja monstruoze diktatoriale. Lista e armiqve të popullit, lista e shkrimtarëve të padëshiruar, lista e bashkëpunëtorëve të Sigurimit, lista e bukës... lista... çdo gjë ishte me listë dhe gjithkush gjendej në listë. Çdo gjë në resht!

Në rast agresioni nga jashtë nga një armik apo kualicion armiqsh, të gjithë në listë të ekzekutohen! Urdhër i prerë!

Në cilën listë je ti? Listë?! Nuk di gjë... Sa tuaf je! Të gjithë jemi në listë...

Ky mund të ishte dialogu apo monologu i gjithëkujt. Nuk je sot, por mund të jesh nesër. Shkrimtari ishte një Hamlet tashmë jo në mëdyshjen “të rroj apo të mos rroj”, por të shkruaj apo të mos shkruaj? Por pa ngurim, i vendosur, pa mëdyshje, vendimtare: - Do të shkruaj! Është tempulli im, Përndia ime – Letërsia. Aty jam sovran! “S'ishte më kot enigma e ne të gjithëve, ajo që niste me pyetjen, a mposhtet poeti prej tiranit, për të përfunduar te mposhtja ose jo prej popullit”.

“Komunistët i trembte arti, udhëzimet e shefave të tyre më të lartë, duke përfshirë Leninin dhe Maksin, ishin aq të cekta, saqë mi-jëra punonjës të kulturës, torturonin trutë ditë e natë për të kuptuar se ç' donte të thoshte Lenini, në të vetmin librushkë të tij për letërsinë: “Organizata e partisë dhe letërsia e partisë”

“...që në letërsi kishte ndodhur një katasrofë, këtë e ndjenin të gjithë”. Pra, kërkohet shembja e gjithë ngrehinës së letërsisë. Vendosja nën zap e letërsisë dhe arteve ishte një nga orientimet e para të pushtetit komunist. Krijimi i organizmit të Lidhjes së Artistëve dhe Shkrimtarëve nuk ishte gjë tjetër veçse një thundër për të mbajtur nën vëzhgim, orientuar dhe drejtuar shkrimtarët dhe artistët drejt kërksave të Partisë shtet. Shkrimtarët dhe artistët e ardhur nga rregjimi tjetër, ai monarkik do të eleminoheshin pothuajse të gjithë dhe një fryjë e re kishte ardhur.

“Ai numër (telefoni) ishte krijuar për një bisedë të vetme, atë që sapo kishte ndodhur...” Telefonon befasisht tirani i vendit. Prej të cilit varej jeta dhe vdekja e gjithkujt.

“...njëherëit e policisë së shpëtitë trazonin me tërbim, por pa shumë kujdes, dorëshkrimet e poetit”, të sjell në kujtesë tërbimin me të cilën iu sulën shtëpisë së shkrimtarit, pas ikjes së tij në Francë.

Lufta në art dhe letërsi ishte e thugët, mizore e njëjtë me një luftë të vërtetë, ku ka të arrestuar, të dënuar, të pushkatuar, të internuar, të burgosur, autorë me pa të drejtë botimi apo me gjysëm apo kinse të drejtë. Marrëzira diktatoriale dhe raciste në thelb, e mbushur me urrejtje ndaj “tjetrit” që ishte ndryshe, dilte nga rradhët dhe guxonte me dykuptueshmëri siç bëri Kadare.

Fliste për popullin dhe ndërkohë ky i fundit ishte kthyer në noc-ion abstrakt nga lufta e klasave, e cila shtonte për ditë kundërshtarët e rregjimit, tashmë gjithnjë e më shumë nga rradhët e veta. Befas herojnëjtë ktheheshin në armiq me një shpejtësi marramendëse.

Vite më parë shkrimtari në mënyrë profetike kishte shkruar, në një duel ndërmjet Poetit dhe Tiranit është gjithmonë Poeti që fiton.



DHJETË KËNGIËT E SIBILAVE NË KUJTIM TË PJETËR BOGDANIT

Nga Rudolf Marku

Në librin e vet Cuneus Prophetarum (1685), Pjetër Bogdani boton dhe 10 poezitë e tij kushtuar dhjetë Sibilave, një cikël poetik që kurr nuk e ka patur vëmendjen e merituar të studjuesve a të njerëzve tanë të letrave.

TS Elioti vë në krye të ‘Waste Land’ – poema më ndikuese e poezisë botërore të shekullit të XX- një shënim për Sibilën e Cumaene-s, ndersa Mikelangjelo, shekuj para TS Eliotit, pikturon ne Kapelen e Sistinës Pesë nga dhjetë Sibilat- ato të Cumaenen, Delfiken, Eritrean, Persianen dhe të Libisë. Ndërkohë ka me dhjetëra piktorë të Rilindjes europiane të cilët kanë dhënë variantët e veta të këtyre figurave misterioze.

Interesi im për Sibilat lindi vite më pare, prej leximit të poezive të Bogdanit tonë kushtuar Sibilave, këtyre pasardhëseve të Kasandrës dhe Orakullit të Delfit. Siç dihet, Sibilat janë gra-vajza Profete të Greqisë së Lashtë, të cilat profetizonin në një vënd të ngjuar (shpellë a yrt i shkretë), fillimisht në Delfi dhe Pesino, dhe të cilave u ishte dhënë nga Apollo jetëgjatësia e përjetshme, por jo rinia e përjetshme. Në shekujt e mëvonshëm, shkrimtarë të ndryshëm dëshmojnë për Sibilat në Itali (Cumaene është një vendndodhje afër Napolit të sotëm), dhe në Azinë e Vogël (Turqia e Sotme).

Pjetër Bogdani mbetet një figurë pak e vlerësuar tek ne- çka ndodh shpesh herë me figurat e shquara të kulturës e të historisë tonë. Edhe pse te poezia e Bogdanit mund të vesh re pika takimi me poezinë e Shën Françeskut të Assisit Laudes Creaturarum dhe me poetët të tjerë të Rilindjes europiane.

Ky cikël poetik është shkruar si një *replica* bashkëkohore e poezisë së Bogdanit, a si një përkujdesje kujtese e krijimtarisë së tij të hershme poetike, e krijimtarisë së njërit prej figurave më të shquara të kombit shqiptar.

SIBILA CUMAENE

“Sepse Sibilën e kam pa me sytë e mi në Cumaene të varurur në një qelqurinë, e kur fëmijët e pyesnin: Sibila, çka don? Ajo gjegjëj: Dua me dekël,, - Tokë e Shkretë, T.S. Eliot

Koha ka mbajtur mirë, të korrat kanë qënë të bollshme, Asnjëherë tjetër Pema e marrëzisë nuk ka dhënë fruta aq shumë sa këtë vit, Varur në degët e reve, sipër rrëpirave të maleve, buzë honesh. Tani, kur Klima e zemëruar Arriti ta gjejë ekuilibrin prapë, Ujqërit kanë zbritë mes njerëzish, duke folë për paqen dhe mirësinë, Ndersa vetë ligësitë kanë komplotuar në certifikatat tua të lindjes.

O Bir i Njeriut, veshur më lëkurën e fishkur të vetvetes, Engjëjt të kanë braktisë prej shekujsh, Të thanë se Shtëpinë e ke në Bankat me shkëlqim, brenda kasafortave të hekurta, Dhe ti nuk dite as me qa; E dashura jote ka shkuar në konstelacione të largëta, Dhe ti vazhdon t’i shkruash letra dashurie, Dhe vetë fëmijët e tu kanë kohë që as emërin nuk ta dinjë, Nuk lozin me dhitë e egëra, majë shkëmbinjëve Dhe u pëlqen elektronika edhe kur qielli asht mbush me yje, Dhe librat e tu kurr nuk i lexojnë. E prapë ti pret që mrekullia të ndodh.

Lavdi marrëzisë së bollshme të këtij viti, Se dhëmbja këtë rradhë nuk do shoqërohet as me rënkime e as me lotë!

SIBILA E DELFIT

Njerëzit vdektarë duan ta shpëtojnë botën nga vdekja, Të ndrymë në një shishe qelqi duan të luftojnë kundër stuhive, Dhe të arrijnë pavdkesinë.

Biri i Njeriut dhe Cjapi dhe Dragoi Do shfaqen në majën e malit duke qarë së bashku me dënesë.

O kohë që je e vetmja gjë e përjetshme, Si mund t’u flasësh ti vetë vdektarëve Për murtajën, kovidin dhe tërmetet shkatërruese?

E përzunë Birin e njeriut që mbërriti mes tyre, e gjuajtën me gurë rrënojash Sepse nuk u premtoi sekretet e pasurisë e të pavdekësive,

Atyne që më parë vdesin se arrijnë të festojnë ditën e lindjes së vet, Dhe që pasurinë e vetme e kanë rregjistruar, Në Bankën kurr të munguar të Nekrologjive.



SIBILA E SHKODRËS

Mjegulla që fsheh kafshimet e moteve, Dhe Liqeni që u sjell ujë plagëve për lehtësim; Emni jem asht Rozafë, a Teutë, a vetë Zoja që e fyeme ka ik Ose vetë Trishtimi që pikon si qumështi i Rozafës

Pikë-pikë, pikë-pikë!

Këtu Kalvari asht si vetë lindja Me dy lumenjt që kryqëzohen si dy heshta përballë Dhe Golgota një shëtitore poshtë mureve të Kalasë Me një kujtesë dardane të ardhun si mall.

Në Kalanë tande ka më shumë Porta se Mure, Ma shumë dhëmbshuri se urrejtje që vjen nga larg, Ma shumë fëmijë që lozin në pluhun se pleq të moçëm Ma shumë dritë që i bishton si metaforë errsinës në natë.

Dhe trishtimi që rrjedh çdo ditë si ritual. Kujtesa këtu dhëmb përherë e më shumë çdo ditë, Edhe pse ushtarët e dikurshëm ngjiten malit drejt Kalasë, Dhe zbresin në muzg asnjëherë pa arritë.



SIBILA E TIBURTINES

Veshur me Diell, mathur me hanë Shfaqet Biri i Njeriut në rrugën e madhe. Demodë, natyrisht. Jashtë katalogëve të modës Veç një grusht fëmijësh të palamë i shkojnë mrapa Kanalet televizive e kanë lajmëruar prej kohësh Trendin e fundit të veshjeve të Botës.

Biri i Njeriut ka humbë, mes Ekuinokseve E kush mundet ta kuptojë marrëzinë globale Të paprekur nga stuhitë deri vone?

Klimat e zemëruara nuk do arrijnë ta kërcënojnë Fatin e marrëzisë tonë!



SIBILA E TIRANËS

Ja tek vjen Biri i Njeriut! Nga maja e rrokaqiejve të Tiranës zbret në muzg Por qyteti është pa hije pemësh, pa prrenj dhe lumenj, Pa një hije të vetme ku të ndalësh të kujtosh se kush je. Zbret me shkallë resh në trafikun e zhurmshëm, Mes pluhurit që varet mbi kaosin modern. Askush nuk e njeh; tek tuk policët shohin me dyshim, Kujtohen befas se Romakët e Ponc Pilatit kishin uniformë tjetër.

Bir Njeriu- Juda Iskariot pret të të puth treqind herë Pastaj do shkojë në Bankën Kombëtare të thyej çekun!

Në lagjen e Bllokut thonë se rubinetët kullojnë gjak Nga qëngjat e therrur.

Dhe Engjëllin që lajmëronte ardhjen tënde E morën në pyetje në një Këshillë Pleqsh.

Vetë Pons Pilati do shfaqet ditën e djelë Për t’i predikuar një populli ateist Biblën e vetëvrasjeve.



SIBILA E PRIZRENIT

Biri i Njeriut u shfaq në malin e Pashtrikut,
Një rrethnajë yjesh mbulon qiellin e natës,
Me të njejtin shabllon të përpikt gjeometrie, si gjëmbat
në kunorën e ardhshme.

Vera është Stinë e Thatë.
Në ditët e fundit të Gushtit do mendojmë të shlyejmë
borxhet,
Pa pasë kohë që të lutemi për shiun.
Shumë nga ditët e mira do të jenë të njajta,
Me një diell të pluhurt si një penel piktori
Që bën dhe ribën peisazhet e shkreta të Anadollit.

Të gjithë e harruan Birin e Njeriun
Në majën e malit të gjelbërt të Pashtrikut,
Veç lulës së terfilit me pesë fletë,
Që lind njëherë në pesëqind vjet,
Edhe atëherë për t'u shkelë nën kambën e këmbësorit të
verbër.

Një erë e nxehtë ka për të fry prej viseve të largëta
Do të djegë më kot pemët dhe gurt,

Lakrimorja e fundit që u gjet në Kalanë e Prizrenit
Është si një sy prej qelqi që nuk mbajti lotë kurr.



SIBILA E LIDHJES SË SHKRIMTARËVE

Nuk e pamë Birin e Njeriut, ishim të zënë më shkrimet
tona.
Lajmësit e dhanë më vonë ardhjen e tij,
Por ne ishim të ftuar në gostinë e Pons Pilatit.

Çdo vit na kërkon të hapim një tunel tjetër,
Në intrigën e subjektit që shkruajmë,
Në Labirinthe e ngatërruara të jetës tonë.

Më kot përpiqemi të shtojmë
Një kapitull tjetër në fundin e librit
I cili kurr nuk do t'i mbyll fletët.

Bibliotekës së Alekxandrisë iu vu zjarri,
Nga lexuesit e zemëruar që kërkojnë një Fund të Lumtur
Si ajo puthja e Judës që kujtohet në shekuj.



SIBILA E PARLAMENTIT

Terrori ka fytyrë të pafajshme,
Flet me elegancën e ajërt e plot dritë;
Është e kotë përpjekja për të dëshifruar kodet e vrasjeve,
Shkruar me alfabetin primordial të Kainit.

I ngritën prapë Tempujt me gjakun e të pafajshmëve,
Stallat e Augeas-it nuk ka kush t'i pastrojë,
Ferri është një destinacion turistik,
duhesh të paguash që të hysh në të.

Në një botë të rrafshët
Dhëmbja për të jetuar sanksionohet me ligje.

O njerëz të fuqishëm, çfarë arritën der më tash,
Veç shtizave, iluzioneve, xhelozisë dhe zilive?
Erdh koha të derdhni lotë për veten tuaj!

Hosanna- për Kainin dhe filistinët e Tempujve
O Bir i Njeriut
Kryqëzimin tënd kërkojnë pa gjetur prehje kurr.



SIBILA E DASHNISË

Kam qënë trëndafili i Sharonit, zambakui i luginave të
Jeruzalemit,
Dhe lulebora e kopshteve të fshehura të Shkodrës.

Zemrat janë vende të rreme si mirazhet,
Në një botë të rrafshët ku askush nuk arrin.

Në cilat shtylla prej hejesh të akullt
Varen lajmërimet e vdekjeve të dashnive?
Cila muzikë alegre do luhet në vdekjen e saj?

O qytetnim pa dashni,
Dhe dije pa rrahje zemrash,
Si një aeroplan me dy krahë të destinuara të thyhen
Në lartësi marramendëse pa shpresë shpëtimi.

Në një shfaqje bamirësie, në Amfiteatrin e Veronës
Rolin e Xhuljetsë e luan një transgjender e bukur vjeneze,
Me flokët e verdha Aryane, dhe me sytë në ngjyrë blu.

Nuk mund të gjesh krime me prova të mjaftueshme për
flakët e përjetshme!




KËNGA E SIBILËS QË NUK ËSHTË LINDUR

Mëshira është mrrolë në trajtën e skeletit të çvarrosun
Në elegancën gjithë përkujdesje të rrathëve të sintaksës
Tek vallëzon mes ngjyrave të ikonografive të modës më të
fundit.

Zotat më të fuqishëm predikojnë Biblat e veta,
Profetët e rinj shkruanë me variantet më të reja të te-
knologjisë.

Rrethuar me flakët e Ferrit që ngrihen der' në qiej,
E kanë më të lehtë të flasin për Ngrohjen Globale,
Për shkrirjen e ajsbergëve të Antraktitës, dëborën e Hima-
lajit,
Dhe të predikojnë se së shpejti vetë Arinjt polarë
Do japin shfaqje me arixinjt e Ballkanit.

Në Ngrohjen Globale, rrethuar nga Flakët
Që ngrihen me një familjaritet sistematik deri natën vonë,
Bir i Njeriut, ja ku shfaqesh mes posterve të mëdha:
The most wanted fugitive in the World !



GUERNIKËN VESH SI KËMISHË

Poezi nga Roland Gjoza

GUERNIKËN VESH SI KËMISHË

tani shoh më shumë filma të vjetër
lexoj klasikët
hapin e kam më të qetë, një bastun do të më bënte punë
dhe një beretë që t'i ngjaja pikasosë
guernika e tij
mund të ishte një këmishë e përshtatshme për mua
se zemra prej kohësh më është djegur
flas, shumë fjalë i shkruaj në ajër
se lexues s'ka
ngushëllohem kur shoh një zog me ngjyra që s'e kam parë
më parë
kur dëgjoj qukapikun në dru
dhe para s'mbaj
e ç'më duhen?
unë rroj me kujtime
i bëj këmbimet e parave në bursën e gjetheve
në ngjyrat dhe aromat e luleve
në ranishten e oqeanit
ku ulet për të pushuar koloni e pulëbardhave
dhe diku
një grua e bukur
dhe uollt uitmani që shkruan; fije bari

DEDALUSI I RI ËSHTË SHFAQUR

dedalusi i ri është shfaqur
nga një mëngë ku fshihet një kartë fati
tryeza është e rrumbullakët dhe në mes të saj nje don
kishot me flatra
ka ngritur shpatën!
diku fausti dhe mefistofeli s'gjejnë qetësi dhe margarita
nëpër muzgje dhe mëngjese argjendti herë vjen herë
zhduket pafajsisht
hitleri kokëposhtë në një kartë bizhozi në dorën e një
mashtuesi
stalini ndjek nga pas hegelin me cilindër që shkon të tako-
jë një damë plakë
fallxhoren e tij që i paralajmëron një ngjitje për lart që ai e
merr për famë
karl marksi le dhe dashnoren e fundit për hir të një karte
përjetësie që ngec në shyllën e krishtit në golgotha, por
nuk kryqëzohet
dhe mao ce duni niset për një rondevu me të gjitha lulet
aty në tryezën e rrumbullakët dedalusi
që përzjen kartat dhe pret fituesin
ikari nga kjo tryezë e rrumbullakët do të dalë
po kartat vonohen si dhjami
dhe papa vrapon me këmbët e nuse lalës të arrijë i pari
se është e rrumbullakët kjo tryezë dhe i ngjan qiellit kur
lutja u ngjit dhe s'u kthye
papa do lutjen të kthehet
dhe luan kartën e fundit
të fitojë në lojën e madhe
shfaqet dhe frojdi si libido që s'ndalet
dhe tryeza e rrumbullakët herë merr formën e penisit herë
atë të vaginës
është magjepsës ky ngashnjim!
dedalusi nxiton të fusë në lojë ikarin e tij
iu vë të gjithëve flatra prej dylli
dhe dihet fundi në zenit në diell
tryeza e rrumbullakët është ende
të gjithë të tjerët kanë vdekur
dhe si përfundim nuk ka fitues!
vetëm një don kishot me flatra
ka ngritur shpatën!

KËPUCA TJETËR E HIRUSHES

frymëmarrja u prish
më shumë shfryjmë
se sa thithim
sepse urryem dhe ulërimë
sepse inatin e shpërthyem si minë
thithëm dashurinë
ajo qe frymëmarrja më divine
thamë fjalë
po më e bukura
të dua
u thith
se dashuria ishte brenda
në një skutë
hirushe
me një këpucë
tjetra s'u gjend kurrë
s'kane fat ata që thithin
ata që dashurojnë
po ata që shfryjnë
ata që ulërijnë
ata që shkatërrojnë
të dua
nuk u tha
të dua
u ndje
u thith
bashkë me kundërmimin e luleve
të kurmit tënd virgjin
luftë!
shfryjmë
luftë!
shpërtheu me ulërimë
të dua po humb
ah, këpuca tjetër e hirushes
që s'u gjend kurrë

GRUA, TI JE E KEQKUPTUAR

grua, ti i ke të treja prandaj je e keqkuptuar;
kur lind ti je nëna dhe prej qielli i ke tiparet
nuk zgjon cingiz khanin kur pushtonte botën, po vetëm
krishtin kur ecte në shkretëtirë
me një shkop bariu të shpëtonte kurvën, maria magda-
lenën
kur je vajzë ti zgjon tundimin me veskujt e freskët te gjin-
jve dhe kofshëve
me afshin prej zjarri të pyjeve të verës që digjen prej një
rrufeje të kaltër
grua, ti ke përvojen e mishit dhe mëkatin e epshit të pang-
injur
dhe mund të bëhesh prehë e lehtë e ujqërve që të vijnë
rrotull
por ti s'jepesh se dashuron burrin tënd sipas zakonit
shtyp dhe ha me dhëmbë mëkatin imagjinar të tradhtisë
grua, ti je e rrezikshme se tundon të rinjtë
që vuajnë prej paditurisë, lakmojnë mishin, me pasionin e
errët
por t'i di t'i japësh të rinjve nënën për t'i zbutur
dhe vajzën për t'i joshur vetëm me një prekje a një puthje
grua, ti e pathyeshmja prej pushtuesve, herë troja, herë
thermopilet
te këmbët e tua bien ushtri që luftën humbën
ndërsa burrat bien të parët
prej tundimeve, tradhtive, pabesive
ti e fundit bie
të ndihmon krishti!



GRUAJA ME SATEN TË VERDHË

cigare s'kam, as verë as gruan bionde me saten të verdhë
në këtë natë te errët pa hënë, me një kujtim te tmerrshëm
që më dhemb; gruaaja me saten të verdhë kur vallëzonim
në verë dhe binte shi në plazh në rërë
dhe ne lageshim po na lëpinin puthjet në të gjitha vendet e
trupit ku ka zemra
gjersa na zuri muzgu i kaltër dhe pulëbardhat s'fjetën, po
na erdhën te këmbët
cigare s'kam as verë as gruan bionde me saten të verdhë
as atë që nuk di ku humbi në errësirën si fund i një filmi që
s'duam të ketë fund
ndez një fije shkrepëse dhe marr flakën e saj me vete të
djeg errësirën e errët
të kërkoj gruan bionde me saten të verdhë, kur i rrëshqiti
sateni i verdhë te këmbët në plazh në rërë
dhe pulëbardhat nuk fjetën, shikonin kurmin e saj dhe
satenin e verdhë që kishte dhe ai flakën e vet
po dashuria është si lulet, çel dhe për dy tri ditë tretet,
pastaj përsëri çel për një tjetër
marr flakën me vete në errësirën e errët të gjej gruan
bionde me saten të verdhë
dhe po s'e gjeta do të vallëzoj me flakën në tajms skuer në
mes të policëve që do më qeshin
ej, shiko, një dashnor i çmendur vallëzon me flakën e një
fije shkrepëseje!
cigare s'kam, as verë, as gruan bionde me saten të verdhë
po vetëm flakën e një fije shkrepëseje që më zgjat duart
dhe vallëzojmë tango në tajms skuer
ah, gruaaja bionde me saten të verdhë..

MË MIRË TË MOS ISHIN MËNGJESET

më mirë të mos ishin mëngjeset
që të mos shiheshim, se dashuri s'ka më
më mirë të ishin vetëm mbrëmjet
që të kishim kujtimet që dhembin
dielli nganjëherë lind në mbrëmje
dhe perëndon në mëngjes
dua të shoh diellin që në mbrëmje lind
dhe t'i kthej kurrizin
sepse dua të shoh perëndimin në mëngjes
ndoshta dashuria e gjen një vrimë në kujtime
dhe del, kjo shpresë e marrë më ndjek
prandaj kurrizin i kthej diellit në mbrëmje
sepse dua të shoh perëndimin në mëngjes

PRANVERA S'VJEN VETËM PËR DRURËT

pranvera s'vjen vetëm për drurët
një zog fluturon rrotull kurmit tënd
kërkon të ngrejë fole në gropkën e gjinjve
e largoj me duar
ai vjen sërish të ngrejë fole në kofshët e tua
shkon dhe vjen me një fije kashtë në sqep
dhe cicërin
sikur më lutet
mos më largo me duar!

e kuptoj më në fund se dhe ti je një pemë e lulëzuar

PËRVJETOR MKATESH

Poezi nga Rozafa Shpuza



PËRVJETOR MKATESH

Asht vjeshtë e një vjeti t’thinjun...
Gjyshi pin cingare Tarabosh
e mirazhi i syve dridhulatet përhanshëm në misterin e shtëllungave
që ju përgjasin luleborave rranxë murit.
Çakmaku shkrepë veç nadje herët,
mandej cingaret përshkohen vargevi
tue u lidhë ny në gacën e mbrame,
t’strukun mes dy gishtave bojsepie.
At’ vjeshtë piva tinzash cingaren e parë...
E pimë në grup tanë fmitë e lagjes
tue e thithë me rradhë si mkatin ma naiv.
Gjyshi s’e mori vesh se i mungonte ajo cingare,
kurse na e lamë fajin me stërpikat e makinës kabahe
që lagte ngeshem pervlimin e asfaltit.
Vjeshtën e atij vjeti
hyna shkujdesun në botën e mkatarve,
kukllat e pecave i msheha nën minder
e shpinden e kerrusa paksa
prejse i druhesha kryeneçsisë së cicave.
Anipse gjyshi ka kohë që asht ba një me shtëllungat,
ka net kur ma ka anda me pi cingare tarabosh,
si me dashtë me festue pervjetorin e mkatit tem të parë.

SHENJA NË GJU

Në gju kam një shenjë picigjate
njajtë me shigjetën e Kupidit
e kur pellgjet marrohen
prej pasqyrimit të përmbysun të kofshëve,
kocat kërcasin
tue imitue dyzimin e timonit
ditën kur mësova biçikletën...
Na ishim fëmijët e Dugajve
e radhën e caktonim me “tek a çift”,
mandej harkonim shtatin nën hekur
tue u rrekë me ba zapt atë biçikletë gjigande
me samar të lidhun me tel.
Sa herë retë e mbarsuna më nisin mesazhe
më therë shenja mbi gju
e m’duket se ndiej zilen e gazmendit fëminor
që lajmëron se njeni prej nesh
mësoi me e nisë vetë
biçikletën shkatrraqe të jetës...

DYER PA ÇILCA

Në shpinë tonë dyert ishin pa çilsa
e përdita kalamendej nga njena odë në tjetrën
e pandryshueshme
si lutjet që gjysha këndonte nën za
teksa njehte nyjet e një filispaje të sajueme si tespije.
Shtrojet e pecave ju përgjithnin rrugicave qorre
me destinacion të paracaktuam
e tanë rrugtimi jem ishte një lojë shahu pa fitimtarë.
Tash që shpija e vjetër u zhba
si në epilogët e përrallave me gogolë
e ndiej përditën të shfaqet prej birave të çilsave
që kurrë s’u përdorën
krejt si në fokusin e një aparati
që s’rreshtë së fotografiuemi.

KANGA E GOZHDËS

Asht një gozhdë
ngulun mbi shtëllunga plasash
që harbohen si flokë shtrigash
tue i dhanë murit një pamje mitike.
S’mbahet mend kush e nguli
e çka ban saora atje mes sekrete bojnash,
t’stivue me një mbi një
si teshat e dekës në baulen e gjyshes.
Asht një gozhdë
ngulun mbi mirazhe t’ujshme
që ngutem me i fiksue ndër fotografitë bardhezi.
Medet, edhe këtë pranverë harrova me i ba një ny frymimit,
kësisoj dashnitë u shprazën si rruzat e lutjeve
mbi qylymin dalëboje prej pelegrinazhit të hapave.
Asht një gozhdë ngulun në mue
që më mban varun,
anipse tasheparë preki me gishta tabanin e andrrave.


GRUEJA FANTAZËM

Asnjeni prej fëmijëve t’lagjes
s’e dinte kuptimin e fjalës “prostitutë”.
As gjysha s’e dinte...
E kërkuem m’kot edhe n’fjalorin
me shkronja t’preme si shkallë
n’kursin e italishtes
te shpija e zotni Ndoci...
Dinim veç se në Shkodër
endej me biçikletë një grue fantazëm,
prejse asnjeni s’guxonte me e pa n’sy.
Hamendjet që s’ua rrëfyem as ditarëve
ua zunë vendin lojnavë të fëminisë...
Një ditë u shpërndamë nëpër botë
për me u takue prorre
kur shpinat na ishin kërrusë paksa,
e s’u çuditëm aspak
kur ndjem mall për gruen fantazëm
që dikur pat’ qindisë fantazitë tona rrebele.

MESDITË MAJI

Im atë luen shah n’oborr
me sy t’picrruem rreshton ushtarë drunit
mbi kuadratet e njeshun solemnisht si paradë maji.
Aty ku pikon truma
lugu asht birue n’qasje t’synit t’ciklopit,
e gjysha s’pranë tue m’porositë
se trumës duhet me i qitë sipër pak ujë

sa me shpërla ndryshkun.
Im atë luen shah n’oborr
në pamundësi me gjetë arsyen pse antena e radios
e lidhun për tandën me hardhi të krasituna
s’asht e zoja me kapë një tjetër stacion,
përpos marshit solemn të paradës.
Jam veç 13
e sandalet e reja m’i shtërngojnë gishtat
teksa marshoj mbi kuadratet bardhezi.
Im atë luen shah n’oborr
me shpresë se radioja ka me këndue një tjetër himn
e unë kam me nga’ zbathtë n’një fushë pa kuadrate.



NJË SULM I TË PËRDITSHMES GJERMANE *Frankfurter Rundschau* NDAJ DANTE ALIGHERIT



**Përgatiti, përktheu nga gjermanishtja
dhe italishtja ARISTIDH SHQEVË**

Me rastin e shtatëqind vjetorit, u festua në Itali më 25 mars 2021, Dita e Dante-s. Në të njëjtën ditë, kritiku gjerman, Arno Widmann, botoi një artikull në revistën letrare Frankfurter Rundschau. Artikulli i tij, i cili bënte një analizë Dante Alighieri-t dhe veprës së tij madhore, shkaktoi një reagim të menjëhershëm të shtypit dhe të të gjitha mediave. Për shumicën e gazetave, botimi i artikullit të Widmann-it u konsiderua si veprimi i dikujt që fillimisht mbjell erën e pastaj i duhet të korrë furtunën. Në faqet e para të gazetave u panë tituj si: *Sulm i pabesueshëm nga Gjermania* – La Repubblica, *Gjermania na fyen edhe me figurën e Dante-s* – Il Secolo d'Italia, *Sulm nga Gjermania* – La Stampa, *Dante – egoist dhe plagjiator?* – Il Fatto Quotidiano, *Dante, sulm i një të përditshme gjermane: Kopjoi gjithçka nga një arab* – La Stampa. *Dante dhe gazeta gjermane: sulm i egër i Frankfurter Rundschau* – La Nazione

Nga ana tjetër, aty këtu u dëgjua edhe ndonjë zë i rrallë në mbrojtje të artikullit të Arno Widmann-it. Njëri prej tyre ishte edhe gazetari Roberto Saviano. Me një postim të tijin në facebook, ai shprehet: 'Shikoj nëpër mediat sociale një polemikë absurde që e ka zanafillën te një artikull i botuar në Gjermani. Dua t'ju tregoj këtu se edhe një artikull shumë i mirë i një analize letrare mund të përdoret si mjet për arritjen e qëllimeve të veçanta nga populizmi i pafytyrë. Dante-s nuk i bëhet asnjë sulm nga Gjermania, siç sugjeron ndonjë gazetar apo politikan, dhe nuk ka kurrfarë akuze në drejtim të tij se ai është një plagjiator. Nuk ekziston asgjë e tillë, madje nuk ka as edhe një hije të vetme. Ka vetëm mungesë kapaciteti për t'i lexuar dhe kuptuar tekstet e shkruara', përfundon ai.

Sipas gazetarit Roberto Vivaldelli, Saviano nuk argumenton dhe nuk jep shpjegime në postimin e tij se ku qëndrojnë gabimet në përkthim të shtypit italian. Ai thjesht shprehet se e njeh mirë Widmann-in, dhe në të njëjtën kohë akuzon gazetarët italianë. Drejtori i Galerisë Uffizi në Firence ishte nga të parët që reagues ndaj shkrimit të Arno Widmann-it. Po kështu, edhe gazetarja Chiara Pozzati i përgjigjet atij me një shkrim në gazetën Il Quotidiano Nazionale.

TË MIRIT SHPËRBLIM, TË LIGUT NDËSHKIM

Nga Arno Wiedmann

Frankfurter Rundschau

Shtatëqind vite pas vdekjes, festohet në Itali, por jo rastësisht më 25 Mars, dita e Dante-s.

Më 14 shtator, 1321, florentini Dante Alighieri vdiq në mërgim në Ravenna, por, përse vallë shkruhet sot ky artikull për të? Njëzetë e pesë marsi i vitit të kaluar u prezantua si Dita e Dante-s në të gjithë vendin. Çdo vit, poeti më i madh i Italisë do të përkujtohet në këtë datë. Por përse më 25 mars? Pikërisht në këtë ditë, të Premten e Madhe të vitit 1300, thuhet se ai nisi udhëtimin e tij nëpër ferr, purgator dhe parajsë. Dante-s i pëlqen të luajë me numrat. Poema e tij e madhe, 'Komedia Hyjnore', fillon me fjalët: 'Pasi kishim përshkuar gjysmën e udhëimit të jetës, erdha në vete në një pyll të errët. Shtegun që duhej ta ndiqja, e kisha humbur.' (Përkthimi: Kurt Flasch). Meqenëse datë regjistrimi të lindjes së Dante-s nuk ka, bazuar në deklaratën e bërë me rastin e përvjetorit, i bie që Dante të kishte lindur në vitin 1265. Njëzetë e gjashtë marsi, data e pagëzimit të tij, një e Shtunë e Madhe, na është lënë trashëgim. Dhe ja, rastësisht, ai u pagëzua me emrin Durante, i cili shumë shpejt u shndërrua në Dante.

Vijmë kështu në midisin e arritjeve që Dante pati gjatë jetës së tij. Italia e vlerëson atë si një nga kontribuuesit, të cilët e ngritën gjuhën kombëtare në lartësitë e një letërsie të madhe. Në një farë kuptimi, ai e krijoi gjuhën në funksion të veprës së tij. Gjuha e Dante-s u bë gjuha e lexuesve të tij dhe më pas e italianëve. Por kjo është rrëguar. Askush nuk do të fliste kështu sot, sidoqoftë, gjashtëdhjetë vite më parë, ishte pikërisht kjo ajo që iu thuhej nxënësve italianë. Për më tepër, këta nxënës ishin të vetëdijshëm se Dante-n ata nuk e kuptonin dot. Teksti i Dante-s kishte nevojë për deshifrim. Komedia Hyjnore - dhe jo vetëm botimet shkollore - u mbushën me shënime që jo vetëm shpjegonin fjalë të veçanta, por njëkohësisht ndihmonin lexuesit modernë që të orientoheshin përmes sintaksës së Dante-s. Gjuha ama ishte italishtja, dhe jo latinishtja.

Në këtë vepër do të flitej, në nivelin më të lartë filozofik dhe teologjik, për Zotin dhe botën. Në gjuhën 'vulgarë', domethënë në gjuhën e thjeshtë të popullit. Pra, në gjuhën që prindërit tanë na folën kur ne sapo kishim lindur, gjuhën me të cilën ne u rritëm, dhe nëpërmjet së cilës artikuluam për herë të parë ndjenjat tona. Sidoqoftë, veç kësaj ekziston edhe gjuha me anën e së cilës ne mësojmë ta kuptojmë atë, gjuha e shkencës që na tregon se si është vetë bota, por edhe si ajo duhet të jetë.

Kur e lexojmë këtë vepër, kemi të drejtë që mendjen ta çojmë te dyzimi që ekziston midis gjuhës amtare dhe latinishtes. Sidoqoftë, kjo nuk është e mjaftueshme nëse ju e preferoni Italinë, dhe nëse doni ta kuptoni situatën në të cilën italishtja ndodhej në shekullin e 13-të. Fushata kundër sektit fetar të Katarëve në Occitania, në jug të Francës (1209-1229), jo vetëm që shkatërroi nga themelet një pjesë të mëdhe të Provansës, por edhe lejoi shumë prej trubadurëve të saj të kërkonin strehim në gjykatat e huaja. Këta autorë në mërgim iu erdhën në ndihmë poetëve vendas, të cilët në shumë pjesë të Evropës flisnin gjuhën e tyre amtare. Italia mbeti prapa këtij zhvillimi. Kjo është aq e vërtetë, saqë mund të thuhet se: 'Poezia e parë e artit në gjuhën amtare në Itali u shkrua në dialektin Provansal'. Brunetto Latini, një mësues dhe mik i Dante-s, enciklopedinë e tij të titulluar 'Libër Thesar' e shkroi në frëngjisht. Jo vetëm sepse e botoi atë gjatë mërgimit në Francë, por edhe sepse e dinte që lexuesit e gjuhës frënge do të ishin më të shumtë.

FR
FRANKFURT RHEIN-MAIN POLITIK MEINUNG ZUKUNFT EINTRACHT MEHR

2 f t v Veröffentlicht am: 25.03.2021 - 14:11

GÖTTLICHE KOMÖDIE

Dante: Die Guten ins Töpfchen, die Schlechten ins Kröpfchen

von Arno Widmann

100 Jahre nach Dante: Erinnerungen, nicht zufällig an einem 25. März.

Am 14. September 1321 starb der Florentiner Dante Alighieri im Exil in Ravenna. Warum also heute ein Artikel über Dante? Im vergangenen Jahr wurde in Italien der 25. März als Dantetag eingeführt. Jedes Jahr soll an diesem Datum an Italiens größten Dichter erinnert werden. Warum am 25. März? An diesem Tag, einem Karfreitag des Jahres 1300, soll er seine Reise durch Hölle, Fegefeuer und Paradies angetreten haben. Dante liebt das Spiel mit den Zahlen. Sein großes Gedicht, die „Göttliche Komödie“, beginnt mit den Worten: „In der Mitte unseres Lebenswegs kam ich zu mir in einem lunklen Wald. Der rechte Weg war da verfehlt.“ (Übersetzung: Kurt Flasch). Da ein Geburtsdatum nicht überliefert ist, schloss man schon früh aus dieser Angabe, Dante sei 1265 geboren worden. Überliefert ist ein Taufdatum, ein Karsamstag, der 26. März. Getauft wurde er übrigens auf den Namen Durante, der schon bald zu Dante zusammengezogen wurde.

Vomit wir schon mittendrin sind in der Lebensleistung Dantes. Italien preist ihn als einen von denen, die die Landessprache zu den Höhen großer Literatur geführt haben. Er hat sich gewissermaßen die Sprache für sein Werk erschaffen. Aus dieser Sprache wurde die seiner Leser und dann die Italiens. Das ist verkürzt. Niemand würde es heute so sagen, aber vor sechzig Jahren wurde es so jedem italienischen Schulkind erzählt. Dabei wusste dieses Kind, dass es Dante nicht verstand. Es musste eine Textzeile entziffern. Die „Göttliche Komödie“ – und nicht nur die Schulausgaben – waren gespickt mit Anmerkungen, die nicht nur einzelne Wörter erklärten, sondern dem modernen Leser auch





Në Itali, me vështrimin e hedhur nga modelet provansalë, tekstet në gjuhën amtare ishin fillimisht poezi dashurie. Ashtu si edhe trubadorët, poetët italianë thurën këngë për gra imagjinare, por edhe të vërteta, duke i ngritur ato në qiell dhe duke i dendur me metafora. Asgjë tjetër nuk ndodh në ‘Komedinë Hyjnore’ të Dantes. Ne as që e kemi idenë nëse Beatrice, e ngritur lart në këngë e në vargje nga autori, ka ekzistuar ndonjëherë. Megjithatë, ne e dimë që - ashtu si edhe modelet e tij - Dante ishte shumë i interesuar që të krijonte një ngrohtësi ndjesie, e cila përveç zhvillimit të të gjitha arteve të elokuencës, duhet të linte pa frymë nga habia çdo person imagjinar të cilit i adresohet, dhe mbi të gjitha, lexuesit e të dy gjinive. Ka persona që pëlqejnë të tregojnë mospërfillje për një ndryshim thelbësor: Trubadorët ishin rapsodë popullorë, nga kryeveprat e të cilëve ka mbetur vetëm teksti, kurse Dante synonte të arrinte të njëjtin efekt - pa muzikë. Ai ndjehej sikur të kishte hyrë në garë me dikë. Dëshironte ta tejkalonte vetveten. Merrej me të pamundurën dhe ndjehej si në shtëpinë e tij.

Në traditën myslimane ekziston rrëfimi i udhëtimit të Muhamedit në parajsë. Jo, ka raporte e komente, dhe të tilla ka pasur që nga vitet 60-të të shekullit të trembëdhjetë. Bëhet fjalë për përkthime në latinisht dhe italisht që i përkasin atij shekulli. Në vitin 1919, studiuesi spanjoll Miguel Asin Palacios, botoi një studim të gjerë në të cilin pohonte se Dante ishte në dijeni të tekstit të vjetër arab, dhe atë tekst ai e shfrytëzoi. Shumica e mbështetësve të Dante-s e panë këtë si një produkt të një imagjinate të shthurur. Ata e kuptuan se veçantia e heroit të tyre po vihej në dyshim. Dhe t'i bësh padrejtësi Dante-s, do të thotë t'i nënvlerësosh ambiciet e tij sportive. Ashtu siç e bëri poezinë provansale të dukej e vjetëruar, në të njëjtën mënyrë ai mund të ketë ëndërruar që ta tejkalonte ngjitjen myslimane në parajsë nëpërmjet ithtarit të tij të krishterë.

Poema me më shumë se katërmëdhjetë mijë vargje të plotë synon të ndërtojë një urë me një shtrirje kohore njëmijë e treqind vjeçare me Eneida-n e Virgjilit. Një vepër e këtyllë ka nevojë për një ego të jashtëzakonshme. Ajo ka nevojë gjithashtu për një fabrikë vargësh që është në gjendje të troshitë një personel prej gjashtëqind personash nëpërmjet një pleksje trishe, në mënyrë të tillë që të jetë gjithmonë e qartë se: ti i përket ose kategorisë së njeriut të mirë, ose njeriut të lig. Vullneti i thjeshtë për t'i futur të njohurit dhe të afërmit në dhomat e ferrit dhe ndarjet e purgatorit, për të ndëshkuar mendje të mëdha dhe sundimtarë për të cilët nuk dihet pothuajse asgjë, nuk do të mjaftonte për një vepër të tillë. Këtu kërkohet fëlligështi. Fëlligështi në gjykim dhe ndëshkim. Leximi dashamirës i mësuesit godet Francesca da Rimini-n dhe të dashurin e saj Paolo-n, duke përshkruar me

imtësi skenën dhe ndjenjat e dashurisë së të dyve, të cilët, me shkas një libër, përfundojnë në krahët e njëri-tjetrit. Çdo lexues provon një ngazëllim të thellë. Por përse e marrtë e mira përfundojnë që të dy në ferr? Dante tregon interes dhe ndjen keqardhje për ta. Pikërisht këtu kemi mbërritur në një pikë të rëndësishme. Në një tekst apokrif të Dhiatës së Re, një ithtar deklaroi se ai ndjen dhembshuri për të dënuarit. Sidoqoftë, në të gjithë Dhiatën e Re kjo fjali nuk ekziston. Ajo është parë si e padëshirueshme. Këtë e thotë vetë Dante. Ishte Zoti ai që vendosi për t'i dërguar të dy të rinjtë në ferr. Megjithatë, Dante nuk pajtohet aspak me këtë. Kritika bëhet më e ashpër kur e mendon se nuk ishte Zoti ai që dërgoi Paolo-n dhe Francesca-n në ferr, por poeti Dante Alighieri, i cili me sa duket e bëri atë vetëm për ta qortuar Zotin. Jeta e pëtejme është një botë e çuditshme. Përveç disa qenieve mitologjike dhe engjëjve të rënë nga qielli dhe të ngritur sërish, aty ka vetëm qenie njerëzore. Suprimimi i madh zhduket. Asnjë pemë nuk gjallon, asnjë gjë e gjallë nuk ekziston. Ekziston – le ta themi thjesht – një visore. Aty gjithçka është vendosur sipas qëllimit. Ja, për shembull, Për Malin e Dëlirjes është shkruar shumë. Por, ç'ndodh në brendësinë e tij? 'Një dhomë për secilin më vete?' A është ajo pjesë e planit të brendshëm qiellor apo pjesë e skëterrës? Këtu ka edhe diçka tjetër që të bie në sy. Për Beatrice-m flitet shumë. Gjatë pelegrinazheve ajo bëhet Maria, por edhe një filozofe. Është pra, pikërisht stilizimi i lartë i 'të dashurës' së adhuruar që ishte në modë në poezinë trubadore. Veç kësaj, gruaja e Dante-s, dhe fëmijët e tij nuk shfaqen. Ata nuk paraqesin interes. Deri në zbulimin e jetës martesore që paraqitet si udha drejt lumturisë; ndoshta duhej të kishim pritur Luther-in dhe Reformimin.

Kërshtëria e Dante-s ishte e pafund. Sidoqoftë ai nuk endej më kot. Angazhohej në punën e tij ose në punët e posaçme, të cilave i përkushtohej. Kjo mund të shihet fare mirë në mënyrën se si ai e shfaq Odise-në në kanton e 26-të. Dhe në këtë mënyrë ai prezanton Kanton e Ferrit. Një a dy shekuj pas Dante-s, humanizmi italian sajoi termin 'ulissimo' pikërisht për atë lloj kurioziteti aktiv në të cilin Perëndimi, që atëherë, njohu me kënaqësi vetveten. Paraqitja e Ulksit (Odise-së) nuk është aspak e shkurtër në veprën e Dante-s; ai rrëfen përpjekjen e tij për ta kaluar ngushticën e Gjibraltarit. Një uragan i fuqishëm goditi anijen e tij, thotë ai, 'dhe më pas deti u shemb mbi ne'. (Përkthimi: Hartmut Köhler). Pra, një fund i papritur e dramatik që ka ndikim edhe sot.

Udhëtimi i Dantes- në botën e pëtejshme, i shkruar ndoshta ndërmjet viteve 1307 dhe 1320, duhet të vendoset pranë një libri tjetër udhëtimi. Atij të Marco Polo-s. Tregtari venecian (1254-1324) kishte shfrytëzuar, si qëndrimin e tij në burg (1298-1299), ashtu edhe mbështetjen e një autori

të romaneve kalorësiakë për të shkruar suksesin e tij të jashtëzakonshëm, të titulluar *Libri i mrekullive të botës*, (edhe një herë tjetër!) në frëngjisht. Kjo është antiteza e udhëtimeve vegimtare të Dante-s në botën e pëtejme. Të dy autorët gërshetojnë imagjinatën me të vërtetën, si edhe besimin me dyshimin. Pavarësisht sesa e drejtë është të flasësh për Dante-n si 'poeti i botës tokësore', do të ishte krejtësisht absurde t'i injoroje pretendimet e tij profetike, si dhe ndjesinë fetare të misionit të tij.

Mrekullitë e botës nuk bëjnë pjesë në temën që ai shtjellon. Të paktën, jo në *magnus opus*-in e tij. 'Traktati mbi ujin dhe tokën' është një pjesë e shkencës së gjithësisë dhe filozofisë natyrore. Natyra është një nga mrekullitë e Zotit, por ky entuziazëm për stringla të larmishme, nëpërmjet të cilave tregtari Venecian Marko Polo shikon mongolët dhe kinezët, popujt, zakonet dhe tregtinë e tyre, humbet tërësisht tek vepra e Dante-s. Sidoqoftë, është e rëndësishme që ta sjellim ndërmend njërin prej tyre në rastin kur përmendet tjetri, përndryshe do të na krijohet ideja se fiksimi fetar i Dante-s është karakteristikë e një epoqe dhe jo diçka që e shquante atë.

Ende nuk jam shprehur për Gibelin-ët dhe Guelf-ët, po kështu nuk kam thënë asnjë fjalë përse Dante kaloi në proces gjyqësor, përse iu desh që ta braktiste Firencen, dhe pse refuzoi të kthehej me kusht në qytetin e lindjes, kur iu dha mundësia për ta bërë një gjë të këtyllë.

Më lejoni që sot, me rastin e Ditës së Dante-s, të bëj një tjetër krahasim. Poeti katolik anglez, T. S. Eliot, botoi një traktat të shkurtër për Dante-n më 1929. Përkthimi gjerman i shtëpisë botuese Suhrkamp gjendet në vëllimin 'Was ist ein Klassiker?' Fillimisht, poeti anglez shpjegon se Dante është i thjeshtë në lexim. Kjo është për t'u çuditur. Megjithatë ai ka të drejtë. Të paktën për mënyrën se si lexohen shkrimet e tij. T. S. Eliot vendos Shekspirin përbri Dante-s, dhe më tej krahason metaforat e veçanta me një saktësi të madhe. Këtë e bën sepse ajo çka binte më shumë në sy, ishte ndoshta aq e qartë për të, saqë dëshirë për ta ravijëzuar atë nuk kishte. Do të mjaftonte t'i hidhej një vështrim Shekspirin për ta kuptuar se ku qëndrojnë vështirësitë tona me Dante-n. Pandershmëria e Shekspirin, përshkrimi nga ana e tij i asaj që ekziston – është në të njëjtën kohë edhe imagjinata e vetë poetit! Shekspiri duket vite dritë më modern sesa orvatja e Dante-s për të pasur një mendim për çdo gjë, si edhe për të tërhequr zvarrë gjithçka drejt bankës së akuzuarit, me bazë moralin e tij. Vepra gjigante e Dante-s i jep mundësinë poetit për t'i paraprirë Gjykimit të Fundit, për t'i kryer punët e Zotit, si edhe për t'i ofruar shpërblim të mirit e ndëshkim të ligut.

Përktheu: Aristidh Shqevi

SULMI VEÇUAR NGA NJË PROVOKATOR INJORANT

Nga Eike Schmidt
Drejtor i Galerisë Uffizi, Firenze

Gazeta italiane La Nazione, 25 mars 2021



Drejtori i Galerisë Uffizi, Schmidt: 'Arno Widmann është i njohur për provokimet e tij, ai është një konspirator. Wiedmann nuk përfaqëson as pikëpamjen e përgjithshme të Gjermanisë për Dante-n dhe as ndonjë rrymë të veçantë mendimi.'

'Arno Widmann? Ai është një personazh i polemikave të forta që gjithmonë provokon të tjerët me synimin që ata ta zënë në gojë në lidhje me teoritë e tij qëllimsht ngacmuese dhe, nganjëherë, edhe për tema që kanë të bëjnë me komplete. Duke dashur të flasë me keqdashje për Dante-n, ai sjell argumente që absolutisht nuk qendrojnë. Mendimi i tij nuk përkon aspak me mendimin e përgjithshëm për Dante-n në Gjermani dhe për më tepër, ai nuk përfaqëson asnjë rrymë të veçantë mendimi'.

Kështu deklaroi sot pasdite në stacionin radiofonik Lady Radio, drejtori i Galerisë Uffizi, Eike Schmidt, në përgjigje të pyetjes së drejtuesit të emisionit në lidhje me artikullin e botuar në gazetën gjermane Frankfurter Rundschau. Artikulli mban firmën e gazetarit dhe bashkëthemeluesit të gazetës 'Taz', Arno Widmann: 'sulmon Alighieri-n duke i ulur vlerat rëndësishme që ai ka për gjuhën italiane dhe letërsinë botërore, me akuzën se karakteristika kryesore e Dante-s është mangësia e mendimit origjinal'.

Schmidt shpjegon: 'Widmann mbështet idenë se rëndësia e Dante-s për gjuhën italiane nuk ka qenë dhe aq e madhe, sepse nxënësit e shkollës e paskan të vështirë për t'i kuptuar tekstet e tij. Kjo nuk është aspak e vërtetë. Me përjashtim të ndonjë fjale apo të ndonjë teksti fetar, gjuha e Dante-s kuptohet edhe sot në mënyrë të përsosur, ndryshe nga çka ndodhur me gjuhën angleze dhe gjermane të viteve një mijë e treqind,

të cilat janë praktikisht të pakuptueshme për anglezët dhe gjermanët e sotëm.'

'Widmann thotë - vazhdon drejtori - se Dante u përpoq t'i imitojë poetët provensalë të Francës. Kjo nuk përbën ndonjë zbulim të madh: që Dante i ka parë poetët provensalë si një model, kjo dihet prej kohësh, por që të thuash se ai është mjaftuar thjesht me një kopjim të tyre, përbën një deklaratë të rremë, dhe kjo është më se e evidente. Një tjetër argument që sjell Widmann është se, sipas tij, Dante paska krijuar një 'kundër-version' kristian përballë traditës islamike të udhëtimit në botën e përtejme të përfaqësuar nga Profeti Muhamed: ky argument është krejtësisht i pabazuar, sepse udhëtimi në botën e përtejme është një zhanër që haset shumë shpesh jo vetëm në traditën kristiane, por në të vërtetë, edhe në letërsinë klasike romake e greke (le ta përmendim këtu Odise-në, kur flitet për zbritjen e tij në Hades - botën e përtejme - në përpjekje për t'u takuar me Akilin). Kuptohet se autorit të shkrimit i mungojnë njohuritë bazë për temën në fjalë'.

'Së fundi, Widmann dënon edhe vetë strukturën e Komedisë Hyjnore tek pohon se Dante - mesa duket atij Poeti i Madh nuk i vjen fare për shtat dhe madje ai ushqen antipati për të - duke vendosur se kush përfundon në Ferr, në Purgator apo në Parajsë, merr përsipër detyrën e Zotit. Përse, sipas tij? Përgjigja nuk vonon: kjo vinte si pasojë e egoizmit të tij shumë të madh. Përfundimisht, cila mund të ketë qenë arsyeja e vërtetë që shtyu Widmann për të shkruar një artikull të tillë? Ndoshta - ironizon Schmidt - atë e ka brerë një smirë e brendshme duke u nisur thjesht nga fakti se shtatëqind vite më parë kishte pasur një shkrimtar me një ego më të madhe se ajo e tij, dhe sigurisht Widmann këtë fakt nuk e përtyp dot...'

Sulm i egër i gazetës gjermane "Frankfurter Rundschau"

*Poeti më i madh i Italisë nuk paska krijuar
'asgjë origjinale'. Alighieri na paska qenë
'vite dritë' pas Shekspir.*

nga Chiara Pozzati

IL QUOTIDIANONAZIONALE, 25 mars 2021

'Dante, njeri i paskrupull dhe plagjiator. Nuk ka kontribuar në formimin e gjuhës italiane, dhe nuk ka krijuar asgjë origjinale. Italia feston më kot'. Ky fshikullim në suazën e një sulmi të papërmbytur vjen nga Gjermania, jo në një ditë çfarëdo, por pikërisht në ditën e festës së përvjetorit të Dante-s. Një sulm ballor, i pathemeltë, që zor se mund ta gëlltitësh, u ndërmor nga komentuesi gjerman Arno Widmann, i cili mbushi dy faqe të plota dhe një pjesë të kopertinës të revistës letrare Frankfurter Rundschau.

Në ditën që i është kushtuar Poetit të Madh, ku marrin pjesë edhe autoritetet kryesore, përfshirë Sergio Mattarella-n dhe Papën Francesco, të bashkuar në nderim të Dante-s, Widmann mbështet idenë se vendi ynë nuk paska ndonjë arsye të fortë për të festuar, thjesht sepse poeti ynë ishte në thelb një mashtroer 'vite dritë mbrapa Shekspir, njeri egoist dhe ambicioz'. Duke u nisur nga të njëjtat motive që bazohen në mendjemadhësinë e tij të tepëruar, ai kritikon edhe poetin T. S. Elliot, i cili na qenka fajtor sepse paska krahasuar madhësinë e shkrimtarit britanik me atë të Dante-s.

Duke rikujtuar 25 marsin si ditën e përvjetorit dantesk, Widmann shkarkon të gjithë mllëfin e tij, 'Italia i thur lavde Dante-s, sepse ai e ngriti gjuhën në lartësitë e një letërsi të madhe: *'e ndërtoi gjuhën në funksion të veprës së tij* dhe nga kjo gjuhë lindi gjuha e lexuesve dhe e vetë Italisë'. Menjëherë pas kësaj, ai preçizon se e gjitha kjo nuk është gjë tjetër veçse një sintezë që iu servir nxënësve gjashtëdhjetë vite më parë. Vetë Komedia Hyjnore, vijon fshikulluesi Widmann, në themel nuk është origjinale: studiuesi spanjoll Asin Palacios deklaroi më 1919 se vepra e Dante-s bazohet në një poemë mitike arabe në të cilën bëhet fjalë për përvojën e ngritjes në qiell. Është më se e qartë se historia i ka përgënjeshtuar të gjitha këto, por le të bëjmë pak durim. Më pas, Widmann përfundon gjithçka me ftesën që i drejton lexuesve të tij që 'mos të gabojmë e t'i hymë në hak Dantes, duke nënvlehtësuar ambicien e tij të pacipë', sepse në të vërtetë, 'mund të ketë ëndërruar që, me udhëtimin e tij kristian në botën e përtejme, të bënte një puç të vogël në kurriz të poemës arabe'.

'Të mos dëgjojmë se ç'thonë të tjerët, hidh një vështrim dhe ec përpara': me një tweet të tillë, Ministri i Kulturës, Dario Franceschini neutralizon këtë episod. Këtë e bën duke iu referuar kantos së tretë të Ferrit, dhe duke bërë kështu lëvizjen më inteligjente përballë një kokëtrashie të madhe.

Gabriel García Márquez

PËRSE DYMËDHDJETË

PËRSE TREGIME

DHE PËRSE PELEGRINE

Përktheu nga origjinali MiraMeksi

Dymbëdhjetë tregimet e këtij libri u shkruan përgjatë tetëmbëdhjetë viteve të fundit. Përpara se të kishin formën që kanë sot, pesë prej tyre kanë qenë shënime gazetareske dhe skenarë filmi, ndërsa njëri serial televiziv. Një tjetër e rrëfëva përpara pesëmbëdhjetë vjetësh, në një intervistë të regjistruar, dhe miku, të cilit ia tregova, e hodhi në letër dhe e botoi; tani e shkrova nga e para, duke u nisur nga ky variant. Ishte një përvojë e rrallë krijuese, e cila meriton të shpjegohet, qoftë edhe vetëm që fëmijët, të cilët duan të bëhen shkrimtarë në të ardhmen, ta dinë që tani se sa i pangjinjur dhe gërryes është vesi i të shkruarit.

Idea e parë më erdhi në mendje në fillim të viteve shtatëdhjetë, nga një ëndërr që pashë në krye të pesë vjetëve që po jetoja në Barcelonë dhe që më ndriçoi mendjen. Pashë në ëndërr sikur ndodhesha në varrimin tim, më këmbë, duke ecur mes një grupi miqsh të veshur me petka solemne zie, por zemërgëzuar. Të gjithë ishim të lumtur që ndodheshim bashkë. Dhe unë më shumë se të tjerët, nga ai rast fatlum që po më jepte vdekja për të qenë me miqtë e mi të Amerikës Latine, me ata më të vjetrit, më të dashurit, ata që kisha kohë pa i parë. Në fund të ceremonisë, kur zunë të largoheshin, unë bëra t'u veja pas, por njëri prej tyre ma bëri të qartë, me një ashpërsi të prerë, se për mua festa kishte mbaruar. “Je i vetmi që s'mund të largohesh” më tha. Vetëm atëherë e kuptova se të vdisje do të thoshte të mos ishe më kurrë me miqtë.

Nuk di përse, atë ëndërr të rrallë e interpretova si një ndërgjegjësim për identitetin tim dhe mendova se ishte një pikënisje e mirë për të shkruar mbi çuditë që u bëjnë vaki latino-amerikanëve në Europë. Ishte një zbulim ngushëllimtar, sepse para pak kohësh kisha mbaruar *Vjeshtën e Patriarkut*, e cila ishte puna ime më e vështirë dhe më e çartuar, e nuk po gjeja rrugë për të vazhduar më tej.

Dy vjet me radhë mbajta shënime për temat që më vinin në mendje, pa vendosur ende se ç'mund të bëja me to. Meqë nuk më ndodhej në shtëpi asnjë bllok shënimesh natën kur vendosa të filloja, bijtë e mi më dhanë një fletore shkolle. Ata vetë e ruanin në çantën e librave gjatë udhëtimeve tona të shpeshta, nga frika se mos humbiste. Arrita të mblidhja gjashtëdhjetë e katër tema të pajisura me aq shumë hollësira, sa s'më mbetej veç t'i shkruaja.

Ndodhi në Meksikë, kur u ktheva nga Barcelonë, më 1974, që u qartësova se ky libër nuk kishte për të qenë roman, siç më ishte dukur në fillim, por një përmbledhje tregimesh të

shkurtra të bazuara në fakte gazetareske, por që dinakëritë e poezisë do t'i shëlbopin prej natyrës së tyre të vdekshme. Deri asokohe kisha shkruar tre libra me tregime. Megjithatë, asnjëri prej tyre nuk ishte ngjizur apo zgjidhur si një i tërë, porse ishte një pjesë e pavarur dhe e rastësishme. Kështu që procesi i shkrimit të të gjashtëdhjetë e katër tregimeve mund të ishte një aventurë e mahnitshme, nëse arrija t'i shkruaja me një frymë dhe me një unitet të brendshëm toni dhe stili, që t'i bënte të pandashëm në kujtesën e lexuesit.

Dy të parët - *Gjurmët e gjakut tënd në dëborë* dhe *Vera e zonjës Forbes* - i shkrova më 1976 dhe i botova menjëherë në suplementet letrare të shumë vendeve. Pa u mbushur mirë me frymë, në mes të tregimit të tretë, i cili ishte pa dyshim ai i varrimit tim, ndjeva se po lodhesha shumë më tepër se me një roman. E njëjta gjë më ndodhi edhe me të katërtin. Aq sa s'më mbeti më frymë për ta përfunduar. Tani e di psenë: mendi për të shkruar një tregim të shkurtër është po aq intensiv sa mendi për të nisur një roman. Sepse në paragrafin e parë të romanit duhet të kesh përcaktuar gjithçka: strukturën, tonin, stilin, ritmin, gjatësinë dhe herë-herë deri edhe karakterin e ndonjë personazhi. Ç'vjen më pas është kënaqësia e të shkruarit, gjëja më intime dhe më e vetmuar, dhe, nëse nuk mbetemi tërë jetën duke korrigjuar librin, kjo ndodh sepse po ai rigorozitet i çeliktë që duhet për ta filluar, të imponohet edhe për ta mbaruar veprën. Përkundrazi, tregimi nuk ka as fillim e as fund: ai ngjit ose nuk ngjit. E kur nuk ngjit, përvoja jote dhe e të tjerëve tregon se është më e shëndetshme ta nisësh prapë nga e para, nëpër një udhë tjetër, ose ta flakësh në kosh. Dikush, që nuk më kujtohet, e ka thënë mirë një frazë ngushëllimtare: “Një shkrimtar vlen më tepër për atë që gris, se për atë që boton”. Sigurisht, nuk i grisa skicimet dhe shënimet, por bëra diçka edhe më të keqe: i lashë në harresë.

Më kujtohet që e kisha fletoren mbi tryezën time të shkrimit në Meksiko, si një anije e mbytur në një stuhi letrurinash, deri në vitin 1978. Një ditë, tek kërkoja tjetër gjë, i rashë më të se nuk ma kishin parë sytë prej kohësh. Nuk e vrava mendjen. Por, kur u binda se me të vërtetë nuk ndodhej mbi tryezë, më zuri një krizë paniku. Nuk mbeti qoshe e shtëpisë pa u kthyer përmbys. Lëvizëm orenditë, çmontuam bibliotekën për të qenë të sigurt se nuk kishte rënë prapa librave, derisa vumë nën një kontroll të pafalshëm shërbëtorët dhe miqtë. S'i kishte mbetur as nami as nishani.

I vetmi shpjegim i mundshëm - apo i besueshëm? - ishte që në një nga ato shfarosjet e letrurinave që bëj shpesh, të ketë shkuar edhe fletorja në koshin e plehrave.

Vetë reagimi im më çuditi: temat që i kisha harrur për gati katër vjet m'u kthyen në një çështje nderi. Duke u rrekur t'i fitoja sërisht e me çdo kusht, me një punë që ishte po aq e vështirë sa edhe vetë shkrimi i tyre, arrita të ngrija në këmbë shënimet për tridhjetë tema. Meqë vetë mendi që derdha për t'i kujtuar më shërbeu si spastrim, nisa t'i përjashtoja pa zemër ato që më dukeshin pa shpëtim, dhe kështu mbetën tetëmbëdhjetë. Kësaj here më motivonte vendimi që të vazhdoja t'i shkruaja pa pushim, por shpejt e kuptova se e kisha humbur entuziazmin. Megjithatë, ndryshe nga ajo që shpesh u pata këshilluar shkrimtarëve të rinj, nuk i hodha në plehra, por i arkivova. Se nuk i dihej.

Kur nisa *Kronika e një vdekje të shpallur*, më 1979, u binda se në pauzat ndërmjet dy librave humbisja zakonin e të shkruarit, dhe gjithashtu e kisha më të vështirë për të filluar sërisht. Prandaj, që nga tetori i 1980 e deri në mars 1984, i vura detyrë vetes të shkruaja nga një shënim javor nëpër gazetatat e vendeve të ndryshme, si gjimnastikë për të mbajtur krahun në punë. Atëherë mendova se konflikti im me shënimet e fletores vazhdonte të ishte ai i gjinisë letrare, dhe se në të vërtetë ato s'duhet të ishin tregime, por shkrime gazetareske. Vetëm se pasi botova pesë shkrime të nxjerra nga fletorja, ndërrova mendje: shkonin më mirë për film. Kështu dolën në dritë pesë filma dhe një serial televiziv.

Ajo që nuk e parashikova kurrë ishte se puna gazetareske apo ajo kinematografike mund të më ndryshonin disa ide mbi tregimet, deri në atë pikë, sa tani që po i shkruaj në formën e tyre përfundimtare më është dashur të kujdesem për t'i ndarë me piskatore idetë e mia nga ato që futën regjisorët gjatë shkrimit të skenarëve. Veç kësaj, bashkëpunimi i njëkohshëm me pesë krijues të ndryshëm më sugjeroi një tjetër metodë për të shkruar tregimet: e filloja njërin kur kisha kohë të lirë, e lija kur ndihesha i lodhur apo kur më dilte ndonjë projekt i paparashikuar, dhe pastaj filloja një tjetër. Në më pak se një vit, gjashtë nga tetëmbëdhjetë temat përfunduan në koshin e letrave dhe midis tyre edhe ajo e varrimit tim, sepse asnjëherë nuk arrita ta krijoja siç duhej atmosferën festive të ëndrrës. Tregimet që mbetën, përkundrazi, sikur zunë të merrnin frymë për të pasur një jetë të gjatë.

Janë dymbëdhjetë tregimet e këtij libri. Shtatorin e kaluar u bënë gati për shtyp pas një pune me ndërprerje, që mori dhe dy vjet të tjerë. Dhe kështu do të kishte marrë fund pelegrinazhi i tyre i pandërprerë i vajtje-ardhjes në koshin e letrave, sikur në orën e fundit të mos më kishte brejtur një dyshim final. Meqë qytetet e ndryshme të Europës, ku ndodhin ngjarjet e tregimeve, i kisha përshkruar vetëm nga mbresat dhe në largësi, desha të provoja besnikërinë e kujtimeve të mia pothuaj njëzet vjet më vonë, dhe kështu ndërmora një udhëtim të shpejtë rinjohjeje në Barcelonë, Gjenevë, Romë e Paris.



Asnjë nga këto qytete nuk kishte tani asgjë të përbashkët me kujtimet e mia. Të gjitha, ashtu si Europa e sotme, ishin firuar nga një përmbysje e frikshme: kujtimet e vërteta më ngjanin fantazma të memories, ndërsa kujtimet e rreme ishin aq bindëse, sa kishin zëvendësuar realitetin. Kështu që ishte e pamundur të dallohej vija që ndante zhgënjimin nga nostalgjia. Ishte zgjidhja përfundimtare. Sepse, më në fund, kisha gjetur atë që më mungonte më tepër për ta mbaruar librin dhe që mund të ma jepte vetëm rrjedhja e viteve: një **perspektivë** në kohë.

Kur u ktheva nga ai udhëtim aventuror, i rishkrova edhe një herë të gjitha tregimet që nga fillimi gjatë tetë muajve të ethshëm, ku s'pata nevojë të pyesja veten se ku mbaronte jeta dhe ku fillonte imagjinata, sepse më ndihmonte dyshimi se ndoshta nuk ishte e vërtetë asgjë nga ato që pata jetuar përpara njëzet vjetësh në Europë. Shkrimi m'u bë atëherë aq i rrjedhshëm, sa kishte çaste kur e ndieja se po shkruaja vetëm nga kënaqësia e të rrëfyerit dhe që ndoshta është gjendja njerëzore që i ngjet më tepër qëndrimit pezull në ajër. Veç kësaj, duke i punuar të gjitha tregimet njëherësh dhe duke u hedhur fare lirshëm, sa nga njëri te tjetri, arrita të krijoja një vizion panoramik, i cili më shpëtoi nga lodhja e fillimeve të njëpasnjëshme dhe më ndihmoi të shmang përsëritje të kota dhe kontradikta vdekjeprurëse. Besoj se me këtë libër tregimesh kam arritur të jem më pranë atij që kam dashur përherë të shkruaj.

Ja ku është këtu, gati për t'u shpënë në tryezë pas tërë atyre ecejakeve, duke u përleshur për të mbijetuar me perversitetet e pasigurisë. Të gjitha tregimet, përveç dy të parëve, mbaruan në të njëjtën kohë dhe secili prej tyre mban datën kur e fillova. Radha, në të cilën ndodhen në këtë botim, është ajo që kishin në fletoren e shënimeve.

Gjithmonë kam menduar se çdo variant i ri i një tregimi është më i mirë se i pari. Si mund ta marr vesh se cili duhet të jetë i fundit? Është një e fshehtë zanati, që nuk u bindet ligjeve të inteligjencës, por magjisë së instinkteve, njëlloj siç e merr vesh amvisa se kur është gati supa. Gjithsesi, për hir të dyshimeve, nuk do t'i kthehem sërisht leximit të librit, ashtu siç nuk i jam kthyer kurrë leximit të librave të mi, nga frika se mos pendohesha. Ai që do t'i lexojë, di tashmë se ç'të bëjë me to. Për fat, për këto dymbëdhjetë tregime pelegrine, prehja në koshin e letrave duhet të jetë si një rikthim i lumtur në shtëpi.


Cartagena de Indias, prill 1992.



E. B. White

DISA MENDIME PËR HUMORIN

E përktheu Granit Zela



Shumë janë përpjekur të shkruajnë për humorin, dhe unë e kam lexuar një pjesë të kësaj literature, por s'më kanë mësuar ndonjë gjë të madhe. Humori mund të shpalohej, ashtu si mjegulla, por gjërat zhduken gjatë kësaj ndërkohe dhe çfarë ndodhëti nënkuptuar i shkruajon të gjithë, me përjashtim të mendjes mirëfilli shkencore. Në një teatër shëtitës kam parë fotografinë e një burri që kishte krijuar fluska të panumërta sapuni, të cilat ishin ngjitur në një lartësi e cila s'ishte arritur kurrë më parë. Ai ishte shndërruar në krijuesin e pakonkurrueshëm të bërjes së fluskave në Amerikë, dhe e kishte përsosur këtë punë duke e stërholluar, dyfishuar, katërfishuar. Madje kishte arritur deri në atë pikë sa mund të mbulohej i tëri me fluska sapuni. Efekti i përfutur s'ishte tërheqës. Disa prej fluskave ishin tepër të mëdha për të qenë të bukura, dhe fluskabërësi gjatë gjithë kohës kërcente i mbuluar prej tyre, u shmangej ose bënte ndonjë lojë aspak tërheqëse me to. S'ishte asgjë më shumë se një pamje e neveritshme. Me humorin, ndodh pak a shumë e njëjta gjë: s'e duron fryrjen e tepërt, ashtu si fluska s'e duron pickimin. Ka një lloj brishtësie, fluiditeti, i cili i cili duhet të respektohet me besnikëri. Humori në thelb është plotësisht mister. Një trup njerëzor që shkundet nga të qeshurit, një e qeshur që bëhet hysterike dhe e pakontrollueshme, e humbet drejtpeshimin po aq sa një grup njerëzish të mbërthyer nga lemza apo grahmat e teshtitjeve.

Një nga gjërat që rëndom thuhet për humoristët është se në realitet janë njerëz të trishtuar, klounë që ta thyjnë zemrën. Ka njëfarë të vërtetë në këtë, por s'është shprehur si duhet. Mendoj se do të ishte më e vërtetë, por të thoshim se një damar i thellë melankolik përshkon jetën e gjithkujt dhe se humoristi, ndoshta, është më i ndjeshëm ndaj tij se të tjerët, dhe e kompenson këtë në mënyrë aktive dhe pozitive. Humoristët lartësohen mbi andrallat e jetës. Ata s'preshtin përpjekjet dhe kanë vullnet të mirë ndërsa i durojnë dhimbjet me gaz. I sheh tek ndeshen me gjuhë të huaja, luajnë me gjestet, mimikën dhe imitimet, teksa vuajnë parehatinë e çizmeve të ngushta (apo sikur i quante Josh Billings "çizme mbërthyesë"). Ato i japin udhë pikëllimit të tyre në mënyrë të frytshme, në një formë e cila nuk është as krejtësisht trillim sikurse as krejtësisht fakt. Poshtë të dukshmes shndritëse të këtyre mëdyshjeve rrjedh batica e fortë e mjerimit njerëzor.

Në fakt secili prej nesh është deri diku një lloj maniaku

depresiv me ulje-ngritjet e humorit dhe, sigurisht, nuk duhet të jesh humorist që të provosh trishtimin e situatës dhe gjendjes shpirtërore. Por shpesh ka një vijë të hollë që e ndan të qeshurën nga e qara, dhe një shkrim argëtues e sjell një person në pikën ku reagimet e tij emocionale janë të pabesueshme dhe ka gjasë të ndërpriten në mbretërinë e kundërt, kjo ndodh sepse humorit, ashtu si poezia, ka një përmbajtje tjetër që është vetëm e tij. Ngjan me zjarrin e madh dhe të nxehtë të së Vërtetës, ndërkohë që herë pas here lexuesi e ndien përvëlimin e tij.

Kur po rilexoj disa prej ditarëve parodizues të Franklin P. Adams-it, hasa në këtë shënim të datës 28 prill, 1926: Lexoni librin e H. Canby-t *Të shkruash më mirë*, i cili është i shkëlqyer. Por kur thotë: "Sensi i humorit vlen sa floriri për çdo shkrimtar", unë s'jam fare dakord. Sepse shkrimtarët që kanë arritur të grumbullojnë arin e tyre letrar, mua më duket se nuk kanë fare sens humorit, po kështu mendoj se nëse do ta kishin këtë sens humorit, kjo do të ishte e tmerrshme për ta, sepse do t'i paralizonte deri në atë pikë sa s'do të mund të shkruanin më kurrë. Sepse tek shkrimtari duhet të vlerësohet më shumë emocioni sesa sensi i humorit, ndërkohë që ato shpesh janë në konflikt me njëri-tjetrin. Ky është një vëzhgim i vëmendshëm.

Mendoj se perceptimi i humorit mund të ndryshojë me kalimin e kohës. Palaçoja i oborrit në kohën e Shekspirit s'kishte pozitë sociale dhe nuk ishte më i mirë se një lakë por dëgjohej me goxha vëmendje, dhe te humorit i tij mbartte të vërtetën e cila ishte e fshehur diku. Artistikisht ndoshta qëndronte më lart se humoristi i sotëm, i cili ka fituar pozitën sociale por jo mirësinë e të plotfuqishmit. (Mendoni se sa andralla do t'i kursente vetes në se do t'i kushtonte vëmendje gjeprave!) Një poet që u këndonte bëmave të mëdha, gëzonte një pozitë më të lartë se palaçoja dhe i lejohej të vishte rroba të mira; përsëri unë dyshoj që këngëtarit i baladave lajakatonte më shpesh se një lolo i dorës së dytë monarkun e tij me lirika, ndërsa palaçoja duhet të ketë qenë shpesh personazh i dorës së dytë që i jepte monarkut këshilla të vyera me lojëra fjalësh.


Frank Moore Colby, një nga humoristët më inteligjentë aktiv në vend në fillim të shekullit të njëzetë, në një ese të titulluar "Në kërkim të humorit" përshkruante se si amerikanit do dhe ruan pasurinë e tij më të çmuar: "Sot është gjëja më e zakonshme në botë të dëgjosh njerëzit ta quajnë mungesën e sensit të humorit një të metë fatale.

Pavarësisht se sa nursëz është njeriu, këtë ta pohon me siguri. Është një e metë mjerane, dhe të shkakton dëm të pallogaritshëm. Një jetë pa humor është si jeta e njeriut pa këmbë. Të ndjek nga pas një ndjesi mangësie, pasi s'mund të arrish atje ku arrijnë miqtë e tu. Je deri diku një lloj barre. Por e vetmja gjë vërtetë fatale është shtirja e të bërit humor kur ti s'e e zotëron dot atë. Janë disa njerëz që kanë lindur për me qenë serioz prej djepit në varr. Ka shumë gjasa që të mbesin të tillë. Kësisoj, për sa kohë i qëndrojnë besnik natyrës së tyre, s'përbëjnë rrezik për askënd; por kur dalin jashtë natyrës së tyre bëhen të tmerrshëm. Solemniteti është deri diku një bekim, dhe ai që ka lindur me këtë veti, nuk duhet të nxitet asnjëherë t'i shmanget. E kemi lavdëruar humorin kaq shumë sa kemi krijuar një kult të pasinqertë, dhe janë të shumtë ata që mendojnë se duhet ta glorifikojnë ndërkohë që e urrejnë me shpirt. Adhurimi i rremë i humorit është më i vdekshmi ndër mëkatet sociale, dhe një ndër më të zakonshmit. Njerëzit me asnjë lloj sensi humorit në gjak do ta lavdërojnë me orë të tëra. Burrat do të pohojnë, tradhtinë, vrasjen, zjarrvënien e qëllimshme ose dhëmbët falsë. Sa prej tyre do të pranojnë singlerisht mungesën e humorit? Guximi që mund të nxirrte në pah këtë kurajë tek një njeri do të shlyente çdo lloj ndjenje faji.

Mund të thuhet që pak humoristë amerikanë janë bërë me të vërtetë të famshëm, në atë mënyrë që janë të njohur në çdo kënd të vendit, sikurse ka ndodhur me shumë romancierë dhe personazhe serioze letrare që janë bërë të famshëm. Mark Twain-i ia doli. Ai pati, pa dyshim një fillim të mbarë, meqenëse në thelb ishte rrëfimtari dhe humorit i tij që më tepër ngashënim. (Ishte gjithashtu shumë-shumë i mirë).

Në vitet '20 dhe '30 Ring Lardner-i ishte idhull i humoristëve profesionistë dhe shumë njerëzve të tjerë, gjithashtu; por mendoj se tregohem korrekt kur them që në kulmin e karrierës ai nuk që një nga figurat letrare më të njohura letrare në vend, dhe emri i Lardner-it ishte i njohur jo për miliona por për pak qindra. Ai kurrë nuk arriti popullaritetin e Mister dhe Mis Amerikës apo të të tjerëve, deri në masën që e arriti Mark Twain-i dhe dyshoj nëse do ta arrij ndonjëherë. Në përgjithësi, humoristët që i japin kënaqësi një audience të gjerë, janë ata që krijojnë personazhe dhe rrëfejnë përralla, pra janë rrëfimtari të lindur. Lardner-i rrëfeu histori dhe u dha jetë disa personazheve, por unë mendoj para së gjithash se ai ishte realist, parodist, dhe satirist, jo thelbësisht një shkrimtar krijimesh letrare. Publiku i përgjithshëm ka nevojë për diçka pas së cilës të jepet – një personazh me emrin Penrod, Huck Finn apo Lepur Vëllaçoja, personazh i përrallave afrikane. Mprehtësia e satirës, burleskes, absurdes, parodisë dhe kritikës nuk i përkasin shijes së përgjithshme; ato janë për shtresën e lartë të intelektit. Clarence Day, për shembull, nuk binte shumë në sy kur hidhte në mënyrë të pakrahasueshme në letër "Mendime pa fjalë", të cilat përbëjnë pjesën më të mirë të krijimtarisë së tij; ai u bë i njohur dhe i dashur për publikun e gjerë vetëm pasi i dha jetë personazhit të Babait. (Këshillë për shkrimtarët e rinj që duan të bëjnë përpara pa ndonjë vonesë të mërzitshme: mos shkruani për Njeriun, shkruani për një njeri të veçantë.)

Mua më ngjall interes, leximi i "Shpërthimi i Mark Twain-it, të De Voto-s për të ndeshur në disa vërejtje therëse të zotit Clemense për një antologji humorit të cilën avokati i tij për të drejtën e autorit i kishte dërguar dhe të cilin Mark Twain-i e përshkruante si "një volum të madh, të trashë,



thumbues”. Ai nuk ishte argëtues. “Ky libër është si varr! - shkroi ai. Në këtë volum të përzishëm (vazhdon De Voto) unë gjej Nashy-n, Artemis Wad-in, Yawcob Strauss-in, Derby-n, Burdette-n, Eli Perkins-in, personazhin e gazetës Danbury, Orpheus C. Kerr-in, Smith O’Brian-in. Josh Billingsi-n, dhe një duzinë shkrimtarësh të tjerë, mbase dy duzina shkrimtarësh, shkrimet dhe thëniet e të cilëve përcilleshin gojë më gojë, ndërsa sot as që përmenden. Shtatëdhjetë e tetë shkrimtarë të përmendur në këtë libër ngjajnë me një aradhë të pabesueshme artistësh të një periudhe dyzet vjeçare, megjithëkëtë s’mund të thuash se ky libër përfshin të gjithë krijimtarinë e kësaj kohe, përkundrazi. Nuk përmendet Ilke Parlington-i; dikur kaq i dashur dhe i mirënjohur, nuk përmendet Doectis’i, as imituesit e panumurt të Artemis Ward-it, as edhe njëri prej tre humoristëve popullorë jugorë, emrat e të cilëve s’po më kujtohen, dhe as një duzinë talentesh të shndritshëm drita e të cilëve ka shkëlqyer gjatë, porse ka kohë që është shuar”.

Pse u harruan ata? Sepse ishin thjesht shkrimtarë humorit. Shkrimtarët e humorit, që janë “thjeshtë” të tillë, nuk mund të mbijetojnë. Humori është thjeshtë aromë, zbukurim. Shpesh kërkon një truk të vjetër ligjërata dhe gërmëzimi, si në rasiin e Ward-it dhe Billings-it apo edhe Nasby-it me “Vullnetarët e shpërdarë” por realisht moda ikën, dhe fama bashkë me të.

Nuk ka shumë kohë që jam thelluar në studimin e humorit dialektor të qysh para pesëdhjetë deri njëqind vjetëve më parë, humor i cili për Mark Twain-in ishte në zhdukje e sipër. Atëherë ishte kulmi i lulëzimit të filozofit të vozës, herë pas here me shkrepitma mençurake, dhe gjithmonë me pamje të atillë, por kur lexohen sot, ata ngjajnë të mërëzshmëm. Mua më duket se në përdorimin e personazheve që flasin me dialekt, ka njëfarë pështjellimi në përdorimin e gërmëzimit dredharak, të çuditshëm apo prej të pashkolluari, por që arrin të ngjallë efekt humorit. Dua të them që nuk është gjithmonë e qartë nëse shkrimtari do që personazhi i tij të sillet sikur lexon apo shkruan dhe unë ndiej që deri në çastin që di fort mirë se çfarë po lexoj, mund të shqiptoj keq. Për shembull, këtu kemi disa nga keqshqiptimet e përdorura në veprat e Petroleum V. Nasby-t: ai shqipton “urë” në vend të “urtë”, “pro” në vend të “po”, “burë” në vend të “burrë”, “birë” në vend të “birrë”.

Shqiptimi në të gjitha rastet nuk është një mjet për të përfutur efektin e humorit, por instrument i nevojshëm për të punuar me materialin, i cili është pashmangshmërisht material humorit. Dyshoj nëse popullariteti i gjithçkaje dialektore përftohet dri diku prej ngasjes së lexuesit, duke i dhënë një ndjesi të këndshme epërsie të cilin ai e krijon duke përdorur keqshqiptimin dhe kënaqësinë e zbulimit të vrazhdësisë ose analfabetizmit të dikujt. Kjo nuk është e gjitha, por shpjegon deri diku diçka. Një specialist i letërsisë për fëmijë më ka treguar që fëmijët janë shumë të dhënë pas dialektit. Atyre u pëlqen të luajnë me fjalët. Kur nxjerrin kuptimin e tyre, e shohin këtë si shkëndijë pjekurie, zotësi për të treguar aftësi më të mëdha intelektuale se personazhet që hasin.

Por që të rikthehemi tek Mark Twain-i dhe “volumi i madh, i trashë” që e bëri të ndihej keq: Ka nga ata (vazhdon ai) që thonë se romani duhet të jetë vetëm vepër arti, dhe nuk duhet të predikojë, nuk duhet të edukojë. Kjo mund të jetë e vërtetë për romanet, por nuk është e vërtetë për humorin. Humori nuk duhet të mësojë në mënyrë predikuese, porse duhet t’i bëjë të dyja nëse do të jetojë përgjithmonë. Me përgjithmonë, nënkuptoj tridhjetë vjet. Mu ato gjërat me të cilat predikon, dhe të cilat janë risi kur predikohet për to, mund të pushojnë së qeni risi dhe të kthehen në diçka të zakonshme brenda tridhjetë vjetësh. Atëherë ky predikim nuk i intereson askujt. Unë kam predikuar gjithmonë. Kjo është arsyeja pse vepra ime ka jetuar tridhjetë vjet. Nëse humori vinte pa ftuar dhe pa menduar, gjithmonë i kam gjetur një vend në predikimin tim, por kurrë nuk kam shkruar një predikim vetëm për hir të humorit. Po i them këto gjëra të mjegullta në mënyrë shumë të sinqertë, sepse unë jam një i vdekur që po flet nga varri. Kësisoj zor se i jepet humorit jetë. Mendoj se kurrë nuk bëhem me të vërtetë vetja jonë e mirëfilltë dhe e plotë derisa të kemi vdekur – jo derisa të kemi qenë të vdekur për vite e vite me radhë. Njerëzit duhet ta nisin nga vdekja për me qenë të ndershme më pas.

Nuk mendoj se do të bija dakord që humori duhet të predikojë që të arrijë të jetojë, duhet thjesht të thotë të vërtetën, dhe shoh se zakonisht e bën këtë. Porse nuk ka kurrfarë dyshimi që njerëzit duhet ta nisin nga vdekja.

Nga Shtëpia Botuese “Polis”:

Geverina Muzhaqi

NGJYRA E TURPIT

Një nëntëmbëdhjetëvjeçare me një foshnjë në krahë, befas, një mbrëmje vendos t’ia vërë flakën shtëpisë. Nuk ka asnjë vend se ku të shkojë. Nuk ka shkollim, as bukuri e as ndonjë aftësi të spikatur që mund ta ndihmojë për ta ndryshuar rrënjësisht jetën. E si të mos mjaftojnë këto, vuan nga një sëmundje e rrallë, për të cilën e kanë tallur që në vegjëli. E megjithatë, ajo ia vë flakën të gjithë asaj që dikur kishte qenë jeta e saj mjerane, për t’u kredhur në të panjohurën, në të mistershmen: në të ardhmen.

Quhet Romina, vjen nga komuniteti rom dhe nuk ka kurrfarë qëllimi a pritshmërie për të ardhmen, pos atij që t’i japë një jetë më të mirë të birit ende njomëzak. Rastësisht e në rrethana krejtësisht të pazakonta, takon plakun Tonin, që vitet e fundit të jetës i ka kaluar në një shtëpi për të moshuarit, por ëndrra e tij më e madhe është që t’i mbyllë sytë në shtëpinë ku ka jetuar ngaherë, në mes të kujtimeve të tij.

Por çfarë i lidh këta dy njerëz në pamje të parë aq ndryshe nga njëri-tjetri? Cilat turpësi i bashkojnë dy botëkuptime të kundërta, dy breza të largët, dy kultura të papërputhshme dhe me shumë paragjykime për midis?

Me një gjuhë të mprehtë e pa barriera, të shprehura nga njëri personazh, si dhe me një shprehësi letrare e miklueshmërisht të sofistikuar të personazhit tjetër, zbulohen të gjitha frikërat më të fshehta, ndjesia e turpit, braktisjes, vetmisë, ajo ideja e ngulët e të mosqenit i mjaftueshëm për botën, ashtu sikurse ajo nuk është për ne.

Si mund të rimëkëmbesh, kur gjithçka ka marrë fund? Po sikur i panjohuri aty në rrugë, që duket se po vuan, të ishte familjari yt?

Po sikur tjetri të jem unë?

Mbi këto pyetje ngrihen themelet e historisë së këtij romani.

“Ndonjëherë edhe transparentja mund të ketë ngjyrë. Ngjyra e shiut, për shembull, përziehet me dheun dhe, kur formon një pellg, bëhet e kafenjtë. Ngjyra e detit: e pasqyron qiellin dhe ia vjedh kaltërsinë. Ngjyra e shpirtit: këtu çështja ndërlikohet shumë, se brenda të njëjtit shpirt mund të bashkëjetojnë më shumë se një ngjyrë. Por më e rëndësishmja, ajo më transparentja, është ngjyra e ndërgjegjes. Nëse në ndërgjegje të krijohen njolla të errëta, asgjë, besomë, asgjë nuk mund t’i fshijë.”

Teknika narrative pasqyron reflektimin përmes pyetjeve ekzistenciale të personazhit femër, gërshetuar me orientimin e ngrohtë atësor të personazhit mashkull, të rrëfyera në të dyja rastet në vetën e parë.

Me përshkrime fizike e shpirtërore tronditëse, me pasiguritë mbi atë që është dhe atë që dëshiron të jetë, çdo grua e gjen sadopak veten te Romina, te sfidat që ajo duhet të përballojë dhe betejat që duhet të luftojë, me qëllim që zëri i saj të dëgjohet dhe në fund ta gjejë vendin e saj në botë.

Nga ana tjetër, kemi plakun e mirë Tonin, që përfaqëson moshën e tretë, atë më delikaten e më pak të kuptuarën dhe, mbi të gjitha, më të vetmuarën.

Me një stil të rrjedhshëm, monologët përshfaqin një pasqyrë të brendshme dhe dialogët midis dy personazheve kryesorë janë si një përballje me realitetin.

A mund ta ndihmojë njeriu njeriun?

A mund të ringrihesh, pasi të është thërmuar e gjithë bota përpara syve?

A mund ta pranosh turpin e të bashkëjetosh me të?

Të gjitha këto përbëjnë “Ngjyrën e turpit”.




Geverina
Muzhaqi

Ngjyra
e turpit

Roman



POLIS



SENECA

Shkurtësia e jetës

Minerva